Manifestimet Binjake

Instituti Ruhi

Libri 4

Manifestimet Binjake

Instituti Ruhi

Librat në seri:

Më poshtë janë titujt në seri të planifikuara nga Instituti Ruhi. Librat janë caktuar që të përdoren si sekuenca kryesore e kurseve të një programi formal edukimi për të rinj dhe të rritur që kanë si qëllim të ndërtojnë aftësi shërbimi. Instituti Ruhi gjithashtu po zhvillon një strukturë kursesh që degëzohen nga libri i tretë në seri për trajnimin e mësuesve të klasave Bahá'í për fëmijë dhe kjo gjithashtu tregohet në listë. Duhet theksuar se lista do të ndryshojë ndërkohë që eksperienca në këtë degë përparon dhe do të shtohen tituj të ri ndërkohë që një numër në rritje elementësh kurrikulare në zhvillim arrijnë fazën në të cilën mund të bëhen të gjerësisht të disponueshme.

Libri 1	*Reflektime mbi jetën e Shpirtit*
Libri 2	*Duke u ngritur në shërbim*
Libri 3	*Mësimi në klasat e fëmijëve, nivel 1*
	Mësimi në klasat e fëmijëve, nivel 2 (kurs degë)
	Mësimi në klasat e fëmijëve, nivel 3 (kurs degë)
Libri 4	*Manifestime binjake*
Libri 5	*Të çliruar mundësitë e paratërinjve* (variant i para-botuar)
Libri 6	*Mësimdhënia e Kauzës*
Libri 7	*Duke ecur së bashku në rrugën e shërbimit*
Libri 8	*Besëlidhja e Bahá'u'lláh·ut*
Libri 9	*Marrja e një Këndvështrimi Historik*
Libri 10	*Ndërtimi i Komuniteteve Drithëruese*
Libri 11	*Mjetet Materiale*
Libri 12	*Familja dhe Komuniteti*
Libri 13	*Angazhimi në Aksion Social*
Libri 14	*Pjesëmarrja në Biseda Publike*

E Drejta e Autorit © 2008, 2022 nga Ruhi Foundation, Kolombia
Të gjitha të drejtat të rezervuara. Botimi 2.1.2.PE nentor 2023

Titulli origjinal në anglisht: *Las Manifestaciones Gemelas*
Copyright © 1987, 1997, 2021 nga Ruhi Foundation, Kolombia
ISBN 978-958-53332-2-2

Asambleja Shpirtërore Kombëtare e Bahá'í·ve të Shqipërisë ka marrë lejenga Instituti Ruhi,për një shtypje të kufizuartë këtij libri në shqip.

Instituti Ruhi
Cali, Kolombia
Email: instituto@ruhi.org
Web site: www.ruhi.org

Asambleja Shpirtërore Kombëtare e Bahá'í·ve të Shqipërisë
Tiranë, Shqipëri
Email: nsa@bahai.al
Web site: www.bahai.al

Pasqyra e lëndës

Bashkëpunëtorëve v

Madhështia e kësaj Dite 1

Jeta e Báb·it 15

Jeta e Bahá'u'lláh·ut 69

BASHKËPUNËTORËVE

Rreth kohës qëpjesëmarrësit arrijnë këtëkurs të katërt, të ofruar prej Institutit Ruhi, ata do të kenëpërparuar në mënyrë të vendosurnë shtegun e shërbimittë vënë në lëvizje nga sekuenca e saj kryesore. Ngado që të vijnë,kur hyjnë në Librin 1, ata do të zotohen tashmëndaj vizionit të individitdhe transformimit kolektiv të përshkruar në Shkrimet e Bahá'u'lláh·ut. Për këtë qëllim, ata do të kenë filluar të formojnëzakonin e leximit të fjalës së Tijçdo ditëdhe do të jenë duke marrë mbështetje shpirtërore, si në takimet devocionale dhe në momente meditimi të qetë, prej lutjeve dhe këshillave që Ai ka reveluar. Ata do të jenë duke mësuar të angazhohen në biseda me miqtë dhe të njohuritpër parimet shpirtërore, që Ai ka shpallur dhe do të jetë duke bërë vizita në shtëpitë e fshatit apo lagjes së vetë për të diskutuar parimet që Ai ka sjellëpër t'a ndërtuar botën sërish. Disa do të jenë duke drejtuar klasa për edukimin shpirtëror të fëmijëve. Në këtë pikë në shtegun e shërbimit, më pas, ata do të jenë gati—me të vërtetë, të etur—të njihen më shumë me jetën e Atij,mësimet e të Cilit,i kanë influencuar atakaq thellëdhe të fitojnë një të kuptuar më të thellëtë rrethanave historikeqë shoqëruan lindjen dhe shpalosjen graduale të Revelacionit të Tij. Tre Njësitë,të cilat e përbëjnë Librin 4 janë synuar t'u sigurojnë pjesëmarrësve këtë mundësi.

Jeta e një Manifestimi të Perëndisë është thelbësisht e ndryshme nga ajo e qenieve të tjera njerëzore, dhe madhështia e Tij nuk mund të kuptohet thjesht duke studiuar ngjarjet që kanë ndodhur në atë kohë. Gjatë viteve që Ai jeton në tokë, fuqitë e Tij të jashtëzakonshme përhapen në të gjithë planetin, duke shkaktuar një ndryshim të thellë në realitetin e të gjitha gjërave të krijuara, dhe duke e shtyrë njerëzimin për një fazë të re në progresin e tij. Ndonëse për sytë e jashtëm jeta e Tij mund të duket e mbushur me vuajtje, sytë shpirtërorë shquajnë në çdo gjë që ndodh shenjat e lavdisë e të madhështisë së Tij.Për t'i pregatitur pjesëmarrësitnë studimin e historive nga Jeta e Báb·it dhee Bahá'u'lláh·ut, të diskutuararespektivisht në njësitë e Dyta dhe të Treta, i pari u kërkon atyre të mendojnë rreth domethënies së Ditës,në të cilën ne jetojmë, një Ditë, që dëshmoi shfaqjen e dy Manifestimeve të Perëndisë.

Kjo njësi është relativisht e shkurtër. Ajo konsiston në disa pasazhenga Shkrimet Bahá'í,të cilat flasin përmadhështinë e kësaj Dite, përgjatë pak ushtrimeve të thjeshta. Së bashku, këto do t'i mundësojnë pjesëmarrësit, të reflektojnëjo vetëm mbi Natyrëne këtij momenti në Histori, kur bashkimi i njerëzimit në afat të gjatë është i mundur, por në përgjegjësitë që kjo diturifut tek secili nga ne. Ata të cilët shërbejnë si një lehtësuesi Librit 4,duhet të jenë të vetëdijshëm se njësia supozon,që pjesëmarrësite kanë tashmë një të kuptuar bazëtë koncepteve të caktuarathemelore për Besimin, të fitura si nga studimet e tyretë kurseve më të hershmenga përfshirja në jetën e komunitetit të tyre. Që të gjithë librat fetarë të së shkuarësi janë referuar Ditës së premtuar të Perëndisëkur paqja dhe drejtësia do të vendoseshin mbi Tokë, që Bahá'u'lláh·uka ngritur flamurine paqes universaledhe ka thirrur njerëzimin të njohë njëshmërinë e vetë thelbësore, saqëAi e ka fiksuar vështrimin e komunitetit të pasuesve të Tijtek synimi i një rendi të ri botëror—këto janë midis koncepteve, që përforcojnë diskutiminnë këtë njësi, "Madhështia e kësaj Dite".

Dy njësitë e tjera janë kronika ngjarjesh,që e sollën Besiminpërpara prej asaj mbrëmjeje profetike në 1844, kur Báb·ideklaroi Misionin e Tij, tek orët e hershme të mëngjesit afërsishtpesëdhjetë vite më vonëkur shpirti i Bahá'u'lláh·utu ngrit nga ky plan tokësor i egzistencës. Ky rrëfim kronologjik, veçanërishtnë njësinë e tretë të jetës së Bahá'u'lláh·ut, plotësohet nga pasazhe nga Shkrimet, të cilat hedhin dritë mbi tema të caktuara shpirtëroretë shoqëruara me personin e Manifestimit. Disa prej këtyre pasazhevendiqen nga ushtrimet; të tjerat kërkojnë vetëm lexim të përsëritur dhe reflektim personal. Meqëlehtësuesi do të donte të sigurohej, që pjesëmarrësit të fitojnë një njohuri të gjithanshme dhe sistematike të jetëve të Báb dhe Bahá'u'lláh, ndërkohë, që ata studiojnë njësitë, janë të vërtetat e thella shpirtërore, të cilat mund të qëmtohen nga episodet e përshkruara, të cilat kanë rëndësi primare.

Kur përgatitet të kalojë një grup përmes njësive dy dhe tre, atëherë lehtësuesi duhet t'u kushtojë vëmendje temave shpirtërore të trajtuara. Midis këtyre është, për shembull, që çdo i Ndriçuar Hyjnor nuk manifestohet në botën e njerëzimitsipas vetë zgjedhjes së Tij, por përmes Dëshirës së Perëndisë, dhe është i paisur prej Atij me dije të lindura; saqë të parët, që e njohin Pozitën e Tijthirren, që të kryejnë vepra të një heroizmi të pashoqvepra, të cilat dëshmojnëpër fuqinë transformuese të Besimit të Tij; që Ai pranon të durojë një jetë vuajtjeshme qëllim, që t'a udhëheqin njerëzimintek e vërtetadhe të bëjnë të njohur Vullnetin dhe qëllimin e Perëndisëtekkrijesate Tij; që asnjë forcë mbi tokë, sado e fuqishme, mund të ketë suksesnë zvogëlimin e influencës së Tijapo t'a ndalojë Atënga arritja e Misionit të Tij,me të cilin Ai është ngarkuar. Në lidhje me këtë, një koncept i rëndësishëm i trajtuarnë njësinë e tretëështë ai i krizës dhe fitores. Një i kuptuar i këtij koncepti—që çdo krizënë Kauzën e Perëndisëshërben tëçlirojënjë masë të freskët të fuqisë së vetë të brendshme—është thelbësore për të gjithë ata, që shkelin shtegun e shërbimit, jo vetëm që ata t'a vlerësojnë historinëe Besimit,por gjithashtu, qëata të mund të kontriubojnënë shpalosjen e tij të qëndrueshme në lagjet dhe fshatrat e tyre, një proces, i cili në mënyrë të pandryshueshme kalonpërmes një serie krizash dhe fitoresh.

Reflektimi mbi tema të tilla si këto do t'i ndihmojnë pjesëmarrësittë shquajnë në ngjarjet e shoqëruara me jetët e Báb·it dhe të Bahá'u'lláh·utngrohtësinë e dashurisë së Tyre për njerëzimindhe për karakterin e lartësuartë misioneve të Tyre të njëpasnjëshme. Do të shërbejë, që t'i afrojë zemrat e tyre më pranëManifestimit të Perëndisëdhe t'i bëjë të patundura hapat e tyrenë shtegun e shërbimitndaj Kauzës së Tij. Do të rrisë gjithashtu, kapacitetin e tyrepër të biseduar me të tjerëtrreth personittë Bahá'u'lláh·utdhe Revelacionit të Tij, një kapacitet, që ata e kanë zhvilluar qysh nga studimi i historisë së jetës së Tijnë Librin 2. Pasi, aftësia për të rrëfyer historinë e jetës së Tij dhejetën e Pararendësit të Tij në një mënyrë të tillë, që prek zemrat e dëgjuesvembështetet mbi gjithçka, mbi një të kuptuar të domethënies shpirtërore të ngjarjeve, që tregohen. Sigurisht, nevoitet gjithashtu shumë praktikë, dhe tutori duhet të sigurojë, që pjesëmarrësve t'u jepet mundësi e mjaftueshme,që t'i tregojnë njëri tjetrit episode nga jetët e Manifestimeve Binjake. Disa pjesëmarrësmund t'a bëjnë të mundur, që të prezantojnëatë çfarë ata janë duke nxënënë biseda,që ngjasin me miqtë dhe fqinjëtsi pjesë e një serievizitashnë shtëpitë e tyre. Për t'i ndihmuar ata në këto dhe raste të tjera, një broshurë vizatimeshme tekste të shkurtrapërfshihet në secilinprej dy njësive të historisë. Broshurat mund të kopjohen, sipas nevojës, apo mund të shkarkohen prej faqes publike të internetit të Insitutit Ruhi.

Është e rëndësishme të përmendet këtu, që ngjarjet e shoqëruara me jetët Manifestimeve Binjakejanë regjistruartek njësitë mësimoresipas datave Gregoriane,në të cilat ato ndodhën. Sot, përvjetorëte ngjarjeve më domethënësepërkujtohennë datat e tyre Bahá'í, duke ndjekur dispozitat e kalendarit Badí', dhe ekuivalentet e tyreGregorianemundet të ndryshojnë nga viti në vit. Tutorinuk është nevoja të hyjë në një diskutim mbi këtë çështje me anëtarët e grupit; ajo do të bëhet gradualisht e dukshme për ta ndërkohë, që ata marrin pjesë në

përkujtimin e Ditëve të Shenjtanë komunitetin e tyre. Me të vërtetë, gjatë këtyre dhe aktiviteteve të tjera kolektive, episode prej jetës së Manifesitimevedhe ditëve të hershme të Besimitrrëfehen shpesh, dhe kjo do t'i sigurojë pjesëmarrësit metë kuptuar të mëtejshëm për në rrethanat historike,që dhanë impulsin fillestar për proceset, që janë duke shpënë përparafshatin apo lagjen e tyre sot.

Madhështia e kësaj Dite

Qëllimi

Arritja e kuptimeve të brendshme
rreth rëndësisë së kësaj Dite
dhe premtimeve që ajo bart
për njerëzimin.

PJESA 1

Ne jemi të bekuar që jetojmë në një Periudhë shumë të veçantë, një Epokë të inauguruar prej dy Manifestimeve të Perëndisë, Bahá'u'lláh dhe pararendësi i Tij Báb, të Cilët u shfaqën për tëripërtëritur të gjitha gjërat e krijuara. Ne e shohim me sytë tanë se si forcat e çliruara nga këto Manifestime po ndryshojnë shoqërinë njerëzore – sesi një botë e vjetër po perëndon dhe një botë e re po ngrihet në vend të saj. Është sigurisht e vërtetë se vdekja e një bote sjell me vete vuajtje të patregueshme. Ne prekemi thellë nga këto vuajtje dhe trishtohemi nga shkatërrimi që ndodh rreth nesh, por nuk mposhtemi, sepse e dimë që bota po lëviz me shpejtësi drejt qytetërimit të lavdishëm që Bahá'u'lláh·u ka parashikuar.

Kjo është dita e Perëndisë. Të jetosh në Ditën e Perëndisë, është një bekim i pamasë, që nënkupton përgjegjësi të mëdha gjithashtu. Për ta vlerësuar këtë bujari e për tëpërmbushur detyrat tona me efikasitet, ne shpesh duhet të përsiatim rreth domethënies e madhështisë së kësaj Ditedhe të bëhemi të vetëdijshëm në rritje për qëllimin e Perëndisë për njerëzimin. Synimi i kësaj nënndarjeje, e cila është relativisht e shkurtër, është t'ju njohi ju me disa pasazhe nga Shkrimet Bahá'í që i referohen domethënies së epokës në të cilën jetojmë. Para se t'i studioni këto pasazhe dhe të reflektoni mbi kuptimin e tyre, do të ishte e dobishme të identifikoni me anëtarët e tjerë në grupin tuaj disa prej arritjeve që Perëndia ka synuar për njerëzimin sot:

Unifikimi i racës njerëzore në një familje universale është një prej objektivave që, siç e dimë,do të arrihet në këtë epokë. Përmendni disa të tjera?

_____

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 2

Bahá'u'lláh·u thotë:

"Me të vërtetë, Unë them, kjo është dita në të cilën njerëzimi mund të sodisë Fytyrën dhe të dëgjojë Zërin e të Premtuarit. Thirrja e Perëndisë është shpallur dhe drita e shëmbëlltyrës së Tij është ngritur mbi njerëzit. Çdo njeri duhet të fshijë nga tabela e zemrës së vet çdo gjurmë fjale të kotë dhe të shohë me mendje të hapur e të paanshme shenjat e Revelacionit të Tij, provat e Misionit të Tij dhe dëshmitë e lavdisë së Tij".[1]

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

   a. Në këtë Ditë, ne mund të shohim _____ dhe të dëgjojmë _____ e të Premtuarit.

b. _____ është shpallur dhe _____ e _____ së Tij është ngritur mbi ne.

c. Është detyra jonë të fshijmë nga _____ sonë çdo _____ , dhe të shohim me mendje të _____ e të _____ e Revelacionit të Tij, _____ e Misionit të Tij dhe _____ e lavdisë së Tij.

2. Cilat nga fjalit e mëposhtme janë fjali të kota që i pengojnë njerëzit ta njohin Bahá'u'lláh·un?

_____ Feja e prindërve të mi është e mirë sa duhet për mua.

_____ Njerëzimi ka nevojë për një pranverë shpirtërore.

_____ Feja është e mirë për ata që kanë nevojë për të.

_____ Feja s'është veçse burim konflikti, kështu që duhet ta zhdukim atë.

_____ Me sa shoh unë, të gjitha fetë janë pak a shumë njëlloj, kështu që nuk ka rëndësi se cilës prej tyre i përket.

_____ Perëndia e ka braktisur njerëzimin.

_____ Të gjitha gjërat duhen përtërirë, përfshi këtu edhe fenë.

_____ Shkenca provon se nuk ka Perëndi. Të gjitha problemet tona mund të zgjidhen nëse përdorim fuqinë e arsyes.

_____ Unë nuk dua t'i besoj asnjë feje.

_____ Nuk më duhet Feja për të qënë shpirtëror.

_____ Çdo individ duhet të jetë i lirë ta njohë Perëndinë sipas mënyrës së tij apo të saj.

_____ Çfarë nevojëka për një Manifestim?

_____ Ne kemi Shkrimet e Shenjta të fesë sonë. Nuk ka nevojë për një Manifestim të ri.

3. Cilat nga shenjat e mëposhtme janë shenjat e Lavdisë së Bahá'u'lláh·ut?

_____ Rrjedhshmëria e Ligjërimit të Tij.

_____ Fuqia depërtuese e Fjalës së Tij.

_____ Transformimi i zemrave të atyre që bien në kontakt me Shkrimet e Tij.

_____ Ndikimi që kanë Mësimet e Tij në mendimet dhe veprimet e njerëzve.

_____ Ndikimi që kanë Mësimet e Tij në rrjedhën e historisë.

_____ Madhështia e Vizionit të Tijpër të ardhmen e njerëzimit.

_____ Mundimet dhe fatkeqësitë që Ai duroi për hir të njerëzimit.

_____ Sovraniteti i Tij pavarësisht se ishte viktimë e shtypjes së fuqive tokësore.

_____ Fuqia e mësimeve të Tij për të bashkuar njerëzit e çdo race e bindjeje.

_____ Rritja e vazhdueshme e komunitetit të pasuesve të Tij.

_____ Fuqia e Besëlidhjes për të kapërcyer çdo pengesë dhe për të ruajtur unitetin e Kauzës së Tij.

_____ Madhështia e Rendit të Tij Administrativ.

_____ Mënyra sesi bota është duke lëvizur drejt asaj që Ai ka parashikuar.

PJESA 3

Bahá'u'lláh·u thotë:

"E madhe është me të vërtetë kjo Ditë! Aluzionet që janë bërë për të në të gjitha Shkrimet e shenjta si Dita e Perëndisë dëshmojnë për madhështinë e saj. Shpirti i çdo Profeti të Perëndisë, i çdo Lajmëtari Hyjnor, ka qenë i etur për këtë Ditë të mahnitshme. Edhe të gjitha fiset e ndryshme të tokës po kështu janë djegur nga dëshira për t'ia arritur kësaj Dite. Por, sapo Dielli i Manifestimit të Tij u shfaq në qiellin e Vullnetit të Perëndisë, të gjithë mbetën të shtangur e moskokëçarës, me përjashtim të atyre që Fuqiploti ka dashur t'i udhëheqë".[2]

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

   a. E _____ është me të vërtetë kjo Ditë! Aluzionet që janë bërë për të në të gjitha _____ e _____ si _____ e _____ dëshmojnë për _____ e saj.

   b. Shpirti i çdo _____ të Perëndisë, i çdo _____ _____ , ka qenë i _____ për këtë Ditë të _____.

   c. Edhe të gjitha _____ e _____ të tokës po kështu _____ për t'ia _____ kësaj Dite.

   d. Por, sapo Dielli i Manifestimit të Tij u _____ _____ , të gjithë mbetën të _____ e _____ _____ , me përjashtim të atyre që _____ ka _____ t'i _____ .

2. Nga citimet e mësipërme del qartë që kjo është dita e përmbushjes. Të gjithë Profetët dhe Lajmëtarët e Perëndisë e kanë parashikuar ardhjen e Ditës kur Paqja e Madhe do të vendosej mbi tokë. Bahá'u'lláh·u u referohet në pasazh atyre që, megjithëse të etur e në pritje për Ditën e premtuar, nuk e pranuan Atë kur Ai shpalli ardhjen e saj.Shumë imazhe na vijnë në mendje kur dikush mendon rreth shpirtrave që e njohin

Bahá'u'lláh·un. Mbushini secilin prej vendeve bosh me fjalën e duhur: zgjim, siguri, vetëdije, besim, shpresë.

a. Kalimi nga dremitja në _____

b. Kalimi nga pavëmendja në _____

c. Kalimi nga dëshpërimi në _____

d. Kalimi nga dyshimi në _____

e. Kalimi nga mosbesimi në _____

3. Si mendoni ju çfarë e bën një zemër të hapet ndaj Revelacionit të Bahá'u'lláh·ut?

PJESA 4

Bahá'u'lláh·u thotë:

"Kjo është Dita në të cilën favoret më të shquara të Perëndisë kanë reshur mbi njerëzit, Dita në të cilën hiri i Tij më i madh u është futur të gjitha gjëravetë krijuara. U bie për detyrë të gjithë popujve të botës të pajtojnë mosmarrëveshjet e tyre dhe, në bashkim e paqe të plotë, të gjejnë strehë nën hijen e Pemës së kujdesit e të dashamirësisë së Tij. Ata duhet të kapen pas gjithçkaje që, në këtë Ditë, ndihmonnë lartësimin e pozitës së tyre dhe u shërben interesave të tyre më të mira".[3]

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

a. Në këtë Ditë, _____ më të shquara të Perëndisë kanë _____ _____ mbi njerëzit.

b. Në këtë Ditë, _____ më i madh i Perëndisë është _____ në të gjitha gjërat e krijuara.

c. Të gjithë popujt e botës duhet të _____ dhe, në _____ e _____ të _____, të gjejnë strehë nën hijen e _____ së _____ e të _____ së Tij.

d. Popujt e botës duhet të kapen fort pas gjithçkaje që çon në _____ _____ e _____ së tyre dhe u _____ të tyre më të _____ .

2. Cilat janë disa nga "favoret më të çmuara" që Perëndia i ka dhuruar njerëzimit në këtë Ditë? _____

_____

_____

_____

_____

_____

3. Çfarëdo të thotë fjala "ndihmon"? _____

_____

4. Rendit ato gjëra që mund të bësh për t'u shërbyer interesave më të mira të njerëzimit.

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 5

Bahá'u'lláh·u thotë:

"Kjo është Dita kur Oqeani i mëshirës së Perëndisë iu shfaq njerëzve, Dita në të cilën Dielli i dashamirësisë së Tij ka derdhur mbi ta shkëlqimin e vet, Dita në të cilën retë e favoreve të Tij bujare kanë mbuluar gjithë njerëzimin. Tani ka ardhur koha për t'i ngazëllyer e për t'u dhënë zemër të dëshpëruarve me flladin gjallërues të dashurisë e të vëllazërisë dhe me ujërat e gjalla të miqësisë e të dhembshurisë".[4]

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

   a. Në këtë Ditë, Oqeani i _____ së Perëndisë iu _____ .

   b. Në këtë Ditë, Dielli i _____ së Tij ka _____ _____ e vet.

   c. Në këtë Ditë, retë e _____ të Tij _____ kanë _____ gjithë njerëzimin.

d. _____ ka ardhur koha për t'i _____ e për t'u _____ të dëshpëruarve me flladin gjallërues të _____ e të _____ dhe me ujërat e gjalla të _____ e të _____ .

2. Cilat nga këto që janë renditur më poshtë u japin zemër e i ngazëllejnë njerëzit?

_____ E drejta për t'u shkolluar.

_____ Rritja e kapacitetitpër t'u konsultuar.

_____ T'i shohësh me keqardhje.

_____ Vënia në përdorim e arritjeve të shkencës.

_____ Ushtrimi i forcës tërheqëse për të mbështetur parti a fraksione të ndryshme politike.

_____ Leximi dhe ndarja me të tjerët e Fjalës së Perëndisë.

_____ T'i bindësh ata të blejnë me kredi diçka që nuk u nevojitet.

_____ Të pasurit e një vetëdijemë madhe mbi rëndësinë e lutjes.

_____ kur marrin inkurajm për përpjekjet e tyre.

_____ T'i ndihmosh ata që t'u parashtrojnë autoriteteve shqetësimet e tyre në mënyrë

_____ elokuente e në rrugë ligjore.

_____ Marrja pjesë në lëvizjeproteste.

_____ Pirja e alkolit, për të harruar problemet e tyre.

_____ Marrja e përfitimeve nga një sistem kujdesi shëndetësor.

_____ Të paturit e një diskoteke aty pranë, ku ata mund të argëtohen.

_____ Njohja e Manifestimit të Perëndisë për kohën e sotme.

_____ Mbështetja në fuqinë e ndihmës hyjnore.

PJESA 6

Bahá'u'lláh·u thotë:

"Ekuilibri botëror është tronditur nga ndikimi drithërues i këtij Rendi Botëror madhështor e të ri. Jeta e organizuar e gjinisë njerëzore është revolucionarizuar nga veprimi i këtij Sistemi të pashoq, të mahnitshëm, të ngjashëm me të cilin sytë vdekshëm kurrë se kanë parë.

"Zhytuni në oqeanin e fjalëve të Mia, që të gjeni sekretet e tij dhe të zbuloni të gjithë margaritarët e urtisë që fshihen në thellësitë e tij. Kujdes se mos lëkundeni në vendosmërinë tuaj për të përqafuar të vërtetën e kësaj Kauze – Kauzë,

nëpërmjet së cilës potencialet e fuqisë së Perëndisë janë reveluar dhe sovraniteti i Tij është vendosur".[5]

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

   a. botëror është _____ nga _____ drithërues i këtij _____ e të ____.

   b. Jeta e _____ e gjinisë njerëzore është _____ nga veprimi i këtij _____ të _____, të _____.

   c. Ne duhet të _____ në _____ e fjalëve të Tij, që të _____ e tij dhe të _____ të gjithë margaritarët e _____ që fshihen në thellësitë e tij.

   d. Ne nuk duhet të _____ në _____ tonë për të përqafuar të _____ e kësaj Kauze.

   e. Kjo është Kauza nëpërmjet së cilës _____ e _____ së Perëndisë janë _____ dhe _____ i Tij është vendosur.

2. Çfarëdo të thotë fjala "ekuilibër"? _____

   _____

3. Çfarë e ka tronditur ekuilibrin botëror? _____

   _____

4. Cilat janë disa nga shenjat që tregojnë se bota e ka humbur ekuilibrin e saj? _____

   _____

   _____

   _____

   _____

   _____

5. Cilat janë disa nga shenjat që tregojnë se jeta e gjinisë njerëzore është revolucionarizuar? _____

   _____

   _____

   _____

   _____

6. Cili është "Sistemi i mahnitshëm" që i referohet Bahá'u'lláh·u? _____

_____

7. Si zhytemi ne në oqeanin e fjalëve të Bahá'u'lláh·ut? _____

_____

_____

8. Si ndikohen mendimet tona kur ne zhytemi në oqeanin e fjalëve të Tij? _____

_____

_____

_____

_____

9. Si ndikohen veprimet tona kur ne zhytemi në oqeanin e fjalëve të Tij? _____

_____

_____

_____

_____

10. Ku e gjejmë ne energjinë e duhur shpirtërore për të punuar për vendosjen e Rendit Botëror të Bahá'u'lláh·ut? _____

_____

11. Çfarëdo të thotë fjala "lëkundem"? _____

_____

12. Si ndikohet energjia jonë shpirtërore nëse ne jemi të lëkundur për të pranuar plotësisht të Vërtetën e Kauzës së Tij? _____

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 7

'Abdu'l-Bahá·i thotë:

O ju të dashurit e Zotit! Kjo ditë është dita e bashkimit, dita e mbledhjes së gjithë njerëzimit. 'Me të vërtetë Perëndia i do ata që, sikur të ishin një mur i fortë, luftojnë për Kauzën e Tij me radhë të shtrënguara'. Shihni sesi Ai thotë 'me radhë të shtrënguara' – domethënë të grumbulluar e të dyndur së bashku, të lidhur njëri pas tjetrit, duke mbështetur secili shokët e tij. Të luftosh, siç thuhet në vargun e shenjtë, në këtë më të madhin e dispensacioneve nuk do të thotë të shkosh përpara me shpatë e heshtë, me shtizë e shigjetë të mprehtë – por i armatosur me qëllime të pastra, me motive të drejta, me këshilla të dobishme e efektive, me atribute hyjnore, me vepra të pëlqyeshme për Fuqiplotin, me cilësi të qiellit. Kjo do të thotë edukim për mbarë njerëzimin, udhëheqje për të gjithë njerëzit, përhapje në të katër anët e shijeve të ëmbla të shpirtit, shpallje e provave të Perëndisë, paraqitje e argumenteve bindëse e hyjnore, kryerje veprash bamirëse".[6]

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

   a. 'Abdu'l-Bahá·i na thotë ne se kjo ditë është dita e _____, dita e _____ të gjithë _____ .

   b. Ai na shpjegon se Perëndia i _____ ata që, si të ishin një _____ , _____ për Kauzën e Tij me _____ të _____ .

   c. 'Abdu'l-Bahá·i na shpjegon se 'me radhë të shtrënguara' do të thotë _____ e _____ , _____ me njëri-tjetrin, duke _____ shoku-shokun.

   d. Ai na thotë se të luftosh për t'i shërbyer Kauzës në më të madhin e të gjitha _____ , nuk do të thotë të shkosh përpara me _____ e _____ , me _____ e _____ _____ , por i _____ me një _____ të _____ , me _____ të _____ , me _____ të _____ e të _____ , me _____ , me _____ të _____ për _____ , me _____ e _____ .

   e. Po kështu, të luftosh në këtë dispensacion do të thotë _____ për mbarë njerëzimin, _____ për të gjithë njerëzit, _____ kudo e _____ të _____ të _____ , _____ _____ e _____ të Perëndisë, _____ e _____ e _____ , _____ _____ .

2. Kjo është dita e bashkimit të gjinisë njerëzore. Për ta vlerësuar se sa madhështore është kjo detyrë, mendo për ndarjet e panumërta që përçajnë njerëzimin. Renditni këtu poshtë sa më shumë prej tyre. _____

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

3. Cila fuqi mund t'i mposhti të gjitha këto ndasi? _____
_____

4. Cila është natyra e luftës në të cilën jemi përfshirë? _____
_____

5. Cilat nga këto më poshtë janëmidis armëvetë përdorura në këtë luftë?

_____ Qëllim i pastër	_____ Zemërim
_____ Atribute hyjnore	_____ Bujari
_____ Motivet e pastra	_____ Fuqia e lutjes
_____ Dëshira për t'u bërë udhëheqës	_____ Vepra të lavdërueshme
_____ Arroganca e krenaria	_____ Dashuria e Perëndisë
_____ Pasioni për drejtësinë	_____ Dashuria për njerëzimin
_____ Avokati i vetes	_____ Besimi te Perëndia
_____ Pushkët, revolet	_____ Këshillat e dobishme e të efektshme
_____ Thikat	_____ Fuqia e Unitetit
_____ Fuqia e Fjalës së Perëndisë	_____ Paratë
_____ Vetëkënaqësia	_____ Besimi
_____ Kompleksi i madhështisë	_____ Përunjësia

6. Është e rregullt të kërkosh t'i dominosh të tjerët me qëllim që të vendosësh drejtësinë?

_____

7. Cilat nga këto që janë renditur këtu poshtë përfaqësojnë gjërat që ne bëjmë kur jemi të angazhuar në betejën shpirtërore për të bashkuar njerëzimin?

_____ Nxisim Shkollimin.

_____ I detyrojmë të tjerët të bëjnë si duam ne.

_____ Mësojmë Kauzën e Perëndisë.

_____ Shpallim Kauzën e Perëndisë.

_____ Ndahemi në fraksione sipas interesave tona.

_____ Luftojmë për interesat e grupit të cilit i përkasim.

_____ Kryejmë vepra bamirëse.

_____ Parashtrojmë argumenta bindës për të Vërtetën e Revelacionit të Bahá'u'lláh·ut.

_____ Zhytemi në oqeanin e Fjalëve të Tij.

_____ Shtypim të dobëtin e të mjeruarin.

_____ Lutemi me zjarr.

_____ Plaçkisim pronat e njerëzve.

_____ Grumbullojmë pasuri duke vjedhur të tjerët.

PJESA 8

Vetëdija e theksuar për madhështinë e kësaj Dite krijon tek të gjithë ne një dëshirë për t'u ngritur, për të mësuar Besimin, për të shërbyer dhe për të kryer vepra vetëmohuese. Kështu, për të mos e larguar vështrimin nga ngutësia me të cilën ju duhet të angazhoheni në veprime shërbimi për Kauzën, nguliteni në kujtesë pasazhin e mëposhtëm të marrë nga një letër e datës 28 janar 1939 e shkruar nga Ruajtësi:

> **"Nuk ka kohë për të humbur. Nuk ka vend për lëkundje. Mori njerëzish janë të uritur për Bukën e Jetës. Skena është bërë gati. Premtimi i sigurt e i parevokueshëm është dhënë. Plani i vetë Perëndisë është vënë në lëvizje. Ai po përshpejtohet nga ditë në ditë. Fuqitë e qiellit e të tokës mbështesin në mënyrë të mistershme zbatimin e tij. Një mundësi e tillë është e pazëvendësueshme. Le të ngrihet ai që dyshon dhe ta verifikojë vetë të vërtetën e këtyre pohimeve. Të përpiqesh, të këmbëngulësh, do të thotë të sigurosh fitoren e plotë e përfundimtare".**[7]

REFERENCAT

1. Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh·ut, Tiranë 1995, #7.

2. Po aty, #4

3. Po aty, #5

4. Po aty, #7

5. Po aty, #70

6. Pjesë të zgjedhura nga Shkrimet e 'Abdu'l-Bahá·it, Tiranë 2007, #207.

7. Nga një letër e datës 28 Janar 1939 botuar tek "Kjo Orë Vendimtare" shkruar nga Shoghi Effendi, drejtuar Bahá'í-ve të Amerikës Veriore, 1932-1946, (Wilmette, Bahá'í Publishing Trust, 2002), f. 28.

Jeta e Báb·it

Qëllimi

Të mësojmë se si të tregojmë historinë e jetës së Báb·it
dhe të arrijmë në një vlerësim për fuqinë
e Udhëheqjes së Tij të shkurtër e dramatike

PJESA 1

Dispensacioni i Báb·it filloi më 1844 dhe zgjati vetëm nëntë vjet. Qëllimi i tij parësor ishte të përgatiste rrugën për ardhjen e Bahá'u'lláh·ut. Ndonëse i shkurtër, Dispensacioni i Báb·it pati një intensitet kaq të jashtëzakonshëm shpirtëror, saqë efektet e tij do të ndihen për qindra breza të ardhshëm.

Báb·i, emri i të cilit ishte Siyyid 'Alí-Muḥammad, lindi më 20 tetor 1819 në Shíráz, një qytet në Iranin e jugut, të njohur edhe me emrin Persi. Shumica e njerëzve në Iran i përkasin atij sektit të Islamit që pret ardhjen e një të Premtuari të Perëndisë të quajtur Qá'im. Fjala "Qá'im" do të thotë "Ai që ngrihet".

Báb·i i përkiste një familjeje të shquar e fisnike që e kishte prejardhjen nga Muhameti, profeti i Islamit. Babai i Tij ndërroi jetë kur Ai ishte fëmijë i vogël, dhe Atë e rriti i ungji, që e çoi në shkollë në moshë fare të re. Megjithëse Báb·i ishte i pajisur me dije të lindura dhe nuk kishte nevojë ta mësonte ndonjë njeri, ai ia plotësoi dëshirën të ungjit. Megjithatë, mësuesit të Tij i ra menjëherë në sy aftësia e madhe e Báb·it dhe e kuptoi se ai nuk kishte çfarë t'i mësonte këtij fëmije të jashtëzakonshëm. Ai na ka lënë tregimin e mëposhtëm rreth kohës së jetës shkollore të Báb·it:

> "Një ditë i kërkova Báb·it të recitonte fjalët hyrëse të Kuranit… Ai ngurroi duke u shfajësuar që nëse Atij nuk do t'i thuhej se çfarë kuptim kishin ato fjalë, Ai kurrsesi nuk do të përpiqej t'i shqiptonte ato. Unë u hoqa sikur nuk e dija kuptimin e tyre. 'Unë e di se çfarë duan të thonë këto fjalë,' tha nxënësi im; 'me lejen tuaj unë do t'i shpjegoj ato.' Ai foli me një dije e rrjedhshmëri të tillë, saqë unë mbeta me gojë hapur…. Ëmbëlsia e të folurit të Tij ende kumbon në kujtesën time. E ndjeva veten të detyruar ta merrja e t'a çoja përsëri tek i ungji, për t'ia lënë atij në dorë kujdesin për Të, që ai m'a kishte besuar mua. Unë vendosa t'i tregoja atij se sa të paaftë e ndieja veten që të mësoja një fëmijë kaq të shkëlqyer. E gjeta ungjin e Tij vetëm në zyrë. 'E solla përsëri tek ti', i thashë, 'dhe po ta besoj Atë ty e mbrojtjes sate vigjilente. Ai nuk duhet trajtuar thjesht si një fëmijë, pasi tek Ai unë që tani mund të shquaj shenjat e asaj fuqie të mistershme të cilën mund ta zbulojë vetëm Revelacioni i Qá'imit. Tani është detyra jote që ta rrethosh Atë me kujdesin tënd më të madh dashamirës. Mbaje Atë në shtëpinë tënde, pasi Ai me të vërtetë nuk ka nevojë për mësues të tillë si unë.' I ungji e qortoi ashpër Báb·in. 'Po ti, i harrove udhëzimet e mia?' i tha ai. 'A nuk të këshillova unë që të ndiqje shembullin e moshatarëve të Tu, të rrije urtë e të dëgjoje me vëmendje çdo fjalë që thoshte mësuesi Yt?' Pasi mori nga Báb·i premtimin se Ai do t'i zbatonte me besnikëri udhëzimet e të ungjit, ai i tha Báb·it të kthehej në shkollë. Megjithatë, shpirti i atij fëmije nuk mund të frenohej nga qortimet e ashpra të të ungjit. Asnjë lloj disipline nuk mund të ndalte rrjedhën e dijes së Tij intuitive. Ditë pas dite Ai vazhdoi të shfaqte shenja të tilla të shkëlqyera mençurie mbinjerëzore saqë unë jam i paaftë t'i rrëfej".[1]

Më në fund i ungji i Báb·it vendosi ta lejojë Atë që të mos shkonte më në shkollë. Më vonë Ai filloi të punonte me të ungjin si tregtar në Búshihr, një qytet në juglindje të Shíráz·it. Pikërisht në këtë periudhë të jetës së Tij Báb·i u martua. Ai dhe gruaja e Tij patën një djalë me emrin Aḥmad, i cili vdiq që foshnjë, një vit përpara se Báb·i të deklaronte se Ai ishte Qá'imi i Premtuar.

Gjatë rinisë së Tij, Báb·i tregoi shenja të një fuqie e madhështie të tillë sa askush nuk mund të krahasohej me Të. Cilësitë e jashtëzakonshme që do ta shquanin gjatë gjithë Udhëheqjes së Tij të shpejtë e tragjike ishin tashmë të dukshme. Ruajtësi i referohet Atij si "personi i butë, rinor dhe i parezistueshëm i Báb·it, i pashoq në ëmbëlsinë e Tij, i patrazuar në qetësinë e Tij, magnetik në të folurin e Tij". Pjesët që vijojnë nuk mund të përshkruajnë veçse në mënyrë të pamjaftueshme ngjarjet e jetës së Tij. Megjithatë, edhe ky rrëfim i shkurtër duhet të ndezë në zemrat tona një shkëndijë nga zjarri i dashurisë që Ai ngjalli në zemrat e mijëra e mijëra ithtarëve në Persi e më gjerë .

1. Cili ishte emri i Báb·it? _____

2. Ku lindi Báb·i dhe në çfarë date? _____

_____

3. Çfarë do të thotë fjala "Qá'im"? _____

4. Prej nga rridhte familja e Báb·it? _____

_____

5. Kush mori përsipër ta rrisë Báb·in pasi ndërroi jetë i ati? _____

_____

6. Çfarë nënkupton thënia se Báb·i ishte i pajisur nga Perëndia me dije të lindura? ___

_____

7. Çfarë mendoi mësuesi i Báb·it kur i ra në sy aftësia e madhe e Tij? _____

_____

8. Çfarë do të thotë fraza "mençuri mbinjerëzore"? _____

_____

9. Çfarë bëri Báb·i pasi la shkollën? _____

_____

10. Me çfarë fjalësh i referohet Ruajtësi Báb·ít _____

_____

_____

_____

11. Shkruani me fjalët tuaja historinë e kohës së jetës shkollore të Báb·it, sipas rrëfimit të mësuesit të Tij.

PJESA 2

Para se Báb·i të deklaronte Misionin e Tij, disa njerëz në botë e dinin thellë në zemrat e tyre se i Premtuari do të shfaqej së shpejti. Njëri nga këta persona të shenjtë ishte SiyyidKáẓim, i cili jetonte në qytetin e Qerbelasë në Irak. SiyyidKáẓim·i kishte shumë studentë, dhe ia përkushtoi jetën e tij përgatitjes së tyre për ardhjen e shumëpritur të Qá'imit. Ai u thoshte vazhdimisht atyre se pas vdekjes së tij ata duhet të linin shtëpitë e tyre dhe, me zemra të çliruara nga të gjitha dëshirat tokësore, të shpërndaheshin në kërkim të të Premtuarit të Shumëdashur.

Pasi ndërroi jetë SiyyidKáẓim·i, një nga studentët e tij më të shquar, MulláḤusayn·i, shkoi në një xhami dhe u lut e meditoi dyzet ditë me radhë, gjatë të cilave ia hapi zemrën frymëzimit të Perëndisë. Ai u largua më pas nga Iraku bashkë me dy shokë dhe filloi kërkimin e tij. Në fillim shkoi në Bushehr.Megjithatë ai nuk qëndroi atje shumë kohë, sepse dukej që diçka e tërhiqte në mënyrë të parezistueshme nga veriu, drejtShírázit. Kur ju afrua qytetit, ai ukërkoi dy shoqëruesvetë tij të shkonin në një xhami të caktuar dhe ta prisnin aty që të bashkohej me ta atje.

Disa orë para perëndimit të diellit të po asaj dite, pikërisht jashtë portës së Shíráz·it, ai takoi një Person të ri i Cili i uroi mirseardhjen dhe e ftoi në shtëpinë e Tij për t'u çlodhur pas udhëtimit të tij të gjatë e të vështirë. Mullá Ḥusayn·it i bëri përshtypje të thellë mënyra e sjellshme e njëkohësisht bindëse, me të cilën foli ky i Ri i jashtëzakonshëm. Ai e ndoqi pas dhe shumë shpejt arritën te porta e një shtëpie të thjeshtë. Ata hynë brenda dhe u ulën në dhomën e sipërme. Mikpritësi i hijshëm porositi të sillnin një kabash me ujë në mënyrë që mysafiri i Tij të pastrohej nga pluhuri i rrugës. Pastaj Ai Vetë përgatiti çajin dhe ia ofroi atëMullá Ḥusayn·it.

Pas këtyre gjesteve të mikpritjes, Ai filloi të bisedonte me mysafirin e Tij. Hollësitë e asaj bisede historike i ka rrëfyer më vonë vetë Mullá Ḥusayn·i:

> "Dielli kish rreth një orë që kishte perënduar kur Mikpritësi im rinor filloi të bisedonte me mua. 'Cilin konsideroni ju më pyeti Ai, pas Siyyid Káẓim·it, si pasardhësin e tij dhe udhëheqësin tuaj?'. 'Në momentin që ai po jepte shpirt,' u përgjigja unë, 'mësuesi ynë i ndjerë na udhëzoi me këmbëngulje të linim shtëpitë tona dhe të shpërndaheshim anekënd në kërkim të të Premtuarit të Shumëdashur. Në përputhje me këtë, kam udhëtuar për në Persi, jam ngritur të përmbush amanetin e tij, dhe jam akoma i zënë me kërkimin tim. 'A ju ka dhënë mësuesi juaj,' pyeti Ai më tej, 'ndonjë tregues të hollësishëm në lidhje me tiparet dalluese të të Premtuarit?' 'Po,' u përgjigja, 'Ai ka racë të pastër, vjen nga një prejardhje e famshme, dhe nga fara e Fáṭime·s. Përsa i përket moshës së Tij, Ai është më shumë se njëzet dhe më pak se tridhjetë vjeç. Është i pajisur me dije të lindura. Është shtatmesëm, nuk pi duhan, dhe nuk ka të meta trupore'. Ai heshti për pak çaste dhe pastaj me zë të ngazëllyerdeklaroi: 'Shiko, të gjitha këto shenja janë të dukshme tek Unë!' Më pas Ai i shqyrtoi veç e veç të gjitha shenjat e mësipërme dhe demonstroi bindshëm se të gjitha pa përjashtim ishin të zbatueshme për personin e Tij".[2]

Gjatë asaj nate, Báb·i i demonstroi Mullá Ḥusayn·it, me prova të qarta e të pagabueshme, se Ai ishte Qá'imi i Premtuar. Ai reveloi, me shpejtësi të jashtëzakonshme, pjesën e parë të komentit të Tij për Suren e Jozefit, që është një kapitull i rëndësishëm i Kuranit. Pastaj iu drejtua Mullá Ḥusayn·it me këto fjalë:

> "O ti që je i pari që besove tek Unë! Me të vërtetë them, Unë jam Báb·i, Porta e Perëndisë, dhe ti je Bábu'l-Báb·i, porta e asaj Porte. Në fillim duhet që tetëmbëdhjetë shpirtra spontanisht dhe me pëlqimin e tyre, të më pranojnë Mua dhe të njohin të vërtetën e Revelacionit Tim. Pa i njoftuar e pa i ftuar, çdonjëri prej tyre duhet të kërkojë të më gjejë Mua në mënyrë të pavarur. Dhe kur numri i tyre të jetë plotësuar, njëri nga ata duhet të jetë i zgjedhuri që do të Më shoqërojë në pelegrinazhin Tim në Mekë dhe Medinë. Atje do t'i dorëzoj Sharíf·it të Mekës Mesazhin e Perëndisë. Pas kësaj do të kthehem në Kúfih, ku përsëri, në xhaminë e atij qyteti të shenjtë, do të shpall Kauzën e Tij. E ke për detyrë të mos ua bësh të ditur, as shoqëruesve të tu e as ndonjë shpirti tjetër, atë që ke parë e dëgjuar".[3]

Ky Revelacion i lavdishëm e mbushi shpirtin e Mullá Ḥusayn·it plot emocion e hare, admirim e respekt. "Sa i dobët e i pafuqishëm, sa i trishtuar e i drojtur, isha ndier më parë!" ka thënë ai më pas. "Në ato çaste nuk mundesha as të shkruaja e as të ecja, kaq të dridhur ishin duart e këmbëte mia. Por tani dija e Revelacionit të Tij e kishte elektrizuar qenien time. E ndieja veten të pushtuar nga një guxim e një fuqi e tillë, saqë edhe sikur bota, të gjithë popujt e të fuqishmit e saj, të ngriheshin kundër meje, unë i vetëm do t'i bëja ballë i paepur sulmit të tyre të furishëm. Universi më dukej veç një grusht pluhuri në dorën time. Më dukej vetja si Zëri i mishëruar i Gavrilit, që i bënte thirrje gjithë njerëzimit: 'Zgjohuni, se ja, Drita e mëngjesit ka zbardhur. Çohuni, se Kauza e Tij është shfaqur. Porta e hirit të Tij është hapur dykanatësh; hyni në të, o popuj të botës! Pasi Ai Që është i Premtuari juaj ka ardhur!'"[5]

Deklarimi i Báb·it u bë në prag të 23 Majit 1844. Ai ishte njëzet e pesë vjeç. Shumë vite më vonë, me rastin e përvjetorit të Deklarimit të Báb·it, 'Abdu'l-Bahá·i iu drejtua me këto fjalë një grupi besimtarësh:

"Ky është 23 Maji, përvjetori i mesazhit dhe i Deklarimit të Báb·it. Është një ditë e bekuar dhe agimi i manifestimit, sepse shfaqja e Báb·it ishte si rrezet e para të mëngjesit të vërtetë, … është një ditë e bekuar, zanafilla e bujarisë qiellore, fillesa e rrëzëllimit hyjnor. Në këtë ditë më 1844 Báb·i u dërgua për të lajmëruar e shpallur Mbretërinë e Perëndisë, për të njoftuar lajmin e gëzuar të ardhjes së Bahá'u'lláh·ut, duke i bërë ballë kundërvënies së mbarë kombit Persian".[5]

1. Çfarë u tha Siyyid Kázim·i nxënësve të tij të bënin pas vdekjes së tij? _____

_____

_____

2. Çfarë bëri Mullá Husayn·i pas ndërrimit jetë të Siyyid Kázim·it? _____

_____

_____

3. Nga e dinte Báb·i që Mullá Husayn·i kishte arritur në Shíráz? _____

_____

4. Çfarë pyetjesh i bëri Báb·i Mullá Ḥusayn·it pasi ata arritën në shtëpinë e Tij? _____

_____

_____

_____

_____

5. Çfarë shenjash u dha Siyyid Kázim·i nxënësve të Tij që i përkisnin personit të Qá'im·it?

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

6. Vajza e kujt është Fatimeja dhe çfarë do të thotë të jesh "nga fara e saj"? _____

_____

7. A i zotëronte Báb·i cilësitë që po kërkonte Mullá Ḥusayn·i? _____

_____

8. Çfarë do të thotë titulli "Báb"? _____

_____

9. Çfarë titulli i dha Báb·i Mullá Ḥusayn·it? _____

_____

10. Çfarë do të thotë ky titull? _____

_____

11. Çfarë do të ndodhte përpara se Báb·i do të shpallte hapur Kauzën e Tij? _____

_____

_____

12. Shprehni me fjalët tuaja atë çfarë tha Mullá Husayn·i rreth natës së paharrueshme gjatë së cilës ai arriti të njihte Qá'im·in e premtuar.

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

13. Kur ndodhi Deklarimi i Báb·it? _____

_____

14. Çfarë moshë kishte Báb·i kur bëri Deklarimin e Tij? _____

_____

PJESA 3

Pas MulláḤusayn·it, shtatëmbëdhjetë persona të tjerë kërkuan dhe gjetën në mënyrë të pavarur Dëshirën e Zemrës së tyre, Báb·in. Secili prej tyre u udhëhoq nga Perëndia për të njohur

të vërtetën e Revelacionit të porsalindur, disa nëpërmjet vegimeve dhe ëndrrave, disa përmes lutjes, dhe të tjerë gjatë çasteve të përsiatjes. Të gjithë, me përjashtim të njërit, arritën në praninë e Báb·it në Shíráz. Personi që nuk arriti ta takonte Atë ishte një grua e pashoqe dhe e talentuar që quhej Ṭáhirih. Ajo arriti të mësonte për Báb·in përmes një ëndrre, e njohu Atë si të Premtuarin e Shumëdashur dhe u bë një mbështetëse e madhe e Kauzës së Tij. Personi i tetëmbëdhjetë që u bashkua me radhët e pasuesve të Tij ishte një djalë i ri njëzet e dy vjeçar i njohur me emrin Quddús. Ndonëse i ri në moshë, Quddús·i zotëronte një karakter shembullor dhe një guxim e besim që pak vetë mund ta kishin. Këta besimtarë të parë, së bashku me MulláḤusayn·in, u shpallën nga Báb·i si tetëmbëdhjetë "Shkronjat e të Gjallit".

Pak kohë pasi numri i Shkronjave të të Gjallit ishte plotësuar, Báb·i thirri Mullá Ḥusayn·in në praninë e Tij dhe i dha udhëzimet e mëposhtme:"Ditëve të shoqërimit tonë po u vjen fundi. Besëlidhja Ime me ty tashmë është përmbushur. Bëhu gati dhe ngrihu për të përhapur Kauzën Time. Mos u druaj duke parë degjenerimin e zvetënimin e këtij brezi, sepse Zoti i Besëlidhjes me siguri do të të mbështesë. Me të vërtetë, Ai do të të rrethojë me mbrojtjen e Tij dashamirëse, dhe do të të prijë nga fitorja në fitore. Ashtu si reja që resh bekimin e saj mbi tokën, përshko anembanë vendin dhe resh mbi njerëzit e tij bekimet me të cilat Fuqiploti, me mëshirën e Tij, ka denjuar të të dhurojë…. Në këtë pelegrinazh ku do të nisemi së shpejti, Ne kemi zgjedhur Quddús·in si shoqëruesin Tonë. Ne të kemi lënë ty mbrapa për të përballur sulmin e furishëm të një armiku të egër e të pamëshirshëm. Por të jesh i sigurt se një bekim i lavdishëm që s'mund të përshkruhet do të të jepet ty. Merr rrugën drejt veriut dhe vizito gjatë udhëtimit tënd Iṣfáhánin, Káshánin, Qum dhe Tiḥránin. Përgjëroju Perëndisë fuqiplotë që me dashamirësi të bëjë të mundur të arrish, në atë kryeqytet, selinë e sovranitetit të vërtetë dhe të hysh në banesën e të Shumëdashurit. Një sekret qëndron i fshehur në atë qytet. Kur të shfaqet, do ta shndërrojë botën në parajsë. Unë Shpresoj që ti të marrësh nga hiri i tij dhe të njohësh shkëlqimin e tij".[7]

Pasi i dha MulláḤusayn·it udhëzimet për të shkuar në Ṭihrán, Báb·i mblodhi në praninë e Tij Shkronjat e tjera të të Gjallit dhe i caktoi secilit prej tyre nga një mision të posaçëm. Në fjalën e Tij të ndarjes, Ai u bëri thirrje të linin mënjanë çdo dëshirë tokësore dhe të përhapeshin anekënd për të shpallur Kauzën e Tij. Ai iu drejtua atyre duke ju thënë:

> **"O miqtë e Mi të shumëdashur!Ju jeni bartësit e emrit të Perëndisë në këtë Ditë.Ju jeni zgjedhur si personat e besuar të misterit të Tij. Duhet, që secili prej jush të shfaqivetitë e Perëndisë, dhe të ilustroni përmes veprave dhe fjalëve tuajashenjat e drejtësisë së Tij, fuqinë dhe lavdinë e Tij. Vetë Gjymtyrëte trupit tuajduhet të dëshmojnëpër lartësinë e qëllimit tuaj, ndershmërinë e jetës suaj, realitetin e besimit tuaj, dhe karakterin e lartësuartë përkushtimit tuaj. Pasi me të vërtetë unë them, kjo është Dita e shprehur nga Perëndia në Librin e Tij: 'Në atë ditë Ne do të vëmë një vulë në gojët të tyre; e për më tepërduart e tyre do të flasin për Ne, dhe këmbët e tyre do të dëshmojnë për atë që ata kanë bërë.' Peshonifjalët eJezusitdrejtuardishepujve të Tij,ndërkohë që Ai i nisi tëpërhapninKauzën e Perëndisë.Me fjalë të tilla si këto, Ai i urdhëroiata, të ngrihendhe të përmbushin misionin e tyre: 'Ju jenitamam si zjarri,që në errësirëne natësështë ndezur në majën e malit. Lëreni dritën tuaj të shkëlqejë përpara syve të njerëzve. E tillë duhet të jetë pastërtia e karakterit tuajdhe niveli i dorëheqjes tuaj, që njerëzit e tokëstë mund të njohin përmes jushdhe t'i qasen më pranë Atit qiellor,i cili është burimi i pastërtisëdhe i mirësisë. Pasi askush nuk e ka parë Atin, që është në qiell. Ju të cilët jenifëmijët e tij shpirtërorëduhet përmes veprave tuajat'i bëni shembull virtytet e Tij, dhe të dëshmoni për lavdinë e Tij. Ju jeni kripa e tokës, por**

nësekripa e ka humbur shijen e vetë, me çfarëdo të kripet ajo? E tillë duhet të jetë shkalla e shkëputjes suaj, që në çfarëdoqyteti, që hyni për të shpallur dhe për të mësuarKauzën e Perëndisë, ju nuk duhet në asnjë mënyrëtë prisni as mish apo shpërblimnga njerëzit e tij. Përkundrazi, kur ju të largoheni prej atij qyteti, ju duhet t'a shkundni pluhurinprej këmbëve tuaja. Ashtu siç hytë në tëpastër dhe të panjollë, kështu duhet të largoheni junga ai qytet. Pasi Unë flas të vërtetën, Ati qiellor është gjithmonë me judhe sytë i mban tek ju. Nëse ju i jeni besnikë Atij, Ai me siguri do t'i furnizojë duart tuaja metë gjitha thesaret e tokës, dhe do t'u lartësojë juvembi të gjithë sundimtarëtdhe mbretërit e botës.' O Shkronjat e Mija! Flas të vërtetën, pafundësisht e lartësuarështë kjo Ditë mbi ditët e Apostujve të së Shkuarës. Madje, i pamatë është dallimi! Ju jeni dëshmitarëtë Agimittë Ditës së premtuar të Perëndisë. Ju jenipjesëmarrësit ekupës mistiketë Revelacionit të Tij. Shtroni këllqet e përpiquni, dhe mbani në mend fjalët e Perëndisësiç janë zbuluar nëLibrin e Tij: 'Hap sytë, Zoti,Perëndia ytka ardhur, dhe me Të është shpura e engjëjve të Tijtë rreshtuar përpara Tij!' Zbrazini zemrat prejdëshirave të botës, dhe le të jenë virtytet engjëllorestolia juaj. Përpiquni, që përmes bëmave tuaja të mund të dëshmoni për vërtetësinëe këtyre fjalëve të Perëndisë, dhe hapni sytë se mos, duke 'u kthyer mbrapsht,' Ai mund 't'u shkëmbejë ju me njerëz të tjerë,' të cilët 'nuk do të jenë të njëjtë me ju,' dhe që do t'u marrin nga duart Mbretërinë e Perëndisë.Kanë marrë fund ditët kur adhurimi i plogët mendohej të ishte i mjaftueshëm. Ka ardhur koha kurasgjë përveç motivit më të pastër, i mbështetur prej veprave të pastërtisë së panjollë, mund të ngjiten për tek fronii Më Të Lartitdhe të jenë të pranueshme për Atë. 'Fjala e mirë ngrihet për tek Ai, dhe vepra e drejtëdo t'a bëjë atëtë lartësohet përpara Atij.' Ju jeni modestët, për të cilët Perëndiaështë shprehur kështu në Librin e Tij: 'Dhe Ne dëshirojmë të favorizojmë ata, të cilëtu përulën në dynja, dhe t'i bëjmë ataudhëheqës shpirtërorëmidis njerëzve, dhe t'i bëjmë ata trashëgimtarët tanë.' Ju jeni thirrur për këtë pozitë; ju do të arrini tek ajo, vetëm nëse ju ngriheni të shkelni nën këmbët tuaja çdo dëshirë tokësore, dhe përpiqenitë bëheni ata 'shërbëtorë të nderuartë Tij,të cilët nuk flasinderisa të ketë folur Aidhe të cilët bëjnë sipas urdhrit të Tij.' Ju jeni Shkronjat e para,që jeni gjeneruar nga Pika Kryesore, Burimet e para,që kanë gufuar prej Gurrës së këtij Revelacioni. PërgjërojuniZotit,Perëndisë tuajt'u garantojë, që asnjë ngatërresë tokësore, asnjë ndikim i botës, asnjë aktivitet jetëshkurtër, të mund të njollosi pastërtinë, apo të hidhësojëëmbëlsinë, e asaj mirësie,e cila rrjedhpërmes jush. Po ju përgatis juve për ardhjen e një Dite të madhe. Ushtroni përpjekjen tuaj maksimale,qënë botën që do të vijë, Unë, që jamtaniduke ju udhëzuar juve, mundem, përparafronit të mëshirshëm të Perëndisë, të gëzohem me veprat tuajadhe të lëvdohem në arritjet tuaja. Sekreti i Ditës, që ka për të ardhur është i fshehur tani. Ajo as mund të zbulohetapo të vlerësohet. Foshnja e sapolindure asaj Diteja kalon njerëzve më të zgjuar dhe më të respektuar të kësaj kohe, dhe më i përunjuri dhe më i pa mësuari i asaj kohedo t'ja kalojë në të kuptuar më dijetaritdhe teologëve më të arrirëtë kësaj epoke. Shpërndahuni gjithandej kryq e tërthor kësaj toke, dhe me këmbë të palëkundurae zemra të shenjtëruara, pregatisni rrugën për ardhjen e Tij. Mos j'au u vini veshin dobësive dhe brishtësisë tuaj; fiksojeni vështrimin tuaj tek fuqia e pamposhtur e Zotit, Perëndisë tuaj, të Githëfuqishmit. A nuk bëri Ai, në ditët e lashta, që Abrahami, me gjithë pafuqinë e tij në dukje, të triumfontembi forcat e Nimrodit? A nuk e mundësoi Ai që Moisiu, kërraba e të cilitishte shoku i Tij i vetëm, tënënshtronteFaraonindhe ushtritë e tij? A nuk ngriti Aipushtetin e Jezusit, të varfër dhe të përunjursiç ishtenë sytë e njerëzve, mbi forcat e

bashkuara të Hebrenjve? A nuk ja ka nënshtruar Ai fiset barbare dhe ushtarake të Arabisëdisiplinës së shenjtë dhe transformuese të Muḥametit, Profetit të Tij? Ngrihuni me emrin e Tij, vendoseni besimin tuajplotësisht tek Ai, dhe të jeni të sigurt për fitoren përfundimtare."[7]

1. Çfarë titull iu dha Báb·i besimtarëve të parë që e njohën Atë si të Premtuarin? _____

_____

2. Sa ishin ata? _____

_____

3. Kush qe i pari që njohu Báb·in? _____

_____

4. Kush qe Shkronja e fundit e të Gjallit? _____

_____

5. Si u udhëhoqën Shkronjat e të Gjallit për të njohur të vërtetën e Revelacionit të Báb·it?

_____

_____

_____

6. Kush nga Shkronjat e të Gjallit nuk arriti në praninë e Báb·it? _____

_____

7. Pak kohë pasi numri i Shkronjave të të Gjallit u plotësua, Báb·i thirri Mullá Ḥusayn·in në praninë e Tij dhe i dha udhëzimet e mëposhtme: "Ditëve të _____ tonë po u _____. _____ Ime me ty tashmë është _____. _____ dhe _____ për të përhapur _____ Time. Mos u _____ duke parë _____ dhe _____ e këtij _____, sepse _____ i _____ me _____ do të të _____. Me të vërtetë, Ai do të të _____ me _____ e Tij dashamirëse, dhe do të të prijë nga _____ në _____. Ashtu si _____ që resh bekimin e saj mbi tokën, _____ anembanë vendin dhe _____ mbi njerëzit e tij _____ me të cilat _____, me mëshirën e Tij, ka denjuar të të dhurojë".

8. Kë zgjodhi Báb·i për ta shoqëruar Atë në pelegrinazh? _____

_____

9. Çfarë rruge i tha Báb·i Mullá Ḥusayn·it të merrte në udhëtimin e tij? _____

_____

_____

10. Çfarë shprese shprehu Ai për Mulla Husayn? _____

_____

_____

11. Ju mund të dëshironi të mësoni përmendësh të paktën pjesë të fjalëve që Báb·i u drejtoi Shkronjave të së Gjallit.

PJESA 4

Në tetor 1844 Báb·i, i shoqëruar nga Quddús·i, u nis për pelegrinazhin e Tij në Mekë e Medinë. Këta dy qytete që ndodhen në Arabi janë të shenjtë për pasuesit e Islamit. Gjatë qëndrimit në Mekë, Báb·i i shkroi një letër Sherifit të qytetit. Në atë letër Ai shpjegonte qartë misionin e Tij dhe i bënte thirrje Sherifit të pranonte Kauzën e Tij. Por Sherifi, që ishte i zënë me punët e veta, nuk iu përgjigj Lajmëtarit Hyjnor. Nga Meka, Báb·i shkoi me shoqëruesin e Tij në Medinë, ku ruhen eshtrat e Profetit Muhamet. Pasi vizituan atë qytet të shenjtë, ata morën rrugën e kthimit në Persi. Me të mbërritur në Bushir, Báb·i thirri në praninë e Tij Quddús·in dhe e udhëzoi atë me këto fjalë të nisej për në Shíráz:

"Ditëve të shoqërimit tënd me Mua po u vjen fundi. Ora e ndarjes ka ardhur, një ndarje që nuk do të pasohet nga asnjë ribashkim veç atij në Mbretërinë e Perëndisë…. Në rrugët e Shíráz·it shumë fyerje do të të bien mbi kokë, dhe trupi yt do t'i nënshtrohet vuajtjeve më të rënda. Ti do të mbijetosh përballë sjelljes poshtëruese të armiqve të tu dhe do të arrish në praninë e Atij Që është objekti i vetëm i adhurimit e i dashurisë sonë. Në praninë e Tij ti do t'i harrosh të gjitha të këqjat e fatkeqësitë që do të të kenë ndodhur. Ushtritë e të Padukshmit do të nxitojnë për të të mbështetur dhe do t'i shpallin gjithë botës heroizmin e lavdinë tënde. Do të jetë yti gëzimi i parrëfyeshëm që ke pirë kupën e martirizimit për hir të Tij. Edhe unë do të ndjek shtegun e sakrificës, dhe do të takohem me ty në mbretërinë e përjetësisë".[8]

1. Kur u nis Báb·i për pelegrinazh? _____

_____

2. Cilat qytete vizitoi Báb·i gjatë pelegrinazhit të Tij? _____

_____

3. Kujt i shkroi Ai në Mekë? _____

_____

4. Pse Medina është qytet i shenjtë për myslimanët? _____

_____

5. Në rreshtat më poshtë, shkruani çfarë i tha Báb·i Quddús·it kur arritën në Bushehr.

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

6. Cilin do të takonte Quddús·i sipas premtimit që i bëri Báb·i? _____

_____

PJESA 5

Në Shiráz, Quddús·i filloi të mësonte Mesazhin e ri me zell të madh. Por shumë shpejt ai hasi në kundërshtimin e klerikëve myslimanë dhe të guvernatorit të krahinës. Guvernatori, një njeri mizor e plot ligësi, urdhëroi arrestimin e Quddús·it dhe të njërit prej shoqëruesve të tij. Ai dha urdhër që t'u digjeshin mjekrrat, t'u shpoheshin hundët, në vrimat e tyre t'u shkohej një litar dhe me këtë litar t'i tërhiqnin nëpër rrugët e qytetit që t'i shikonin të gjithë njerëzit. "Do të jetë një shembull i mirë për popullin e Shiráz·it," – thuhej në dekretin e guvernatorit, "që kështu gjithkush ta marrë vesh se cili është dënimi për herezi". Pasi iu desh të pësonin këto poshtërime, Quddús·i dhe shoqëruesite tij u dëbuan nga qyteti, me paralajmërimin që nëse do të përpiqeshin të ktheheshin aty, do t'i dënonin me vdekje. Me vuajtjet e tyre, këta dy shpirtra heroikë patën nderin të jenë të parët që u persekutuan në Persi për hir të Besimit të tyre të ri. 'Abdu'l-Bahá·i i referohet me këto fjalë atyre mijëra njerëzve që u persekutuan më pas në shtegun e të Shumëdashurit të tyre, Báb·it:

> **"… ata vuajtën vështirësitë më të rënda dhe sprova të ashpra. Ata u bënë ballë sprovave me një fuqi të mahnitshme dhe heroizëm sublim. Me mijëra u burgosën, u dënuan, u persekutuan dhe u martirizuan. Shtëpitë e tyre u plaçkitën e u shkatërruan, pronat e tyre u konfiskuan. Ata sakrifikuan jetën e tyre me gatishmëri të plotë dhe qëndruan të patundur deri në fund në besimin e tyre. Këta shpirtra të mahnitshëm janë llambat e Perëndisë, yjet e shenjtërisë që ndriçojnë lavdishëm mbi horizontin e përjetshëm të vullnetit të Perëndisë".**[10]

Pasi kishte urdhëruar një dënim kaq të padrejtë për Quddús·in dhe shokun e tij, guvernatori e zbrazi mërinë e tij mbi Báb·in. Ai urdhëroi rojet e tij të kalëronin deri në Bushehr, me udhëzimin që ta arrestonin Báb·in dhe ta sillnin në Shíráz të lidhur me zinxhirë. Ndërkohë, Báb·i ishte nisur nga Bushehri për në Shíráz. Në një vend të shkretë midis këtyre dy qyteteve e arriti Atë shpura e guvernatorit. Shumë kohë më vonë, prijësi i shpurës ka rrëfyer historinë e atij takimi:

> "Kur ne iu afruam, ai na përshëndeti dhe na pyeti se për ku ishim nisur. Unë mendova se do të qe më mirë t'ia fshihja të vërtetën, dhe i thashë se guvernatori na kishte urdhëruar të bënim disa hetime në atë zonë. Ai me një buzëqeshje më tha: 'Guvernatori ju ka dërguar që të më arrestoni Mua. Ja ku jam; bëni si të doni me Mua. Duke ardhur që t'ju takoj, ju kam shkurtuar distancën e rrugës që duhej të bënit, dhe jua kam bërë më të lehtë të Më gjeni'. Unë u befasova nga fjalët e tij e u mahnita nga çiltërsia dhe ndershmëria e tij. Megjithatë, nuk arrija ta shpjegoja gatishmërinë e tij për t'iu nënshtruar, me dëshirën e tij, disiplinës së ashpër të zyrtarëve të qeverisë, duke rrezikuar kështu sigurinë dhe jetën e tij. Unë u përpoqa të mos ua vija veshin fjalëve të tij dhe po bëhesha gati të largohesha, kur ai m'u afrua dhe më tha: 'Betohem për drejtësinë e Atij që ka krijuar njeriun, që e dalloi atë nga pjesa tjetër e krijesave të Tij, dhe që e bëri zemrën e tij selinë e sovranitetit e të dijes së Vet, se gjatë gjithë jetës Sime nuk kam nxjerrë nga goja fjalë tjetër veç së vërtetës, dhe nuk kam pasur dëshirë tjetër veç mirëqenies e përparimit të njerëzve. E kam përçmuar rehatinë Time dhe kurrë nuk jam bërë shkak vuajtjesh apo hidhërimi për askënd. E di që po më kërkoni Mua. Preferoj t'ju dorëzohem juve, sesa të bëhem shkak mërzie të panevojshme për ty e për shokët e tu'. Këto fjalë më prekën thellë. Instinktivisht zbrita nga kali dhe, duke i puthur yzengjitë, iu drejtova me këto fjalë: 'O dritë e syve të Profetit të Perëndisë! Të përgjërohem, për Atë që të ka krijuar dhe të ka pajisur me një fisnikëri e fuqi të tillë, të plotësosh kërkesën time dhe t'i vësh veshin lutjes sime. Të lutem me gjithë shpirt të largohesh nga ky vend dhe të ikësh sa më larg guvernatorit të pashpirt e të urryer të kësaj krahine. Unë u druhem intrigave të tij kundër teje. Mua më hipën gjaku në kokë kur mendoj që jam vegël e qëllimeve të tij keqdashëse kundër një pasardhësi kaq të pafajshëm e fisnik të Profetit të Perëndisë…' Përgjërimeve të mia ai u dha këtë përgjigje: 'Zoti, Perëndia yt të shpërbleftë për shpirtmirësinë dhe qëllimin tënd fisnik. Askush nuk e di misterin e Kauzës Sime; askush nuk mund të depërtojë në sekretet e saj. Asnjëherë Unë nuk do t'i kthej shpinën urdhrit të Perëndisë. Vetëm Ai është kështjella Ime e sigurt, Mbështetja Ime dhe Streha Ime. Deri sa të vijë ora Ime e fundit, askush nuk mund të Më sulmojë, askush nuk mund të pengojë planin e Fuqiplotit. Dhe kur të ketë ardhur ora Ime, sa i madh do të jetë gëzimi Im të pi kupën e martirizimit në emër të Tij! Ja ku Më ke; Më dorëzo në duart e padronit tënd. Mos u frikëso, sepse askush nuk do të ta hedhë fajin ty'. Unë u binda dhe ia plotësova dëshirën".[11]

Báb·i menjëherë vazhdoi rrugën për në Shíráz. I lirë e i palidhur me zinxhirë, Ai eci para rojeve, të cilët e ndiqnin pas me respekt.Me të mbërritur në Shíráz, Báb·in e çuan te guvernatori, i cili e trajtoi me një mizori të paturpshme. Ai e qortoi dhe e kritikoi Báb·in në sy të të gjithëve. Pastaj e la Atë nën kujdestarinë e të ungjit. Megjithëse Báb·i u lejua të kthehej në shtëpinë e Tij, liria e Tij ishte e kufizuar. Vetëm anëtarët e familjes dhe pak veta të tjerë lejoheshin ta vizitonin. Megjithatë, me kalimin e disa muajve, pavarësisht nga përpjekjet e guvernatorit dhe të klerikëve për t'i dhënë fund ndikimit të Tij, numri i pasuesve të Tij u shtua me shpejtësi.

Fama e Báb·it u rrit kaq shumë sa Mbreti dërgoi një nga dijetarët më të besuar e më të ditur në Shíráz në mënyrë që të hetonte situatën. Mik në shtëpinë e vetë guvernatorit, dijetari, i cili do të njihej më vonë si Vaḥíd, u takua me Báb·in në tre raste. I vendosur në çdo kohë për të refuzuar argumentet e Báb·it, ai u rrit gjithnjë e më shumë duke u mahnitur me dijen, elokuencën dhe urtësinë e Tij. Në takimin e tretë, Vaḥíd u bind krejtësisht mbi Rangun hyjnor të të Riut. Më vonë, duke iu referuar takimeve të tij me Báb·in, Vaḥídi shpjegoi se ai u ndjei përulur si "pluhuri nën këmbët e Tij". Vaḥídi menjëherë dërgoi një raport të shkruar oborrit të mbretit dhe sipas instruksioneve të Báb·it u largua nga Shíráz·i. Që nga ajo ditë, ai i dedikoi energjitë e tijnë mbështetje të Kauzës së Tij dhe e vendosi jetën e tij në shtegun e të Shumëdashurit të Tij.

Bashkë me rritjen e fuqisë dhe famës së Báb·it, u rrit edhe inati i guvernatorit dhe ai përsëri urdhëroi arrestimin e Tij. Këtë herë guvernatori kishte ndërmend t'a ekzekutonte Báb·in dhe ai dërgoi një oficer t'a kapte atë në shtëpinë e ungjit të Tij në mes të natës. Por atë natë në Shíráz shpërtheu murtaja dhe i gjithë qyteti u rrëmbye nga paniku. Brenda pak orësh rreth njëqind veta vdiqën nga sëmundja e llahtarshme. Ulëritje dhimbjesh dhe tmerri mund të dëgjoheshin në rrugë, dhe banorët e qytetit po ja mbathnin në rrëmujë. I pasigurt se çfarë të bënte oficeri i policisë e çoi Báb·in në shtëpinë e tij. Ai u mërzit shumë kur mësoi në mbrritje, se djali i tij po vdiste nga sëmundja. I ligështuar ai u hodh tek këmbët e Báb·it dhe ju përgjërua t'a falte. Kur djali i tij u shërua në mënyrë të mrekullueshme nga Báb·i, e njohu Dorën e Perëndisë në shpërthimin e murtajës dhe iu lut guvernatorit që ta lironte Báb·in. Duke pasur frikë për jetën e familjes së tij dhe të banorëve të qytetit, guvernatori pranoi, por me kusht që Báb·i të largohej nga Shíráz·i.

Në vjeshtë të vitit 1846 Báb·i u nis për në Iṣfáhán, një qytet në veri tëShíráz·it. Ndërsa po i jepte lamtumirën të ungjit, Ai i tha atij: "Unë do të të takoj ty sërish midis maleve të Ádhirbáyjánit, prej nga ku Unë do të të dërgoj për të marrë kurorën e martirizimit. Unë Vetë do të vij pas teje, bashkë me njërin nga dishepujt e Mi besnikë, dhe do të bashkohem me ty në mbretërinë e përjetësisë".[12]

1. Çfarë bëri Quddús·i kur arriti në Shíráz? _____

_____

2. Kush iu kundërvu Quddús·it kur ai filloi të mësonte Besimin e ri në Shíráz? _____

_____

3. Çfarë do të thotë fjala "klerikë"? _____

_____

4. Çfarë fjalësh e përshkruajnë karakterin e guvernatorit të Shíráz·it? _____

_____

5. Çfarë ndëshkimi urdhëroi guvernatori për Quddús dhe dy shoqëruesit e tij? _____

_____

_____

6. Çfarë do të thotë fjala “herezi”? _____

_____

7. Pasi i dëboi Quddús·in dhe dy shoqëruesit e Tij nga Shíráz·i, çfarë i udhëzoi Guvernatori të bënin më pas rojet e tij _____

_____

8. Çfarë po bënte Báb·i kur e takuan rojet? _____

_____

9. Báb·i i tha udhëheqësit të rojeve që ishte dërguar t’a arrestonte Atë: “_____ ju ka _____ juve që të më _____Mua. ____ ku jam; bëni si të _____ me _____ . Duke ardhur që t’ju _____ , ju kam _____ e _____ që duhej të bënit, dhe jua kam bërë më të _____ të Më _____”. Komandanti i rojeve u përpoq të mos ua vinte veshin fjalëve të Báb·it dhe po bëhej gati të largohej, kur Báb·i i tha: “... Unë e kam _____ rehatinë Time dhe kurrë nuk jam bërë _____ apo _____ për askënd. E ____ që po më _____ Mua. Preferoj t’ju _____ juve, sesa të bëhem _____ të _____ për ty e për _____ e tu”.

10. Si e mposhti Báb·i armiqësinë e rojeve të Tij? _____

_____

11. Si arriti Báb·i në Shíráz? _____

_____

12. Çfarë veprimesh ndërmorri guvernatori kundër Báb·it? _____

_____

13. Cili ishte efekti i përpjekjeve të guvernatorit dhe të klerikëve për t’i dhënë fund influencës së Tij? _____

_____

14. Kush është Vaḥíd? _____

_____

_____

15. Si reagoi Guvernatoiri ndaj rritjes së popullaritetit të Báb·it? _____

_____

_____

16. Çfarë gjë e bindi guvernatorin që ta lëshonte më në fund Báb·in dhe ta lejonte Atë të largohej nga Shíráz·i?_____

_____

17. Ku shkoi Báb·i pasi u largua nga Shíráz·i? _____

18. Kur e ndërmori Ai këtë udhëtim? _____

19. Çfarë i tha Báb·i të ungjit kur po i jepte lamtumirën? _____

_____

_____

_____

_____

20. Formoni një çift me një anëtar tjetër të grupit tuaj dhe bëjeni me radhë duke treguar historinë e takimit të shpurës hipur në kalë me Báb·in në vendet e shkreta ndërmjet Búshihr·it dhe Shíráz·it.

PJESA 6

Ndërsa Báb·i po i afrohej qytetit të Iṣfáhánit, Ai i shkroi një letër guvernatorit të asaj krahine duke i kërkuar atij që t'i caktonte vendin ku do të banonte. Ndryshe nga guvernatori i Shíráz·it, ky guvernator ishte njeri i drejtë e zemërbardhë. Ai u prek kaq shumë nga korrektësia dhe stili i letrës së Báb·it saqë udhëzoi zyrtarin më të lartë fetar të krahinës që ta priste Báb·in në shtëpinë e tij dhe t'i bënte Atij një pritje të ngrohtë e bujare.

Gjatë qëndrimit të Báb·it në Iṣfáhán, fama e Tij dalë-ngadalë u përhap në gjithë qytetin. Turma njerëzish vinin ta takonin Atë çdo ditë dhe të dëgjonin fjalët e Tij të urta. Por shtimi i popullaritetit të Báb·it nxiti xhelozinë e klerikëve të qytetit, të cilët kishin frikë se mos humbisnin pozitën dhe pushtetin që kishin. Ata filluan të përhapin thashetheme për figurën e Báb·it, duke shpresuar të ngjallnin dyshime ndaj Tij. Kur kjo gjë dështoi, ata hartuan një plan për ta hequr qafe Báb·in. Guvernatori, që kishte dijeni për intrigat e klerikëve kundër Báb·it, vendosi se gjëja më e mirë do të ishte që Báb·i të vinte e të rrinte në vetë shtëpinë e atij. Aty, gjatë orëve që kalonte në biseda me Báb·in, guvernatori pak nga pak arriti të kuptonte madhështinë e Revelacionit të Tij. Një ditë, ndërsa ishte ulur me Báb·in në kopshtin e shtëpisë së tij, guvernatori iu drejtua Atij me këto fjalë:

"Dhuruesi i Gjithëfuqishëm më ka pajisur me pasuri të mëdha. Unë nuk e di cila është mënyra më e mirë për ta përdorur atë. Tani që, me ndihmën e Perëndisë, m'u tregua rruga për

ta njohur këtë Revelacion, është dëshira ime e zjarrtë që t'ia përkushtoj të gjitha zotërimet e mia mbështetjes së interesave dhe përhapjes së namit të tij. Qëllimi im është që, me lejen Tuaj, të nisem për në Ṭihrán, dhe të bëj çfarë është e mundur që këtë Kauzë ta përqafojë edhe Mbreti, besimi i të cilit ndaj meje është i fortë e i patundur".[13]

Këtij vërshimi dashurie e përkushtimi Báb·i iu përgjigj me këto fjalë:

"Perëndia të shpërbleftë për synimet tuaja fisnike. Një qëllim kaq i lartë, për Mua është madje më i shtrenjtë se edhe vetë akti. Por ditët e tua dhe të Miat janë të numëruara; ato nuk dalin për të bërë të mundur që Unë të dëshmoj, dhe ti të arrish, realizimin e shpresave tuaja. Perëndia Fuqiplotë do ta arrijë triumfin e Besimit të Tij jo me anë të mjeteve që ti i përmende me aq ngrohtësi. Përmes të varfërve dhe vegjëlisë së kësaj toke, me gjakun që ata do të derdhin në shtegun e Tij, do të sigurojë Sovrani i gjithëfuqishëm ruajtjen dhe konsolidimin e themeleve të Kauzës së Tij. Po Ai Perëndi, në botën e ardhshme, do të vendosë në kokën tënde kurorën e lavdisë së pavdekshme dhe do të reshë mbi ty bekimet e Tij të paçmuara. Vetëm tre muaj e nëntë ditë kanë mbetur nga koha e jetës sate tokësore, mbas së cilës ti, me besim e siguri, do të nxitosh për në banesën tënde të përjetshme".[14]

Tre muaj e nëntë ditë më pas guvernatori ndërroi jetë, pikërisht ashtu siç e pat parashikuar Báb·i. Disa ditë pas vdekjes së tij, pasardhësi i tij i dërgoi një mesazh Mbretit në Ṭihrán duke e pyetur se çfarë duhej të bënte me Báb·in. Mbreti e urdhëroi atë që ta dërgonte Báb·in fshehtazi në kryeqytet, ku Mbreti kishte ndërmend ta takonte. Kështu, i shoqëruar nga një shpurë kalorësish, Báb·i nisi udhëtimin e Tij drejt Ṭihrán·it.

1. Kujt i shkroi Báb·i ndërsa po i afrohej qytetit të Iṣfáhánit? _____

_____

2. Me çfarë fjalësh përshkruhet Guvernatori i Iṣfáhánit? _____

_____

3. Çfarë udhëzimesh i dha guvernatori zyrtarit më të lartë fetar të krahinës? _____

_____

_____

4. Çfarë i bëri xhelozë klerikët e Iṣfáhánit? _____

_____

5. Çfare frike kishin klerikët se do të humbisnin nëse Báb·i lejohej të vazhdonte të shpallte Mesazhin e Tij? _____

_____

6. Çfarë bëri guvernatori i Isfáhán·it për ta mbrojtur Báb·in nga intrigat e klerikëve?

_____

_____

7. Çfarë ofroi guvernatori të bënte për Kauzën e Báb·it? _____

_____

_____

8. Si iu përgjigj Báb·i ofertës së guvernatorit? _____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

9. Çfarë të vërtete të madhe rreth përparimit të Kauzës së Perëndisë i përcolli Báb·i si përgjigje Guvernatorit? _____

_____

_____

10. Çfarë urdhëra i dha Mbreti pasuesit të guvernatorit? _____

_____

_____

PJESA 7

Kryeministri i atëhershëm i Persisë ishte një njeri egoist e i paaftë. Ai kishte frikë se po të vinte Báb·i në Ṭihrán dhe të takohej me Mbretin, ai do të humbiste postin dhe pushtetin që kishte. Prandaj ia mbushi mendjen Mbretit që t'i ndryshonte urdhërat dhe ta dërgonte Báb·in në krahinën e Ádhirbáyjánit në veriperëndim të vendit.

Kur Báb·i mbërriti në Tabríz, në kryeqendrën e krahinës, Atë e çuan në një nga ndërtesat kryesore të qytetit, ku edhe do të qëndronte nën mbikqyrje. Një detashment ushtarësh ruante hyrjen e ndërtesës. Askush nuk lejohej Ta takonte, me përjashtim të dy prej pasuesve të Tij. Banorët e qytetit ishin paralajmëruar se kushdo që do të përpiqej të takonte Báb·in do të futej në burg dhe të gjitha zotërimet do t'i konfiskoheshin.

Báb·i qëndroi në Tabríz për një kohë të shkurtër dhe prej andej e transferuan në kështjellën e Máh-Kú·së, që ndodhej në malet e Ádhirbáyjánit, shumë larg nga qytetet dhe qendrat e tjera të mëdha të banuara. Banorët e asaj zone i përkisnin një sekti tjetër të Islamit, një sekti që kishte shumë mosmarrëveshje me atë që ndiqte shumica e popullsisë. Kryeministri kishte menduar se duke e dërguar Báb·in në atë skaj të largët e jo mikpritës të vendit, ndikimi i Tij do të pakësohej dhe Besimi i Tij gradualisht do të harrohej. Por ai nuk e kuptoi se llampa e Fesë së Perëndisë ishte ndezur dhe se asnjë dorë njerëzore nuk mund ta shuante flakën e saj.

Báb·i nëpërmjet madhështisë dhe dashamirësisë së Tij, fitoi shpejt respektin dhe admirimin si të zyrtarit përgjegjës për kështjellën, ashtu dhe të banorëve të zonës.

Kushtet e rrepta të cilave u nënshtrohej Báb·i pak nga pak u lehtësuan dhe dyert e kështjellës u hapën për pasuesit e Tij, të cilët erdhën nga vise të ndryshme të Persisë, në numër gjithnjë e më të madh, për Ta takuar. Gjatë periudhës së burgimit të Tij në Máh-Kú, Báb·i reveloi Bayánin Persian, më të rëndësishmen ndër Veprat e Tij. Në atë Libër, ai caktoi ligjet e Dispensacionit të Tij, shpalli qartë e në mënyrë të drejtpërdrejt ardhjen e një Revelacioni tjetër më të madh se ai i Tij, dhe i nxiste pasuesit e Tij që të kërkonin e të gjenin "Atë Që Perëndia do ta shfaqë". Një nga pasuesit e Tij që jetonte në Máh-Kú në atë kohë e përshkruan me këto fjalë revelimin e Bayánit Persian:

"Zëri i Báb·it, ndërsa diktonte mësimet dhe parimet e Besimit të Tij, mund të dëgjohej qartë nga ata që banonin në rrëzë të malit. Melodia e këngës së Tij, rrjedha ritmike e vargjeve që gurgullonin prej buzëve të Tij pushtonte veshët e depërtonte thellë në shpirtrat tanë. Mali e lugina kthenin jehonën e madhështisë së zërit të Tij. Zemrat tona vibronin në thellësitë e tyre nga thirrja tërheqëse e Tij".[15]

Kur Kryeministri mësoi se Báb·i kishte fituar admirimin e banorëve të Máh-Kú·së dhe se Besimi i Tij po vazhdonte të përhapej ngado, ai dha urdhër që Báb·i të transferohej në kështjellën e Chihríq·ut. Por edhe aty njerëzit e qytezave përreth si dhe zyrtari i kështjellës u tërhoqën nga personaliteti magnetik i Báb·it. Madje edhe disa nga klerikët më të shquar të zonës e pranuan Besimin e ri dhe i lanë postet e tyre të privilegjuara për t'u bashkuar me pasuesit e Tij.

Sapo Kryeministri mori vesh për popullaritetin në rritje të Báb·it në Chihríq, dha urdhër që ta çonin Atë menjëherë në Tabríz. Atje qeveria organizoi një takim të autoriteteve fetare për ta marrë në pyetje Báb·in dhe për të gjetur mënyrën më efektive për t'i dhënë fund ndikimit të Tij. Në atë takim, klerikët dhe zyrtarët qeveritarë u përpoqën ta poshtëronin Báb·in, por u mposhtën nga madhështia e Tij. Kur e pyetën, "Kush je ti sipas teje, dhe cili është mesazhi që ke sjellë?", Ai deklaroi:

> **"Unë jam, Unë jam, Unë jam i Premtuari! Unë jam Ai emrin e të cilit e keni thirrur për njëmijë vjet, duke përmendur emrin të cilin jeni ngritur, ardhjen e të cilit mezi keni pritur ta dëshmoni, dhe orën e Revelacionit të të cilit i jeni lutur Perëndisë ta shpejtojë. Me të vërtetë Unë them, është detyrë e popujve të Lindjes dhe të Perëndimit t'i binden fjalës Sime dhe të zotohen për besnikëri ndaj personit Tim".[16]**

Disa ditë pas atij takimi, Báb·in e çuan përsëri në Chihríq. Armiqtë e Tij kishin shpresuar se duke e sjellë në Tabríz, do ta detyronin Atë të hiqte dorë nga Misioni i Tij. Por në fund u bindën se, sakohë Báb·i do të mbetej gjallë, do të ishte e pamundur të ndalnin ndikimin në rritje të Tij.

1. Cilatfjalë e përshkruajnë karakterin e Kryeministrit të Persisë të asaj kohe?_____

   _____

2. Pse kishte frikë Kryeministri nga takimi i Mbretit me Báb·in? _____

   _____

3. Çfarë bëri Kryeministri për ta penguar takimin e Báb·it me Mbretin? _____

_____

4. Pse e ruanin ushtarët hyrjen e shtëpisë ku qëndroi Báb·i në Tábriz? _____

_____

_____

5. Çfarë paralajmërimi u ishte dhënë njerëzve të qytetit ? _____

_____

_____

6. Për ku u transferua Báb·i pas qëndrimit të Tij të shkurtër në Tabriz? _____

_____

7. Çfarë mendoi kryeministri se do t'i ndodhte Kauzës së Báb·it sapo Ai të burgosej në Máh-Kú? _____

_____

8. Ku gaboi Kryeministri në mënyrën e tij të të menduarit? _____

_____

_____

9. Si u hapën portat e burgut të Báb·it në Máh-Kú për pasuesit e Tij? _____

_____

_____

10. Çfarë libri të rëndësishëm reveloi Báb·i gjatë periudhës së burgimit të Tij në kështjellën e Máh-Kú·së? _____

_____

11. Cilat janë disa nga temat e Bayánit Persian? _____

_____

_____

_____

12. Për Kë nxiste pasuesit e Tij në Bayán Báb·i,që t'a kërkonin dhe t'a gjenin? _____

_____

13. Çfarë bëri Kryeministri kur dëgjoi se Besimi i Báb·it po vazhdonte të përhapej? ___

_____

_____

14. Si u ndikua Kauza e Báb·it nga transferimi i Tij në Chihríq? _____

_____

15. Çfarë menduan se do të arrinin armiqtë e Báb·it duke e çuar Báb·in nga Chihríq·u në Tabríz? _____

_____

16. Çfarë pyetjesh i bënë autoritetet Báb·it gjatë marrjes së Tij në pyetje? _____

_____

_____

17. Çfarë deklaroi Báb·i në përgjigje të pyetjeve të tyre? _____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 8

Duke iu referuar Báb·it, 'Abdu'l-Bahá·i ka thënë:

"Përsa i përket Báb·it − u bëftë theror shpirti im për Të! − në rininë e Vet, domethënë kur kishte arritur vitin e njëzetepestë të jetës së Tij të bekuar, Ai u ngrit për të shpallur Kauzën e Tij…. Krejt i vetëm, në një mënyrë që kapërcen çdo imagjinatë, Ai përhapi Kauzën midis persëve, që janë të njohur për fanatizmin e tyre fetar. Ky Shpirt i shquar u ngrit me një fuqi të tillë saqë lëkundi shtyllat e fesë, të moralit, kushtet, doket e zakonet e Persisë dhe vendosi rregulla të reja, ligje të reja dhe një fe të re. Edhe pse personalitetet e mëdha të shtetit, pothuajse të gjithë klerikët dhe ofiqarët publikë u ngritën për ta asgjësuar e zhdukur Atë, Ai u bëri ballë atyre i vetëm dhe tronditi gjithë Persinë.

"Shumë ulama e ofiqarë publikë, si dhe njerëz të tjerë, flijuan me gëzim jetën e tyre për Kauzën e Tij dhe nxituan në udhën e martirizimit.

"Qeveria, kombi, doktorët e fesë dhe personalitetet e mëdha donin ta shuanin dritën e Tij, por nuk mundën ta arrinin këtë. Më në fund, hëna e Tij doli, ylli i Tij

shkëlqeu, themelet e Tij u vendosën fort dhe vendagimi i Tij u bë i ndritshëm. Ai i dha edukim hyjnor një shumice të pandriçuar dhe arriti rezultate të mrekullueshme në fushën e mendimeve, të moralit, të zakoneve e të kushteve të persëve. Ai u shpalli pasuesve të Vet lajmin e gëzuar të manifestimit të Diellit të Baháit dhe i përgatiti ata që të besonin tek Ai.

"Shfaqja e shenjave të tilla të mahnitshme dhe arritja e rezultateve të mëdha; ndikimi i ushtruar mbi mendjet e njerëzve dhe mbi idetë mbizotëruese; hedhja e themeleve të përparimit; formulimi i parimeve të suksesit e të begatisë nga një i ri tregtar, përbëjnë provën më të madhe se Ai ishte një Edukator i përsosur. Një person i paanshëm kurrë nuk do të ngurrojë ta besojë këtë".[17]

Jeni i inkuarajuar të përgatisni dhe mbani një kumtesë të shkurtër rreth jetës së Báb·ít duke u bazuar në fjalët e mësipërme të 'Abdu'l-Bahá·it dhe në historinë që keni studiuar deri tani.

PJESA 9

Në vitin 1850, një kryeministër i ri i Persisë, po aq katil sa edhe i mëparshmi, urdhëroi ekzekutimin e Báb·it. Përsëri Báb·in e sollën që nga Çehriku në Tabríz. Atje e burgosën në një qeli ngjitur me një shesh, i cili do të bëhej skena e martirizimit të Tij.

Ndërsa Báb·in po e çonin në qeli, një djalë i ri çau përmes turmës dhe i ra Báb·it ndër këmbë. "Mësues, mos më largo prej Teje", iu përgjërua ai. Ai iu lut Báb·it që ta lejonte ta ndiqte kudo që do të shkonte. "Çohu", iu përgjigj Báb·i, "dhe të jesh i sigurt se ti do jesh me Mua. Nesër ti do të dëshmosh atë që ka urdhëruar Perëndia".[19] Të riun menjëherë e arrestuan, bashkë me dy nga ata që e shoqëronin, dhe e burgosën në të njëjtën qeli ku ishin mbyllur edhe Báb·i me sekretarin e Tij. Ky djalë i ri u bë i njohur me emrin Anís.

Anís·i kishte dëgjuar për Mesazhin e ri nga vetë Báb·i gjatë burgimit të mëparshëm të Tij në Tabríz dhe kishte vendosur ta ndiqte Atë në Çehrik. Kaq i fortë ishte zjarri i dashurisë për Perëndinë që digjej në zemrën e Anís·it, saqë e vetmja dëshirë e tij ishte të flijonte veten për Besimin e tij të ri. Por njerku i tij, i alarmuar nga sjellja e pazakontë e djalit, e mbylli Anís·in në shtëpi dhe e mbante nën kontroll të rreptë. Aty Anís·i kaloi javë të tëra në lutje e përsiatje, duke iu përgjëruar Perëndisë që ta lejonte atë të vinte në praninë e të Shumëdashurit të tij. Dhe një ditë, siç qe ashtu i zhytur në lutje, ai pati një vegim të jashtëzakonshëm. Ai pa Báb·in që qëndronte përpara tij dhe po e thërriste. Anís·i i ra Atij ndër gjunjë. "Gëzohu", i tha Báb·i atij, "po afron ora kur, në këtë qytet, Unë do të varem pezull në sy të të gjithëve dhe do të bie viktimë e zjarrit të armikut. Unë nuk do të zgjedh njeri tjetër veç teje për të ndarë me Mua kupën e martirizimit. Të jesh i sigurt se ky premtim që po të jap do të përmbushet"[20]. E kështu Anís·i filloi të priste me durim, duke e ditur se do të vinte shpejt dita kur ai do të bashkohej përsëri me të Shumëdashurin e tij. Tani, më në fund, ai kishte arritur Dëshirën e Zemrës së tij.

Atë mbrëmje Báb·i shkëlqente nga gëzimi. Ai foli me gëzim me Anís·in si dhe me tre pasuesit e tjerë besnikë që ishin burgosur bashkë me Të në qelinë e Tij. "Nesër", u tha Ai atyre, "do të jetë dita e martirizimit Tim. Ah, sikur të ngrihej tani njëri nga ju dhe, me duart e veta, t'i jepte fund jetës Sime. Unë preferoj të vritem nga dora e një miku sesa nga ajo e armikut". Askush prej tyre nuk guxonte as ta çonte nëpër mend të merrte një jetë kaq të vyer. Rrinin të

heshtur, me lotët që u rridhnin faqeve. Kur papritmas, Anís·i brofi në këmbë dhe tha se ishte gati të zbatonte çfarëdolloj urdhri të Báb·it. "Ky i ri që është ngritur të plotësojë dëshirën Time", deklaroi Báb·i, "do të martirizohet bashkë me Mua. Atë do të zgjedh Unë për të ndarë me Mua kurorën e martirizimit"[20].

Herët në mëngjesin tjetër, më 9 korrik 1850, Báb·i po punonte me sekretarin e Tij kur një zyrtar e ndërpreu papritmas bisedën e tyre. "Derisa t'i kem thënë atij të gjitha ato gjëra që dua t'i them", i tha Báb·i atij, "asnjë fuqi tokësore nuk mund të Më mbyllë gojën. Edhe sikur e gjithë bota të armatoset kundër Meje, përsëri do të jetë e pafuqishme të Më ndalojë të përmbush, deri në fjalën e fundit, qëllimin Tim".[22] Por zyrtari nuk e kuptoi domethënien e fjalëve të Báb·it. Ai nuk u përgjigj dhe i tha sekretarit ta ndiqte pas. Pastaj Báb·in e morën nga qelia e Tij dhe e çuan në shtëpitë e klerikëve më të shquar të qytetit të Tabríz·it, të cilët, pa ngurruar, nënshkruan dekretin për ekzekutimin e Tij.

Më vonë atë mëngjes Báb·in e çuan në shesh publik ku një turmë prej rreth dhjetëmijë vetësh ishte mbledhur që të shikonte ekzekutimin e Tij. Atë ia dorëzuan Sám Khán·it, komandantit të regjimentit të ushtarëve që kishte marrë urdhër për ta ekzekutuar. Por, Sám Khán·i, që ishte prekur shumë nga sjellja e Báb·it, i kishte hyrë frika se mos veprimi i tij do të sillte mbi të zemërimin e Perëndisë. "Unë jam pasues i Besimit të Krishterë", i shpjegoi ai Báb·it, "dhe nuk kam asgjë kundër teje. Nëse Kauza Jote është Kauza e së Vërtetës, bëj të mundur që unë të çlirohem nga detyrimi për të derdhur gjakun tënd". "Ndiq udhëzimet që të janë dhënë", iu përgjigj Báb·i, "dhe nëse qëllimi yt është i sinqertë, Fuqiploti është sigurisht në gjendje të të çlirojë nga mëdyshja".[22]

Sám Khán·i urdhëroi njerëzit e tij të ngulnin një kunj hekuri në mur dhe të varnin dy litarë në të. Báb·i dhe Anís·i u varën pezull te këta dy litarë. Pastaj regjimenti u rreshtua në tre radhë, secila me nga dyqind e pesëdhjetë vetë. Njëra pas tjetrës çdo radhë hapi zjarr. Kur tymi i shkaktuar nga shkrepja e shtatëqind e pesëdhjetë pushkëve u davarit, turma e habitur pa një skenë që nuk po u besonte syve. Anís·i qëndronte para tyre i gjallë e i pacënuar, kurse Báb·i nuk ishte më aty. Plumbat kishin këputur vetëm litarët me të cilët ata i kishin varur pezull. Atëherë filloi një kërkim frenetik për të gjetur Báb·in. Më në fund e gjetën në qelinë e Tij, duke përfunduar bisedën e ndërprerë në mes më parë me sekretarin e Tij. "Unë e mbarova bisedën", tha Báb·i. "Tani mund të vazhdoni të përmbushni qëllimin tuaj".[23]

I shtangur nga ajo që i kishin parë sytë, Sám Khán·i refuzoi t'i lejonte njerëzit e tij të qëllonin për herë të dytë, dhe u dha urdhër të largoheshin nga sheshi. U desh të sillnin një regjiment tjetër për të kryer ekzekutimin. Edhe një herë trupat e Báb·it dhe të Anís·it u varën pezull në shesh, dhe ushtarët hapën zjarr. Kësaj radhe plumbat e tyre goditën në shenjë. Trupat e Báb·it dhe të Anís·it u copëtuan tërësisht; por megjithëkëtë fytyrat e tyre mbetën pothuajse të paprekura. Ndërsa regjimenti po bëhej gati të hapte zjarr, Báb·i iu drejtua me këto fjalë turmës së njerëzve që ishin mbledhur:

> **"O brez kokëfortë! Nëse do të kishit besuar tek Unë, çdonjëri prej jush do të kishte ndjekur shembullin e këtij të riu, që kishte një pozitë më të lartë se shumica prej jush, dhe me dëshirë do të kishte flijuar veten në shtegun Tim. Do të vijë dita kur ju do të Më njihni; atë ditë Unë nuk do të jem më me ju".[25]**

1. Në cilin qytet u martirizua Báb·i? _____

2. Kush dha urdhër për ekzekutimin e Báb·it? _____

_____

3. Tregoni me fjalët tuaja historinë sesi i riu Anís arriti të martirizohet bashkë me Báb·in.

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

4. Pse Báb·i zgjodhi Anís·in për të ndarë me të kurorën e martirizimit? _____

_____
_____

5. Kur zyrtari e ndërpreu në mes bisedën e Báb·it me sekretarin e Tij mëngjesin e ekzekutimit të Tij, Báb·i i tha atij: "Derisa t'i kem thënë atij të _____ ato _____ që _____ t'i them, asnjë fuqi _____ nuk mund të Më _____".

6. Si quhej komandanti i regjimentit të cilit i qe dhënë urdhri për ekzekutimin e Báb·it?

_____
_____

7. Çfarë i kërkoi Báb·it Sám Khán·i? _____

_____

8. Çfarë i tha Báb·i Sám Khán·it të bënte? _____

_____

_____

9. Sa ushtarë hapën zjarr mbi Báb·in dhe Anís·in? _____

10. Çfarë pa turma e habitur kur u davarit tymi i shkaktuar nga shkrepja e pushkëve?

_____

_____

_____

11. Çfarë po bënte Báb·i kur e gjetën? _____

_____

12. Çfarë tha Báb·i kur u gjet në fund? _____

_____

_____

13. Në çfarë datë u martirizua Báb·i? _____

14. Sa vjeç ishte Báb·i kur u martirizua? _____

15. Në rreshtat që vijojnë shkruani fjalët e fundit të Báb·it drejtuar turmës që qe mbledhur për të parë ekzekutimin e Tij

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 10

Sugjerohet që të vizatoni në hartën e mëposhtme itinerarin e udhëtimeve e të syrgjynosjeve të Báb·it. Ndërsa bëni këtë, përpiquni të kujtoni çfarë ndodhi në secilin vend dhe përsiatni për domethënien e saj.

PJESA 11

Në këto mësime ju keni studiuar ngjarjet e jetës së njërit prej Manifestimeve Binjake të Perëndisë për Ditën e sotme. Gjatë jetës së Tij të shkurtër, Báb·i shkaktoi një revolucion shpirtëror në Persi. Mijëra e mijëra shpirtra të dëlirë pranuan Mesazhin e Tij dhe filluan të përgatisnin vetveten për ardhjen e Manifestimit të Perëndisë të Cilit Báb·i i qe referuar si "Ai Që Perëndia do ta shfaqë". Ju e dini se sa herë që një Manifestim i Perëndisë shfaqet mbi tokë, të gjitha forcat e shtypjes e të errësirës ngrihen kundër Tij dhe përpiqen të shuajnë dritën e Revelacionit të Tij. Edhe në këtë rast, jo vetëm u martirizua Báb·i nga drejtuesit injorantë të Persisë, por edhe u vranë mijëra pasues të Tij. Jetët heroike të këtyre Bábí·ve të hershëm, që vaditën me gjakun e tyre pemën e Revelacionit të sapolindur, do të jenë një temë e studimit tuaj në vitet e ardhshme. Figura të tilla si Mullá Ḥusayn·i, Quddús·i, Ṭáhirih·ja dhe Vahíd·i do të jenë për ju një burim i madh frymëzimi e kurajoje gjatë gjithë jetës suaj ndërsa do të vazhdoni të mësoni rreth historisë së jashtëzakonshme të viteve të hershme të Epokës Bahá'í. Tani për tani, duhet ta përfundojmë këtë kurs duke përsiatur rreth një pyetjeje themelore: Si është e mundur që, brenda një kohe kaq të shkurtër, jetët e mijëra e mijëra njerëzve të transformoheshin aq shumë e që nga një popull i zhytur në bestytni e i skllavëruar prej drejtuesish të korruptuar të dalin të tillë shpirtra të shenjtë dhe të kryejnë të tilla vepra heroike? Çelësi i përgjigjes mund të gjendet vetëm në Personin e 'Alí-Muḥammad·it, Báb·it. Atëherë le të studiojmë e të përsiatim mbi disa pasazhe nga Shkrimet e Bahá'u'lláh·ut, të 'Abdu'l-Bahá·it dhe të Ruajtësit rreth asaj Qenieje të Shenjtë.

Në Testamentin e Tij, ‘Abdu’l-Bahá·i thotë:

“Ky është themeli i besimit të njerëzve të Bahá-it (u flijoftë jeta ime për ta): ‘Shenjtëria e Tij, i Lartësuari (Báb-i), është Manifestimi i Unitetit e i Njëshmërisë së Perëndisë dhe Pararendësi i Bukurisë së Lashtë. Shenjtëria e Tij Bukuria Abhá (u bëftë fli jeta ime për miqtë e Tij të patundur) është Manifestimi Suprem i Perëndisë dhe Agimi i Thelbit të Tij Më të Shenjtë. Gjithë të tjerët janë shërbëtorë të Tij dhe zbatojnë urdhrin e Tij’”.[25]

Në librin “Perëndia kalon pranë”, lexojmë pasazhin e mëposhtëm të shkruar nga Ruajtësi:

“Báb·i, i cilësuar nga Bahá’u’lláh·u si ‘Thelbi i Thelbeve’, ‘Deti i Detrave’, ‘Pika rreth së Cilës sillen realitetet e Profetëve e të Lajmëtarëve’, ‘prej së Cilës Perëndia ka bërë që të rrjedhë dija e gjithçkaje që ka qenë e do të jetë,’ ‘rangu (i të Cilit) ia kalon atij të të gjithë Profetëve, dhe që ‘Revelacioni (i të Cilit) kapërcen të kuptuarin dhe afërmendësinë e të gjithë të zgjedhurve të tyre,’ kishte dhënë Mesazhin e Tij dhe e kishte kryer Misionin e Tij. Ai që sipasfjalëve të ‘Abdu’l-Bahá·it ishte ‘Agimi i së Vërtetës’ dhe ‘Lajmëtari i Dritës së Madhe’, ardhja e të Cilit shënoi njëherazi përfundimin e ‘Ciklit Profetik’ dhe zanafillën e ‘Ciklit të Përmbushjes’, nëpërmjet Revelacionit të Tij në të njëjtën kohë dëboi hijet e natës që kishin rënë mbi vendin e Tij dhe shpalli ngritjen e afërt të atij Ylli të Pashoq, rrezatimi i të Cilit do të mbështillte mbarë njerëzimin”.[26]

Vetë Bahá’u’lláh·u shpjegon:

“Që një periudhë kaq e shkurtër kohore ndau këtë Revelacion kaq të fuqishëm e të mahnitshëm nga vetë Revelacioni Im i ngutshëm, është një sekret që asnjë njeri nuk mund ta shkoklavisë dhe një mister që asnjë mendje s’mund ta rrokë”.[27]

‘Abdu’l-Bahá·i thotë:

“Shfaqja e Báb·it i ngjan agimit, sepse agimi mbart në vetvete premtimin e diellit. Agimi i Báb·it premtoi ngritjen e Diellit të së Vërtetës që do të mbështjellë të gjithë botën”.[28]

PJESA 12

Gjatë jetës së Tij të shkurtër si Manifestim i Perëndisë në tokë, Báb·i reveloi një numër të madh Librash e Tabelash. Tani që keni përfunduar studimin e jetës së Tij, rekomandohet që të mësoni përmendësh dy nga lutjet e Tij si dhe të paktën një pjesë nga fjala drejtuar Shkronjave të të Gjallit.

“A ka ndonjë Largues të vështirësive veç Perëndisë? Thuaj: Lëvduar qoftë Perëndia! Ai është Perëndia! Të gjithë janë shërbëtorët e Tij dhe të gjithë u përmbahen urdhrave të Tij”.[29]

“Thuaj: Perëndia është i mjaftueshëm në gjithçka e mbi gjithçka, dhe asgjë në qiell ose mbi tokë përveç Perëndia është i mjaftueshëm. Me të vërtetë, Ai është në Vetvete Njohësi, Mbështetësi, i Gjithëfuqishmi”.[30]

PJESA 13

Në Njësinë e tretë të Librit 2, ju i përqëndruat përpjekjet tuaja për të mësuar sesi të bisedoni në një numër temash, veçanërisht me ata që janë të rinj në Besim, gjatë një serie vizitash të kryera në shtëpi të komunitetit tuaj. Tani që e keni përfunduar këtë njësi, ju mund t'i shtoni listës së temave, ju mund të dëshironi të diskutonihistorinë e jetës së Báb·it. Sesa shumë detaje zgjodhët të mbuloni në çdo rast të dhënë do të varet sigurisht në shumë faktorë. Por pavarësisht rrethanave, ju duhet të shpresoni të ndani një rrëfim të gjerë të ngjajreve me peshë të jetës së Tij si pararendës i Bahá'u'lláh·ut dhe Lajmëtari i një Epoke të Re.Hera herës do t'u vijnë në ndihmë faqet në vijim.

Bábi

Lajmëtari i një Dite të Re





Bábi u lind në 20 Tetor 1819 në Shíráz, një qytet në pjesën jugore të Iranit. Ai ishte akoma fëmijë kur Babai i Tij ndërroi jetë. Ai u rrit nga xhaxhai i Tij, i cili e futi Atë në shkollë në moshë të njomë.

Mësuesi i Báb-it menjëherë e dalloi kapacitetin e Tij të madh dhe kuptoi se ai ishte i paaftë të mësojë një fëmijë kaq të jashtëzakonshëm. Bábi i paisur nga Perëndia me njohuri të lindura.

Në atë kohë njerëzit e Iranit ishin duke pritur ardhjen e një Mesazheri të ri nga Perëndia. Ata luteshin, që Ai shumë shpejt të bëhej i dukshëm, duke sjellë me Vete një periudhë paqeje dhe drejtësie mbi tokë. Shumë veta lanë shtëpitë e tyre në kërkim të të Premtuarit.



Në prag të 23 Majit 1844, një burrë i ri arriti në Shíráz në kërkimtë të Premtuarit. Bábi e takoi atë jashtë portave të qytetit dhe e ftoi atë në shtëpinë e Tij, që të mblidhte veten pas atij udhëtimi të gjatë. Atje Bábi deklaroi që, Ai ishte Ai,ardhjen e të Cilit njerëzit po e prisnin me shumë zell.



Fjala “báb”do të thotë “portë” apo “derë”. Báb·i shpalli se së shpejti një tjetër Mesazher i Perëndisë do të shfaqej, i Cili do të bashkonte të gjithë njerëzit e botës në një familje. Báb·i ishte si një derë, që e drejtonte njerëzimin tek një e ardhme e re dhe e lavdishme.

Numri i ithtarëve të Báb·it u rrit me shpejtësi. Gjithandej Iranit, ata filluan të pëhapnin mësimet Hyjnore që Ai i shfaqi.



Shpejt autoritetet qeveritare dhe kleri, të cilët kishin frikë se mos humbisnin faqe njerëzve, u ngritën kundër besimit të ri të Perëndisë. Ata e burgosën Báb·in në një fortesë në një vend të vetmuar të shtetit, larg prej ithtarëve të Tij.

Ithtarët e Báb·it pësuan persekutimin më të egër. Ata u sulmuan, u rrahën, dhe u futën në burg. Mijra u dënuan me vdekje, megjithatë Kauza e Perëndisë vazhdoi të përhapej.

**Në vitin 1850 Báb·i u martirizua. Me urdhër të qeverisë,
Ai u var në oborr së bashku me njërin prej ithtarëve të Tij dhe u gjuajt
nga një regjiment ushtarësh. Báb·i ishte vetëm në vitin e 31-të të Jetës së Tij.**

Báb·i dha Jetën e Vet, që të pregatiste rrugën për ardhjen e Bahá'u'lláh·ut, "Lavdisë së Perëndisë", flamuri i Besimit i të Cilit ishte destinuar të ngrihej në çdo qoshe të planetit.

REFERENCAT

1. Lajmëtarët e Agimit: Tregimi i Nabíl·it për ditët e hershme të revelacionit Bahá'í, #158, bot. shqip.

2. Shoghi Effendi, God Passes By [Perëndia kalon pranë], Bahá'í Publishing Trust, Wilmette 1995, f. xiv.

3. Lajmëtarët e Agimit, #139.

4. Po aty, #144.

5. Po aty, #145.

6. 'Abdu'l-Bahá, nga: The Promulgation of Universal Peace [Shpallja e Paqes Universale], Bahá'í Publishing Trust, Wilmette 1995, f. 138.

7. Lajmëtarët e Agimit, #167.

8. Po aty, #176.

9. Po aty, #233.

10. Po aty, #167.

11. The Promulgation of Universal Peace, f. 138.

12. Lajmëtarët e Agimit, #240.

13. Po aty, #328.

14. Po aty, #342.

15. Po aty, #342.

16. Po aty, #376.

17. Po aty, #486.

18. Përgjigje për disa pyetje,#8, bot. shqip.

19. Lajmëtarët e Agimit, #773.

20. Po aty, #477.

21. Po aty, #774.

22. Po aty, #775.

23. Po aty, #781.

24. Po aty, #783.

25. Po aty, #786.

26. Amaneti e testamenti i ‘Abdu’l-Bahá·it, #2.8.

27. God Passes By, f. 57.

28. Bahá’u’lláh, cituar në Shoghi Effendi, The World Order of Bahá’u’lláh [Rendi botëror i Bahá’u’lláh·ut], Bahá’í Publishing Trust, Wilmette 1991, f. 124.

29. ‘Abdu’l-Bahá, On Divine Philosophy [Për filosofinë hyjnore], Tudor Press, Boston 1918), f. 47-48.

30. Báb·i, në Lutje Bahá’í,#47, bot. i dytë shqip.

31. Lutje Bahá’í, #48.

32. Lajmëtarët e Agimit, #176.

Jeta e Bahá'u'lláh·ut

Qëllimi

Të vlerësojmë madhështinë e
forcave shpirtërore të çliruara prej Tij
dhetë mësojmë si të tregojmë historinë e jetës së Bahá'u'lláh·ut

PJESA1

Bahá'u'lláh·u, emri i të cilit ishte Mírzá Ḥusayn-'Alí, lindi më 12 Nëntor 1817 në Ṭihrán, kryeqytetin e Persisë. I ati, Mírzá Buzurg, ishte një fisnik i shquar që mbante një post të lartë në oborrin e Mbretit Persian. Që në moshë të re Bahá'u'lláh·u tregoi shenja madhështie dhe shfaqi njohuri të jashtëzakonshme. Ai nuk ndoqi shkollë të rregullt, por mori njëfarë arsimi në shtëpi. Për fëmijërinë e Tij, 'Abdu'l-Bahá·i thotë:

> **"Përsosuria e Bekuar, Bahá'u'lláh·u, i përkiste fisnikërisë së Persisë. Që në fëmijërinë e hershme Ai u shqua mes të afërmve e miqve. Ata thoshin: 'Ky fëmijë ka fuqi të jashtëzakonshme'. Për nga urtia, inteligjenca dhe si burim i dijeve të reja, Ai ishte i përparuar tej moshës së Tij dhe qëndronte më lart nga ambienti ku jetonte. Të gjithë ata që e njihnin habiteshin me zgjuarsinë e Tij. Shpeshherë thoshin 'Ky fëmijë nuk do rrojë gjatë', sepse zakonisht besohej që fëmijët me zhvillim të parakohshëm nuk e arrinin moshën e pjekurisë".**[1]

Në një Tabelë, vetë Bahá'u'lláh·u tregon një histori nga fëmijëria e Vet kur kishte shkuar në dasmën e njërit prej vëllezërve të Tij në Ṭihrán. Siç ishte zakoni në Ṭihrán në atë kohë, me këtë rast bëhej një gosti e madhe që vazhdonte shtatë ditë e shtatë netë. Ditën e fundit, një teatër kukullash dha një shfaqje kushtuar një mbreti të famshëm për të zbavitur të ftuarit. Bahá'u'lláh·u e pa shfaqjen ulur në një dhomë sipër nga dukej oborri ku ishte ngritur tenda për shfaqjen.

Ai na tregon se shfaqja filloi me hyrjen e disa figurave të vogla në formë njerëzish që lajmëruan se po vinte mbreti. Pastaj hynë disa figura të tjera. Ca fshinin e ca spërkatnin me ujë për të përgatitur sheshin për ardhjen e mbretit. Pas kësaj tellalli i qytetit hyri në skenë dhe u tha njerëzve të mblidheshin për një audiencë me mbretin. Atëherë disa grupe figurash hynë e zunë vendet e tyre. Më në fund, hyri mbreti me pompozitet të madh. Me një kurorë mbi kokë, ai ecte ngadalë e me madhështi dhe u ul në fron. U bënë qitje me pushkë, gjëmuan boritë, dhe tenda u mbush me tym.

Kur u shpërnda tymi, mbreti, ende i ulur në fron, ishte i rrethuar nga ministra, princa e zyrtarë të lartë, të gjithë në qëndrim gatitu në prani të tij. Në atë kohë, sollën një hajdut para mbretit, i cili dha urdhër t'i prisnin kokën. Pa e zgjatur, kryexhelati e zbatoi urdhrin. Pas ekzekutimit, mbreti filloi të bisedonte me ministrat dhe zyrtarët. Papritur mbërriti lajmi se një kryengritje kishte shpërthyer në një nga provincat. Menjëherë u dërguan trupa për të shtypur revoltën. Disa minuta më vonë në sfond u dëgjuan të shtëna topash dhe u tha se trupat e mbretit ishin hedhur në betejë kundër rebelëve.

Kështu vazhdoi shfaqja. Bahá'u'lláh·u u habit pamasë për natyrën e shfaqjes. Pasi ajo mbaroi dhe perdet u mbyllën, Ai pa një burrë që doli nga prapa tendës me një kuti nën krah. "Çfarë është ajo kuti," e pyeti Bahá'u'lláh·u, "dhe e çfarë natyre ishte kjo shfaqje?" "Të gjitha kjo shfaqje dorëlëshuar dhe ato mjete të kushtueshme", u përgjigj ai, "mbreti, princat, ministrat, lavdia e madhështia e tyre, pushteti e fuqia e tyre, gjithçka që pe, është në këtë kuti".[2] Kjo i bëri përshtypje të madhe Bahá'u'lláh·ut, dhe Ai tha se:

> **"Që prej asaj dite, të gjitha stolitë e kushtueshme të botës janë dukur në sytë e këtij Të Riu të ngjashme me atë shfaqje. Ato kurrë nuk kanë pasur dhe as do të kenë ndonjëherë kurrfarë peshe, qoftë edhe sa një farë sinapi… Së shpejti, këto stoli të jashtme, këta thesare të dukshme, këto kotësi tokësore, këta formacione**

ushtarakë, këto veshje të shndritshme, këta shpirtra fodullë e të fryrë – të gjithë do të përfundojnë në varr si në atë kuti. Në sytë e atyre që janë mendjemprehtë, gjithë ky konflikt, kjo grindje e mburrje e kotë ishte ngaherë dhe do të jetë përherë si dëfrime dhe lojë fëmijësh.[3]

Një histori tjetër që ka të bëjë me fëmijërinë e Bahá'u'lláh·ut flet për një ëndërr që kishte parë i ati, në të cilën Bahá'u'lláh·u dukej sikur ishte:

"…duke notuar në një oqean të gjerë, të pafund. Trupi i Tij shkëlqente mbi ujërat me një rrezatim që ndriçonte detin. Rreth kokës së Tij, që dukej qartë mbi ujë, rrëzëllente në të gjitha drejtimet, flokët e Tij të zinj, duke pluskuar gjithandej mbi valët… një morí peshqish ishin grumbulluar rreth Tij, secili duke u mbajtur fort në fund të çdo fije floku. Të ngashnjyer nga shkëlqimi i fytyrës së Tij, e ndiqnin Atë ngado që notonte. Megjithëse ishin të shumtë në numër, e sado fort që mbaheshin pas flokëve të Tij, asnjë fije floku nuk dukej të ishte shkulur nga koka e Tij, dhe asnjë dëm nuk i ishte shkaktuar personit të Tij. I lirë e i papenguar, Ai lëvizte mbi ujërat dhe ata e ndiqnin".[4]

Nën përshtypjen e kësaj ëndrre, i ati i Bahá'u'lláh·ut thirri një njeri të njohur për mendjemprehtësinë e tij dhe i kërkoi t'i shpjegonte ëndrrën. Si të ishte frymëzuar nga një shkëndijë e lavdisë së ardhme të Bahá'u'lláh·ut, ky njeri i tha:

"Oqeani i pafund që keni parë në ëndërr është bota e qenies. I vetëm e pa kurrfarë ndihme, biri juaj do arrijë epësinë supreme mbi të. Kudo që t'i pëlqejë, mund të shkojë i papenguar. Askush nuk do t'i kundërvihet dot marshimit të Tij dhe askush nuk do ta pengojë dot përparimin e Tij. Grumbulli i peshqve simbolizon trazirën që Ai do të shkaktojë midis popujve e fiseve të tokës. Rreth Tij do mblidhen ata dhe pas Tij do të mbahen. I sigurt për mbrojtjen e përhershme të Fuqiplotit, kjo trazirë kurrë nuk do të dëmtojë personin e Tij, dhe as vetmia në detin e jetës nuk do të rrezikojë sigurinë e Tij".[5]

1. Si e kishte emrin Bahá'u'lláh·u? _____

2. Kur lindi Ai? _____

3. Ku lindi? _____

4. Me çfarë emër tjetër njihet sot Persia? _____

5. Si e kishte emrin i ati i Bahá'u'lláh·ut? _____

6. Çfarë pozite kishte i ati i Bahá'u'lláh·ut? _____

_____

7. Çfarë shenjash shfaqi Bahá'u'lláh·u gjatë fëmijërisë së Tij? _____

_____

8. Çfarë arsimimi mori Bahá'u'lláh·u? _____

_____

9. Përshkruani shfaqjen me kukulla që pa Bahá'u'lláh·u në fëmijërinë e Tij

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

10. Çfarë mendoi Bahá'u'lláh·u kur mësoi se gjithë shfaqja me kukulla, me mbretin, ministrat, ushtarët e fronin, ishin futur të gjitha në një kuti? _____

_____
_____
_____

11. Bahá'u'lláh·u tha se që prej asaj dite që pa mbretin ministrat, ushtarët e fronin të futur në një kuti: "…të gjitha _____ e _____ të _____ janë dukur në _____ e këtij _____ të ngjashme me atë _____. Ato _____ nuk kanë _____ dhe as do të kenë ndonjëherë kurrfarë _____, qoftë edhe sa një farë _____… Së shpejti, këto _____ të _____,këto _____, këto _____, këto _____, këta _____ e të _____ – të gjithë do përfundojnë në _____si në atë kuti. Në sytë e atyre që janë _____, gjithë ky _____, kjo grindje e _____, është si një _____.

12. Tregoni me fjalët tuaja ëndrrën e Mírzá Buzurgut.

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

13. Cili ishte kuptimi i oqeanit në ëndërr? _____
_____

14. Cili ishte kuptimi në ëndërr i tufës së peshqve rreth e rrotull Bahá'u'lláh·ut?_____
_____

15. Çfarë donte të thoshte që Bahá'u'lláh·u lëvizte i lirë e i shpenguar mbi ujëra? _____
_____
_____
_____

PJESA 2

Manifestimet Hyjnore janë të pajisur me dije të lindur dhe nuk kanë nevojë të mësojnë në shkolla e universitete. Ata janë edukatorët e jo ata që edukohen. Bahá'u'lláh·u thotë:

> **"Ky i Munduar nuk ka shkuar në shkollë, dhe as ka marrë pjesë në debatet e të diturve. Për jetën Time! Nuk e revelova Veten me dëshirën Time, por Perëndia Më zgjodhi Vetë që të Më shfaqte".[6]**

Lidhur me dijen e lindur të Bahá'u'lláh·ut, 'Abdu'l-Bahá thotë:

> **"Askush nuk vinte në praninë e Tij pa e ndier veten të mahnitur e të druajtur nga fuqia e Tij. Njerëzit e ditur që i drejtoheshin habiteshin me njohuritë e Tij, e megjithatë, Ai kurrë nuk kishte vajtur në shkollë dhe as kishte mësuar nga njerëzit. Miqtë dhe familja e Tij të gjithë janë dëshmitarë për këtë, e megjithatë Mësimet e Tij janë shpirti i kësaj epoke.**
>
> **"Dielli rrezaton nga vetja dhe nuk e merr dritën nga burime të tjera. Mësuesit Hyjnorë kanë dritë të lindur; Ata kanë dije e aftësi të kuptuari për të gjitha gjërat në univers; të gjithë të tjerët në botë e marrin dritën nga Ata dhe nëpërmjet Tyre artet e shkencat ripërtërihen në çdo epokë".[7]**

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

   a. Dielli rrezaton nga _____ dhe nuk e merr _____ nga _____ .

   b. Mësuesit Hyjnorë kanë _____ të _____ .

   c. Mësuesit Hyjnorë kanë _____ e _____ për të gjitha gjërat në univers.

   d. Nga Mësuesit Hyjnorë, të gjithë të tjerët në botë e _____ _____ .

   e. Nëpërmjet Mësuesve Hyjnorë, artet e shkencat _____ _____ .

2. Diskutoni në grupin tuaj për kuptimin e dijes së lindur e të dijes së përvetësuar.

3. Mësoni përmendësh citatin e mësipërm nga Bahá'u'lláh·u.

PJESA 3

Ndërsa Bahá'u'lláh·u rritej shenjat e madhështisë së Tij po bëheshin gjithnjë e më të dukshme. Kur u rrit e u bë djalë i ri, Ai njihej për inteligjencën e mprehtë, karakterin e shkëlqyer, bujarinë e zemërdhembshurinë e Tij. Ishte i aftë të zgjidhte edhe problemet më të vështira e t'u përgjigjej edhe pyetjeve më të komplikuara e më të thella. Prapëseprapë, megjithë fuqitë e Tij të jashtëzakonshme, Ai kurrë nuk kërkoi poste apo famë. Kur i ati ndërroi jetë, Bahá'u'lláh·ut iu kërkua të ndiqte gjurmët e tij dhe të zinte postin e tij në oborrin e mbretit. Por Ai refuzoi. Ai nuk ishte i interesuar për titujt e nderet e kësaj bote. Interesat e Tij ishin mbrojtja e të varfërve e ndihma për nevojtarët. Në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, Bahá'u'lláh·u u martua me Ásíyih Khánum·in dhe shtëpia e tyre u bë strehë për të gjithë. Askujt nuk i refuzohej mikpritja e tyre.

Bahá'u'lláh·u ishte njëzetë e shtatë vjeç kur, më 23 Maj 1844, Báb·i i deklaroi Misionin e Vet Mullá Ḥusayn·it në Shíráz. As tre muaj pas asaj ngjarjeje historike, Bahá'u'lláh·u mori një pergamenë me dorëshkrim nga Báb·i që përmbante disa nga Shkrimet e Tij. Ai dëshmoi në çast vërtetësinë e Revelacionit të Báb·it dhe doli në mbështetje të Mësimeve të Tij. Historia sesi Bahá'u'lláh·u mori atë pergamenë është si vijon:

Shpejt pasi Báb·i kishte caktuar dishepujt e Vet të zgjedhur, tetëmbëdhjetë Shkronjat e të Gjallit, Ai i thirri ata në praninë e Tij dhe i udhëzoi të shpërndaheshin e të predikonin Fenë e Tij. Ai i dha secilit nga një detyrë të posaçme, duke u caktuar disave vendlindjen e tyre si fushë të përpjekjeve që do bënin. Nga këta tetëmbëdhjetë shpirtëra të bekuar, Quddús u zgjodh për ta shoqëruar Atë në pelegrinazhin në Mekë, ku Báb·i do të deklaronte Misionin e Tij. Mullá Ḥusayn·it, të parit që besoi tek Ai, Báb·i i tha: "Mos u hidhëro që nuk u zgjodhe të më shoqërosh Mua në pelegrinazh në Hijáz. Në vend të kësaj, do t'i drejtoj hapat e tu teqyteti që bart një Mister të një shenjtërie të jashtëzakonshme të tillë saqë as Hijáz·i e as Shíráz·i nuk mund të

shpresojnë të krahasohen me të".[8] Ai i dha Mullá Ḥusayn·it një pergamenë dhe e udhëzoi të nisej për në Ṭihrán. I tha t'i përgjërohej Perëndisë që t'i jepte mundësinë të njihte shkëlqimin e sekretit të fshehur në atë qytet e të vinte në praninë e të Shumëdashurit.

Mullá Ḥusayn·i u nis për të kryer misionin e tij dhe pasi kaloi disa qytete arriti në Ṭihrán. Atje zuri një dhomë në një shkollë për studime fetare. Një ndër veprimet e tij të para ishte që i shpalli Mesazhin e Báb·it kreut të asaj shkolle, i cili e hodhi poshtë me arrogancë. Gjithsesi, një nxënës i ri i shkollës e dëgjoi rastësisht bisedën e tyre dhe u prek thellë nga fjalët e Mullá Ḥusayn·it. Ai vendosi t'i bënte këtij një vizitë në mesnatë dhe të mësonte më shumë për Mesazhin që kishte shpallur me aq entuziazëm. Mullá Ḥusayn·i e priti djaloshin dhe i foli me shumë mirësjellje e dashamirësi. I tha se tani e kishte kuptuar pse kishte ardhur në atë vend. Kreu i shkollës e kishte hedhur poshtë me përçmim Mesazhin që kishte sjellë. "Unë shpresoj", tha Mullá Ḥusayn·i, "që nxënësi i tij, ndryshe nga mësuesi, të njohë të vërtetën".[9]

Gjatë bisedës Mullá Ḥusayn·i e pyeti djaloshin nga ishte. Ai u përgjigj se ishte nga rajoni i Núr·it, në provincën e Mázindarán·it. "Pa më thuaj", e pyeti Mullá Ḥusayn·i, "a ka sot në familjen e të ndjerit MírzáBuzurg-i-Núrí·t, kaq i njohur për karakterin, nurin dhe arritjet artistike e intelektuale, ndonjë që e ka provuar se është i denjë të mbajë traditën e lartë të asaj shtëpie të famshme?"[10]

"Po", iu përgjigj ai "nga bijtë e tij që jetojnë, njëri e ka shquar Veten me po ato virtyte që karakterizonin të atin. E ka provuar se është pasardhës fisnik i atit të Tij fisnik me jetën e virtytshme, me arritjet e Tij të larta, me dashamirësinë e bujarinë e Tij. "Çfarë punë bën Ai?" e pyeti Mullá Ḥusayn·i. "U jep zemër të pashpresëve dhe ushqen të uriturit". "Çfarë rangu e pozite ka?" "Nuk ka ndonjë, përveçse u gjendet të varfërve e mysafirëve". "Si e ka emrin?" "Ḥusayn'Alí".[11]

Me çdo përgjigjje, Mullá Ḥusayn·i mbushej gjithnjë e më shumë me gëzim. "Si e kalon kohën Ai?" pyeti më tej. "Endet pyjeve dhe gjen kënaqësi në bukuritë e fshatit." "Çfarë moshë ka?" "Njëzetë e tetë vjeç" Fytyra e Mullá Ḥusayn·it shkëlqente nga kënaqësia e gëzimi kur e pyeti të riun: "Ma merr mendja që e takon shpesh?" "Shkoj shpesh në shtëpinë e Tij", u përgjigj ai. "A do t'i japësh në dorë diçka që po të besoj unë?" "Pa pikë dyshimi" u përgjigj ai. Atëherë Mullá Ḥusayn·i i dha pergamenën e mbështjellë në një copë dhe i kërkoi t'ia dorëzonte Bahá'u'lláh·ut të nesërmen në agim. "Nëse Ai denjon të më përgjigjet", shtoi Mullá Ḥusayn·i, "a do të kesh mirësinë të ma bësh të ditur përgjigjen e Tij?"[12] Nxënësi e mori pergamenën dhe në agim u ngrit që të kryente porosinë e Mullá Ḥusayn·it.

Ndërsa i afrohej shtëpisë së Bahá'u'lláh·ut, ai pa vëllanë e Tij, MírzáMúsá·në, tek qëndronte te porta dhe i shpjegoi atij arsyen e vizitës. Mírzá Músá·i e çoi djaloshin në praninë e Bahá'u'lláh·ut dhe i vunë përpara pergamenën. Bahá'u'lláh·u i ftoi të ulen. Si e hapi atë, Ai filloi të lexonte me zë të lartë disa nga pasazhet. Kishte lexuar vetëm një faqe kur duke iu kthyer të vëllait tha: "Músá, çfarë mund të thuash? Me të vërtetë, unë them se kushdo që beson në Kuranin dhe njeh origjinën Hyjnore të tij, e prapë ngurron, qoftë edhe për një çast të vetëm, të pranojë se këto fjalë të mallëngjyeshme janë të pajisura me po atë fuqi ripërtëruese, ai me sigurinë më të madhe ka gabuar në gjykimin e vet dhe është larguar së tepërmi nga shtegu i drejtësisë."[13] Duke e përcjellë të riun, Bahá'u'lláh·u i kërkoi t'i çonte Mullá Ḥusayn·it, si dhuratë nga Ai, një kallëp sheqeri e një pako me çaj, e t'i transmetonte atij ndjenjat e vlerësimit e të dashurisë së Tij.

Gjithë gëzim, i riu u ngrit e nxitoi të kthehej te Mullá Ḥusayn·i. I dorëzoi atij dhuratën e mesazhin e Bahá'u'lláh·ut. Nuk ka fjalë që të mund të përshkruajë gëzimin me të cilin Mullá

Ḥusayn·i i priti ato. Me kokë të përkulur ai e pranoi dhuratën dhe e puthi me zjarr. Pastaj përqafoi të riun, i puthi sytë, e i tha: "Shumë i dashur mik! Lutem që Perëndia të të dhurojë lumturi të përjetshme e ta mbushë zemrën tënde me gëzim të pashuar, ashtu siç gëzove ti zemrën time".[14] I riu u habit shumë nga sjellja e Mullá Ḥusayn·it. E çfarë natyre mund të jetë lidhja që i bashkon këta dy shpirtra, pyeste veten. Cila mund të jetë arsyeja e vëllazërisë së tyre? Pse u tregua aq i lumtur MulláḤusayn·i për një dhuratë kaq të vogël nga Bahá'u'lláh·u? Për këtë djalë të ri, ky ishte një mister që nuk mund ta kuptonte.

Disa ditë më vonë, MulláḤusayn·i u nis për në Khurásán, një provincë në verilindje të Iranit. Duke i dhënë lamtumirën nxënësit të ri nga Nuri, i tha atij: "Mos i thuaj asnjë fjalë asnjeriu për çfarë pe e dëshmove. Le të jetë ky një sekret i fshehur në gjoksin tënd. Mos ia thuaj njeriu emrin e Tij, sepse ata që e kanë zili pozitën e Tij do të ngrihen për t'i bërë keq. Në çastet e tua të përsiatjes, lutu që Fuqiploti ta mbrojë Atë, që nëpërmjet Tij të lartësojë të shtypurit, të pasurojë të varfërit dhe të shpëtojë të rënët. Sekreti i gjërave është i fshehur nga sytë tanë. Detyra jonë është të lëshojmë thirrjen e Ditës së Re dhe t'ua shpallim këtë Mesazh Hyjnor të gjithë njerëzve. Shumë shpirtra në këtë qytet do të derdhin gjakun në shtegun e tij. Ai gjak do të vadisë Pemën e Perëndisë, do ta bëjë atë të lulëzojë e të mbulojë gjithë njerëzimin".[15]

1. Çfarë bëri Báb·i pas emërimit të tetëmbëdhjetë Shkronjave të të Gjallit? _____

   _____

2. Kë zgjodhi Báb·i si shoqërues për në pelegrinazhin në Mekë? _____

   _____

3. Cilit vendi i përket Hijáz? _____

4. Mullá Ḥusayn·it, të parit që besoi tek Ai, Báb·i i tha: "_____ që nuk u zgjodhe të më shoqërosh Mua në _____ në _____ . Në vend të kësaj, do t'i drejtoj hapat e tu te qyteti që bart një _____ të një shenjtërie të _____ të tillë saqë as _____ e as _____ nuk mund të shpresojnë të krahasohen me të.

5. Çfarë i dha Báb·iMullá Ḥusayn·it? _____

   _____

6. Me të arritur në Ṭihrán, Mullá Ḥusayn·i zuri një dhomë në një shkollë për studime fetare. Si iu përgjigj drejtuesi i asaj shkolle Mesazhit të Báb·it? _____

   _____

7. Pse e çoi Perëndia Mullá Ḥusayn·in tek ajo shkollë? _____

   _____

8. Nga ishte nxënësi që iu përgjigj Mesazhit të Báb·it? _____

_____

9. Ku ishte shtëpia e të parëve të Bahá'u'lláh·ut? _____

10. Ashtu siç u shpjegua studenti nga Nuri, kur ju përgjigj pyetjeve të Mullá Husayn·it:

- Për cilat tipare të karakterit njihej i ati i Tij? _____

  _____

- Me çfarë e angazhonte vëmendjen e Bahá'u'lláh·u? _____

  _____

- Çfarë rangu e pozite kishte Ai? _____

  _____

- Si e kalonte kohën Ai? _____

  _____

11. Çfarë i kërkoi Mullá Ḥusayn·i nxënësit që të bënte _____

_____

12. Pasi Bahá'u'lláh·u kishte lexuar një faqe nga pergamena që i kishte dërguar Báb·i tha: "Me të vërtetë, unë them se kushdo që beson në _____ dhe njeh _____ të tij, e prapë _____, qoftë edhe për një çast të vetëm, të pranojë se këto _____ shpirt-trazuese janë të pajisura me po atë _____, ai me sigurinë më të madhe ka _____ në gjykimin e vet, dhe është _____ nga shtegu i _____".

13. Si e priti Mullá Ḥusayn·i dhuratën nga Bahá'u'lláh·u? _____

_____

14. Çfarë e çuditi nxënësin e ri tek sjellja e Mullá Husayn·itkur ai mori dhuratën._____

_____

_____

_____

_____

_____

15. Tregoni me fjalët tuaja atë çfarë i tha Mullá Husayn nxënësit nga Núri kur i dha lamutmirën.

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

PJESA 4

Báb·i i referohet Bahá'u'lláh·ut si "Ai Që Perëndia do ta shfaqë". Shkrimet e Báb·it, duke përfshirë Librin e Tij më të Shenjtë, Bayánin, përmbajnë referenca të panumërta ku i thuren lavde Atij Që Perëndia do ta shfaqë. Më poshtë janë disa citate nga Shkrimet e Báb·it sa për të na dhënë një shkëndijë lidhur me Rangun e Bahá'u'lláh·ut dhe lidhjen midis këtyre dy Manifestimeve Binjake.

> **"Dhe dije me siguri se me Parajsë nënkuptohet njohja e nënshtrimi ndaj Atij Që Perëndia do ta shfaqë, dhe me zjarr shoqëria e atyre shpirtrave që nuk i binden Atij ose nuk i nënshtrohen pëlqimit të Tij".[16]**

> **"…pastroje veshin tënd që të mos dëgjosh asgjë tjetër veç Perëndisë, dhe pastroje syrin tënd që të mos shohë asgjë tjetër veç Perëndinë, dhe ndërgjegjen tënde që të mos shquajë asgjë tjetër veç Perëndisë, dhe gjuhën tënde që të mos shprehë asgjë tjetër veç Perëndinë, dhe dorën tënde që të mos shkruajë asgjë tjetër veç fjalëve të Perëndisë, dhe dijen tënde që të mos kuptojë asgjë tjetër veç Perëndisë, dhe zemrën tënde që të mos ketë dëshirë tjetër veç Perëndisë, dhe po kështu pastro të gjitha veprimet e punët e tua që të mund të ushqehesh në parajsën e dashurisë së pastër, dhe kështu ndoshta të mund të arrish në praninë e Atij Që Perëndia do ta shfaqë, i stolisur me pastërti të kulluar që Ai e pëlqen shumë, dhe të spastrohesh nga cilidoqoftë që i ka kthyer shpinën Atij e nuk e mbështet Atë".[17]**

> **"Thuaj, me të vërtetë, pëlqimi i Atij Që Perëndia do ta shfaqë është pëlqimi i Perëndisë, kurse mospëlqimi i Atij Që Perëndia do ta shfaqë s'është veçse mospëlqimi i Perëndisë".[18]**

1. Kujt i referohet titulli: "Ai Që Perëndia do ta shfaqë"? _____

2. Báb·i inkurajon gjithë pasuesit e Tij ta përgatisin veten që të lejohen në praninë e Atij Që Perëndia do ta shfaqë. Çfarë u thotë Ai që të bëjnë?

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

3. Zgjidhni një nga citatet e mësipërme dhe e mësoni përmendësh.

PJESA 5

Nga momenti që Bahá'u'lláh·u dëshmoi për vërtetësinë e Revelacionit të Báb·it, Ai u ngrit për ta shpallur atë. Udhëtimi i parë që ndërmori për t'u mësuar njerëzve Besimin e ri u bë në shtëpinë e të parëve të Tij në Nur, në provincën e Mázindarán·it. Atje Ai shkoi në shtëpinë e familjes së Tij në fshatin Tákur.

Lajmi i ardhjes së Bahá'u'lláh·ut në Tákur u përhap shpejt në gjithë rajonin. Shumë prej zyrtarëve e ofiqarëve vendas erdhën ta përshëndesnin, e në të njëjtën kohë të mësonin prej Tij të rejat lidhur me mbretin, oborrin mbretëror dhe punët e shtetit. Por Bahá'u'lláh·u iu përgjigjej me pak interes pyetjeve të tyre. Ai e ndërronte shpejt temën e bisedës dhe fillonte të parashtronte në mënyrën më elokuente Mesazhin e shpallur nga Báb·i. Fjalët e Tij ishin kaq bindëse e argumentat e Tij kaq të fortë sa të gjithë habiteshin. Ata që e dëgjonin çuditeshin që një person i një pozite të lartë si Ai tregonte aq interes për çështje me të cilat zakonisht merreshin vetëm klerikët dhe udhëheqësit fetarë. Entuziazmi dhe njohuritë e thella të Tij, shpejt tërhoqën një numër të madh njerëzish në Besimin e ri, duke përfshirë këtu shumë individë të shquar e anëtarë të familjes së Tij. Askush nga ata që vinin në praninë e Tij nuk i shpëtonte dot rrjedhës së fjalëve të ëmbla të Tij apo nuk guxonte të kundërshtonte vërtetësinë e thënieve të Tij, askush përveç ungjit të Tij.

Ky ungj bëri gjithçka kish në dorë që të diskreditonte Bahá'u'lláh·un dhe vërtetësinë e Mesazhit që Ai kish sjellë. Por kur e pa se nuk ishte në gjendje ta bënte këtë, shkoi te një klerik i njohur mysliman dhe i kërkoi ndihmë. Ai shprehu pakënaqësinë që Bahá'u'lláh·u kishte ardhur në Nur dhe megjithëse nuk ishte klerik po u fliste njerëzve për çështje fetare. Ai e paralajmëroi teologun se gjithkush që vinte në praninë e Bahá'u'lláh·ut magjepsej prej Tij dhe rrëmbehej nga fuqia e fjalëve të Tij. "Nuk e di në është magjistar", tha ai, "apo e përzien çajin me ndonjë substancë që e bën çdo njeri që e pi të bjerë viktimë e magjepsjes".[19]

Duke ditur se nuk do t'ia dilte kurrë mbanë ta sfidonte Bahá'u'lláh·un, teologu nuk ua vari ankesave të ungjit. Po Mesazhi i Báb·it vazhdoi të përhapej si zjarr në tërë rajonin. Të alarmuar, pasuesit e teologut filluan t'i bënin presion që të ndërmerrte ndonjë veprim, dhe më së fundi ai vendosi të dërgonte dy nga nxënësit e tij më të shquar që t'i bënin një vizitë

Bahá'u'lláh·ut e të hetonin natyrën e Mesazhit që Ai po përhapte. Dhe ja historia e asaj që ndodhi kur këta dy përfaqësues erdhën në praninë e Bahá'u'lláh·ut.

Kur mbërritën në Tákur, me të marrë vesh se Bahá'u'lláh·u kishte shkuar në shtëpinë e Tij dimërore, përfaqësuesit e teologut vendosën ta ndiqnin atje. Kur arritën, e gjetën Bahá'u'lláh·un duke reveluar një koment për një nga kapitujt e Kuranit. Ndërsa po uleshindhe e dëgjonin, atyre u bëri përshtypje të thellë paraqitja elokuente e Tij dhe mënyra e jashtëzakonshme sesi fliste. Një nga përfaqësuesit, nuk mundi ta përmbante veten, u ngrit në këmbë e shkoi në fund të dhomës dhe me një qëndrim nënshtrimi e respekti qëndroi në këmbë pa lëvizur pranë derës. Duke u dridhur e me sy të përlotur, ai i tha shokut: "Unë nuk jam në gjendje ta pyes Bahá'u'lláh·un. Pyetjet që kisha ndërmend t'i drejtoja m'u fshinë papritur nga kujtesa. Ti je i lirë ose të vazhdosh me pyetjet ose të kthehesh vetëm te mësuesi ynë e t'i thuash se në çfarë gjendje jam. I thuaj nga ana ime se nuk mund të kthehem më kurrë tek ai. Nuk mund ta braktis më këtë prag". Por edhe përfaqësuesi tjetër ishte i shtangur po ashtu nga fjalët e Bahá'u'lláh·ut dhe ai ndoqi shembullin e shokut të vet. "Unë nuk e njoh më mësuesin tonë", ishte përgjigjja e tij. "Në këtë çast, i jam betuar Perëndisë t'ia përkushtoj ditët që më mbeten nga jeta ime në shërbim të Bahá'u'lláh·ut, Mësuesit tim të vërtetë e të vetëm".[20]

Lajmi i bisedës së nxënësve të teologut u përhap me shpejtësi midis popullatës së Nurit. Dinjitarë, zyrtarë shtetërorë, udhëheqës fetarë, tregtarë e fshatarë u mblodhën në praninë e Bahá'u'lláh·ut. Qindra prej tyre u mblodhën në flamurin e Fesë së re. Askush veç Bahá'u'lláh·ut nuk e dinte, megjithatë, se përndjekje të tmerrshme do të pasonin së shpejti, përndjekje që do të shkulnin nga rrënjët shumë prej këtyre fidanëve të rinj e të njomë.

1. Çfarë bëri Bahá'u'lláh pas dëshmisë për vërtetësinë e Revelacionit të Báb·it? _____

_____

2. Si u prit Bahá'u'lláh·u nga banorët e Nurit? _____

_____

3. Pse habiteshin disa njerëz nga mënyra sesi Bahá'u'lláh·u u përgjigjej pyetjeve të tyre?

_____

_____

4. Çfarë bëri i ungji i Bahá'u'lláh·ut kur Ai filloi të shpallte Kauzën e Báb·it? _____

_____

_____

_____

5. Pse nuk ua vuri veshin teologu ankimeve të ungjit _____

_____

6. Çfarë vendosi të bënte më në fund teologu kur pasuesit e tij filluan t'i bënin presion?

_____

_____

7. Tregoni me fjalët tuaja historinë e dy përfaqësuesve të teologut që erdhën në praninë e Bahá'u'lláh·ut.

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

8. Çfarë efekti pati biseda e dy përfaqësuesve në përparimin e Kauzës së Báb·itnëMázindarán? _____

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 6

Ajo që Bahá'u'lláh·u bëri në krahinën e Nurit është ajo që Ai na kërkon neve të bëjmë: të ngrihemi e t'u mësojmë njerëzve Kauzën e Perëndisë. Le të studiojmë pra e të përsiatim rreth

fjalëve të mëposhtme të Bahá'u'lláh·ut, duke mbajtur parasysh se pasi Ai pranoi Revelacionin e Báb·it, veprimi i Tij i parë ishte të ngrihej e të mësonte qindra e qindra shpirtra.

> **"O udhëtar në shtegun e Perëndisë! Merr pjesën tënde të oqeanittë mirësisë së Tij, dhe mos ia moho vetes gjërat që fshihen në thellësitë e tij. Ji ndër ata që kanë marrë pjesë nga thesaret e tij. Një pikë e vetme e këtij oqeani, po të derdhej mbi të gjithë ata që janë në qiejt e mbi tokë, do të mjaftonte për t'i mbushur ata me bujarinë e Perëndisë, Fuqiplotit, të Gjithëdijshmit, Urtiplotit. Me duart e vetëmohimit merr nga ujërat e tij jetëdhënëse dhe spërkat të gjitha gjërat e krijuara, që ato të pastrohen nga të gjitha kufizimet e krijuara prej njeriut dhe t'i aviten fronit të fuqishëm të Perëndisë, këtij Vendi të shenjtëruar e të ndritshëm.**
>
> **"Mos u hidhëro nëse duhet ta bësh këtë i vetëm. Perëndia le të jetë i gjithëmjaftueshëm për ty. Hyr në komunikim intim me Shpirtin e Tij, dhe ji ndër ata që tregohen mirënjohës. Shpallu Kauzën e Zotit tënd të gjithë atyre që janë në qiejt e mbi tokë. Nëse ndokush i përgjigjet thirrjes sate, shtro para tij margaritarët e urtisë së Zotit, Perëndisë sate, që të ka sjellë Shpirti i Tij, dhe ji ndër ata që me të vërtetë besojnë. Dhe nëse ndokush e refuzon ofertën tënde, largohu prej tij, dhe mbështete besimin e sigurinë tënde te Zoti, Perëndia yt, Zoti i të gjitha botëve".[21]**

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

   a. Bahá'u'lláh·u na kërkon të marrim pjesën tonë _____ _____ .

   b. Ne nuk duhet ta privojmë veten nga _____ _____ .

   c. Një pikë e vetme nga oqeani i mirësisë së Tij, nëse derdhet mbi të gjithë ata që janë në qiejt e mbi tokë, do të mjaftonte për t'i _____ _____ _____ .

   d. Neve na kërkohet të marrim _____ , e të spërkasim _____ .

   e. Nuk duhet të hidhërohemi nëse _____ .

   f. Ne duhet të komunikojmë _____ e të jemi _____ .

   g. Ne duhet të shpallim _____ _____ .

h. Nëse ndokush i përgjigjet thirrjes sonë, Bahá'u'lláh na thotë të _____

_____

_____ .

i. Nëse dikush e refuzon ofertën tonë, ne duhet _____

_____

_____ .

PJESA 7

Revelacioni Hyjnor vjen në rritje. Perëndia e revelon Vullnetin e Tij gradualisht në rritje nëpërmjet Manifestimeve të Tij që vijnë nga koha në kohë ndërsa njerëzimi përparon nga një stad në tjetrin. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për Revelacionin e çdo Manifestimi. Mësimet e Tij revelohen gradualisht krahas rritjes së shkallës së të kuptuarit të pasuesve të Tij. Shpeshherë, edhe dishepujt e Tij më të afërt në fillim nuk janë në gjendje të kapin domethënien e plotë të Revelacionit të Tij. Ata vazhdojnë t'u përmbahen ligjeve e Mësimeve të fesë së mëparshme. Vetëm me kalimin e kohës ata arrijnë të kuptojnë se Manifestimi i ri ndryshon disa nga ligjet e Atij që kishte ardhur para Tij. Qëllimi i Tij është të formulojë ligje të reja për stadin tjetër të zhvillimit të njerëzimit.

Kështu ndodhi edhe me Revelacionin e Báb·it. Myslimanët, midis të cilëve u shfaq Báb·i, besonin se as edhe një "shkronjë" nga Mësimet e Profetit Muhamet nuk mund të ndryshohej deri në fundin e botës. Prandaj Báb·i e bëri të njohur vetëm gradualisht Mesazhin e Tij të plotë. Gjatë viteve të para të Misionit të Tij nuk u bënë ndryshime në ligjet e Islamit. Në fakt, kjo as që u shkonte nëpër mend qoftë edhe pasuesve më të ngushtë të Tij. Por, siç e dini, kur ishte më vonë i burgosur në kështjellën e Máh-Kú·së, Báb·i reveloi një varg të ri ligjesh në Bayánin Persian. Tani ishte koha që pasuesit e Tij të shkëputeshin përfundimisht nga e kaluara dhe të shpallnin Pozitën e Tij të vërtetë si një Manifestim i Perëndisë. Kjo u bë në Konferencën e Badashtit.

Badashti është një fshat në njëfarë distance nga Ṭihrán·i në pjesën verilindore të vendit. Konferenca e Badashtit u mbajt në korrik të vitit 1848. Tetëdhjetë e një nga pasuesit më të shquar të Báb·it u mblodhën së bashku në këtë konferencë. Pjesëmarrësit kryesorë ishin Bahá'u'lláh·u, Quddús·i dhe Ṭáhirih·ja.

Megjithëse Bahá'u'lláh·u kishte një rang të lartë midis miqve të tij dishepuj të Báb·it, të cilët e vlerësonin njohurinë dhe urtësinë e Tij dhe kërkonin nga Ai që t'i udhëhiqte, në konferencë u manifestuan masa dhe madhështia e Tij në një nivel më tej.Me të vërtetë, roli i Tij në Konferencë ishte vendimtar. Ai mori me qera kopshtet në të cilat u mbajt konferenca, dhe për njëzet e dy ditë gjithë pjesëmarrësit shijuan mikpritjen e Tij bujare. Çdo ditë Bahá'u'lláh·u revelonte nga një tabelë për t'u lexuar para besimtarëve të mbledhur. Ai i dha secilit nga një emër të ri. Ṭáhirih·së dhe Quddús·it u dha titujt me të cilët këta njihen në histori. Titulli Ṭáhirih do të thotë "e Dëlira", dhe Quddús do të thotë "i shenjti". Ai Vetë, që prej asaj kohe do të njihej me emrin Bahá. Më vonë Báb·i u shkroi nga një letër të gjithëve, ku u drejtohej me emrat e rinj që kishin marrë me atë rast.

Një ditë Bahá'u'lláh·u ishte në shtrat i sëmurë, dhe miqtë ishin mbledhur në praninë e Tij. Kur, papritur, Ṭáhirih·ja, që konsiderohej si thelbi i dëlirësisë e i pastërtisë morale, u shfaq para tyre pa perçen që sipas besimit të myslimanëve në Iran të gjitha gratë duhej ta mbanin në publik. Disa prej Babí·ve të pranishëm, ishin të mendimit se ajo turpëroi veten dhe Besimin e ri. Quddús·i dukej qartë se ishte zemëruar. Por Ṭáhirih·ja, e patundur dhe e mbushur me gëzim, iu drejtua shokëve të saj me shumë elokuencë. U bëri thirrje të shkëputeshin nga e kaluara – nga dogmat e saj fetare, traditat dhe ceremonitë e saj. Tensioni që u krijua midis Quddús·it e Ṭáhirih·së u qetësua me ndërhyrjen e Bahá'u'lláh·ut. Një numër i vogël pasuesish të Báb·it e braktisën Besimin si rezultat i këtij qëndrimi, por shumica qëndruan të patundur dhe u mbushën me entuziazëm të ri. Bahá'u'lláh·u kishte shfrytëzuar me mjeshtri këtë rast për të njoftuar agimin e një Dite të re. Ṭáhirih·ja, nëpërmjet veprimit të saj guximtar, i kishte rënë borisë duke lajmëruar fundin e besimit të vjetër dhe fillimin e një Besimi të ri.

Konferenca e Badashtit shënoi gjithashtu fillimin e periudhës më të trazuar në zhvillimin e Besimit Babí. Së shpejti përndjekjet e pasuesve të tij do të arrinin nivele të reja intensiteti, dhe shumë prej tyre do të thirreshin për t'u martirizuar. Ndodhi sikur konferenca të ishte një takim lamtumire, nga ku ata do të shpërndaheshin për të kryer vepra të mëdha heroizmi, për t'u bashkuar përsëri vetëm përtej në mbretëritë shpirtërore.

Ata që ishin të pranishëm në Konferencë u nisën së bashku për në Mázindarán, por në rrugë e sipër u sulmuan nga banorët injorantë të një fshati, pranë të cilit grupi kishte ndaluar për të pushuar. Besimtarët u shtrënguan të largohen dhe u shpërndanë në drejtime të ndryshme. Bahá'u'lláh·u vazhdoi rrugën drejt Nurit në Mázindarán.

Lajmi i Konferencës së Badashtit arriti shpejt në Ṭihrán, dhe Mbreti e ministrat e tij mësuan për ngjarjet që kishin ndodhur dhe rolin që kishte luajtur Bahá'u'lláh·u në atë Konferencë. Mbreti, i cili vuante nga një sëmundje që së shpejti do t'i merrte jetën, u këshillua nga kryeministri të lëshonte një urdhër-arresti për Bahá'u'lláh·un. Kështu, u dërgua një urdhër për një nga zyrtarët e Mázindarán·it, të cilit i kërkohej ta arrestonte Bahá'u'lláh·un dhe ta sillte në kryeqytet. Urdhri mbërriti një ditë para se ky zyrtar të jepte një pritje për Bahá'u'lláh·un, të cilin ai e kishte shumë për zemër. Ai u mërzit shumë dhe vendosi të mos i thotë gjë njeriu. Të nesërmen, në Mázindarán arritën lajmet se mbreti kishte vdekur; urdhër-arresti nuk ishte më në fuqi.

1. Cili ishte qëllimi i Konferencës së Badashtit? _____

   _____

2. Kur u mbajt konferenca e Badashtit? _____

3. Sa ditë zgjati? _____

4. Sa pasues të Báb·it morën pjesë? _____

5. Cilët ishin pjesëmarrësit kryesorë? _____

   _____

6. Kush ishte figura më e rëndësishme midis të pranishmëve? _____

7. Çfarë do të thotë titulli “Ṭáhirih”? _____

8. Çfarë do të thotë titulli “Quddús”? _____

9. Tregoni me fjalët tuaja ngjarjet, që ndodhën në Konferencë ditën që Ṭáhirih·ja erdhi pa perçe

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

10. Çfarë sinjalizoi vepra guximtare e Ṭáhirih·së? _____
_____

11. Çfarë bëri qeveria kur mori lajmet për mbledhjen eBadashtit? _____
_____

12. Shpjegoni çfarë ndodhi pasi qeveria lëshoi urdhër arrestin për Bahá’u’lláh·un:

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

PJESA 8

Konferenca e Badashtit shënoi zhveshjen e së vjetrës dhe përqafimin e së resë. Pasazhi i mëposhtëm nga shkrimet e 'Abdu'l-Bahá·it tregon se si herë pas here gjatë epokave, feja e Perëndisë duhet përtëritur. Përsiatni mbi kuptimin e këtij citati në dritën e atyre që studiuat lidhur me Konferencën e Badashtit.

> **"Nga fara e realitetit feja është rritur e është bërë një pemë që ka nxjerrë degë e gjethe, lule e fruta. Pas një kohe kjo pemë kalbet. Gjethet e lulet thahen e bien ; pema prishet e nuk jep më fruta. Nuk është e arsyeshme që njeriu të mbajë pemën e vjetër, duke thënë se forcat jetësore të saj janë të pashtershme, frutat të pakrahasueshme dhe ekzistenca e saj e përjetshme. Fara e realitetit duhet rimbjellë në zemrat njerëzore, që një pemë e re të mbijë prej saj dhe që fruta të rinj hyjnorë të freskojnë botën. Kështu kombet e popujt që sot janë të përçarë nga feja, do të bashkohen, imitimet do të braktisen dhe një vëllazëri botërore do të vendoset në vetë realitetin. Lufta dhe konfliktet midis njerëzimit do të pushojnë; të gjithë do të pajtohen si shërbëtorë të Perëndisë. Sepse të gjithë do të gjejnë strehë nën pemën e provanisë e të mëshirës së Tij. Perëndia është i dashur me të gjithë; Ai është dhuruesi i bujarisë ndaj të gjithëve njësoj, ashtu siç ka thënë Jezu Krishti se Perëndia 'dërgon shi njësoj si mbi të drejtin e të padrejtin' – domethënë se mëshira e Perëndisë është e përbotshme. Gjithë njerëzimi është nën mbrojtjen e dashurisë e të favorit të Tij, dhe të gjithëve Ai u tregon rrugën e udhëheqjes e të përparimit".[22]**

PJESA 9

Náṣiri'd-Dín Sháh·u, mbreti që hipi në fron më 1848, ishte shumë më i pamëshirshëm se i ati, mbreti i mëparshëm. Që nga fillimi i mbretërimit të tij përndjekjet e Bábí·ve u shtuan në mënyrë dramatike. Vetë Báb·i u martirizua në korrik 1850 në Tabríz. Pasuesit e Tij të shtypur, që kishin parë me sytë e tyre vdekjen e mijëra shokëve të tyre besimtarë, kishin humbur tani të Shumëdashurin e zemrave të tyre. Në mendjen e tyre, shumë ia vinin fajin mbretit për mizoritë që po vuanin për vite të tëra. Por pavarësisht nga këto ndjenja, ata vazhdonin t'ia donin të mirën qeverisë dhe popullit. Energjitë e tyre iu kushtuan përhapjes së Besimit të ri nëpërmjet fuqisë së veprave të mira e të argumentave bindës. Megjithatë, kishte një grup të vogël njerëzish që, të shtyrë nga zemërimi i madh, po luanin me ide të rrezikshme. Në një gjendje dëshpërimi, këta pak besimtarë të çoroditur besuan se mund të ndryshonin fatin e komunitetit Bábí duke e goditur tiraninë në rrënjët e saj. Ata filluan të komplotonin për vrasjen e mbretit.

Qëllimet e grupit iu komunikuan Bahá'u'lláh·ut nga njëri prej drejtuesve të tij. Bahá'u'lláh·u e këshilloi atë në mënyrën më të qartë se duhej të hiqnin dorë nga ai plan. Ai i paralajmëroi se një veprim i tillë do të sillte vuajtje të reja për ndjekësit e pikëlluar të Báb·it. Por komplotistët ishin në një gjendje të tillë hidhërimi, dhe zjarri i hakmarrjes u digjte aq fort në zemër, saqë edhe këshillat e Bahá'u'lláh·ut nuk mundën t'i ndalnin. Ata kryen një akt që do të konsiderohet përgjithmonë një njollë në historinë e komunitetit Bábí, e cila është e stolisur vetëm me vepra të kulluara, vetëmohuese e heroike.

Më 15 gusht 1852, mbreti u nis kaluar nga rezidenca e tij verore pranë Ṭihrán·it për shëtitjen e mëngjesit. Rojet personale shkonin disa hapa para tij. Ajri ishte i qetë, gjithçka

shkonte mirë për Madhërinë e tij. Papritur, duke i zënë të gjithë në befasi, një djalë i ri që priste në anë të rrugës, me pretendimin se kishte një peticion për mbretin, u përpoq të vrasë atë. Kaq i çoroditur ishte ky atentator, saqë pistoletën e kishte mbushur me saçme, krejt të papërshtatshme për qëllimin që kishte. Mbreti u plagos fare lehtë, por tërbimi që shkaktoi atentati mbi jetën e tij u dha armiqve të Besimit një shkak për të nxitur njerëzit të kryenin veprime të paimagjinueshme për nga egërsia kundër Bábí·ve.

Ky i ri fatkeq u vra në vend. Trupin e tij e lidhën pas bishtit të një mushke dhe e tërhoqën zvarrë gjatë tërë rrugës deri në Ṭihrán, ku e çanë dy copësh dhe e varën që ta shihte publiku. Bashkëfajtorit të tij i derdhën në grykë plumb të shkrirë – vetëm pasi e kishin torturuar pa mëshirë, e megjithatë kishte refuzuar të jepte emrat e shokëve të tjerë. Shoku i tij i zhveshën rrobat dhe i vendosën qirinj të ndezur në vrimat që i kishin hapur në mish, e nxorrën përpara turmave që e shanin dhe e mallkonin.

Ajo që ndodhi më pas nuk mund të përshkruhet me fjalë. Qeveria, kleri dhe mbështetësit e tyre injorantë u ngritën të asgjësonin Bábí·të. Portat e qytetit u mbyllën dhe askush nuk lejohej të hynte a të dilte pa u marrë në pyetje. Bábí·të kërkoheshin në çdo shtëpi, arrestoheshin e vriteshin me një egërsi shumë e tmerrshme për t'u treguar në këto faqe.

Ditën që u krye atentati kundër jetës së Shahut, Bahá'u'lláh·u ishte mysafir te vëllai i kryeministrit në një fshat afër Ṭihrán·it. Lajmi i fatkeqësisë arriti aty shpejt dhe Bahá'u'lláh·un e këshilluan të fshihej derisa të kalonte furtuna. E ëma e mbretit ia vinte fajin Bahá'u'lláh·ut për atentatin kundër jetës së të birit dhe kërkonte arrestimin e Tij. Por Bahá'u'lláh·u refuzoi të fshihej; përkundrazi, të nesërmen i hipi kalit dhe u nis për në selinë qendrore të mbretit. Mbreti dhe oborri i tij u habitën kur morën vesh se po vinte Bahá'u'lláh·u. Si mundej dikush që ishte akuzuar për një krim kaq të tmerrshëm të vinte me aq besim drejt rrezikut, në vend që t'ia mbathte? Mbreti urdhëroi menjëherë arrestimin e Bahá'u'lláh·ut. Përpjekjet e disa miqve të Tij për të gjetur një strehë të sigurt në shtëpinë e kryeministrit dështuan. Atë e arrestuan në fshatin Shimírán, nja 30 km larg kryeqytetit, dhe e lidhën me zinxhirë.

Në këmbë e kokë zbuluar nën rrezet përvëluese të diellit të mesit të verës, Bahá'u'lláh·un e sollën nga Shimírán·i në Ṭihrán. Turmat e njerëzve, të cilëve u kishin thënë se Ai ishte armiku i mbretit të tyre, e shanin me të bërtitura gjatë rrugës. Historia e asaj gruas plakë që donte ta qëllonte me gur ndërsa Ai po i afrohej burgut të nëndheshëm ku do ta mbyllnin, tregon çmendurinë që kishte përfshirë turmën atë ditë dhe dashurinë që kishte zënë vend në zemrën e Tij ndërsa përballej me vuajtjet më të rënda.

Bahá'u'lláh·u po i afrohej burgut në të cilin ai do të burgosej, kur u pa një grua plakë dhe e dobët që përpiqej të çante rrugë midis turmës me një gur në dorë, për të goditur Bahá'u'lláh·un në fytyrë me të. Kishte një pamje të vendosur e fanatike që vetëm pak gra në moshën e saj mund ta kenë. Tërë trupi i dridhej nga tërbimi kur çau përpara dhe ngriti gurin. "Ju përgjërohem", u thoshte atyre që mbanin të lidhur Bahá'u'lláh·un, "më jepni mundësinë ta qëlloj me gur në fytyrë!" "Mos lejoni që kjo grua të zhgënjehet" ishin fjalët që Bahá'u'lláh·u u drejtoi rojeve, kur e pa gruan plakë të sulej drejt Tij. "Mos ia mohoni atë që ajo e mendon si një vepër të lavdërueshme në sytë e Perëndisë".[24]

1. Cili ishte emri i mbretit që hipi në fronin e Persisë më 1848? _____

_____

2. Çfarë efekti pati fillimi i mbretërimit të Náṣiri'd-Dín Sháh·ut në trajtimin e Bábí·ve

_____

_____

3. Si ndjeheshin Bábí·të në përgjithësi pas martirizimit të Báb·it? _____

_____

4. Cila ishte gjendja mendore e grupit të Bábí·ve që vendosën të vrisnin mbretin? ____

_____

_____

5. Çfarë i tha Bahá'u'lláh·u drejtuesit të grupit kur mori vesh qëllimet e tyre? _____

_____

_____

_____

6. Në çfarë datë ndodhi atentati kundër jetës së mbretit? _____

7. Cili qe fati i atyre që u orvatën të kryejnë vrasjen? _____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

8. Çfarë pasojash pati atentati për komunitetin Bábí? _____

_____

_____

_____

9. Ku ndodhej Bahá'u'lláh·u kur mori vesh për atentatin kundër jetës së mbretit? ____

_____

10. Çfarë bëri Bahá'u'lláh·u kur mori vesh lajmin për atentatin? _____

_____

11. Në cilin fshat e arrestuan Bahá'u'lláh·un? _____

12. Meqenëse Bahá'u'lláh·u nuk ishte i pafuqishëm përpara armiqve të Tij, atëherë psemendoni se lejoi Ai ta arrestonin, duke e ditur rrezikun në të cilin do ta vinte Veten?

_____

_____

_____

_____

13. Nën çfarë kushtesh u soll Bahá'u'lláh·u nga Shimírán·i në Ṭihrán? _____

_____

_____

14. Tregoni me fjalët tuaja historinë e gruas plakë që donte të qëllonte Bahá'u'lláh·un me gur në fytyrë ndërsa rojet po e çonin Atë në burg. Çfarë provon kjo histori?

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 10

Gjatë gjithë jetës së Tij, Bahá'u'lláh·u ishte i rrethuar nga armiq që i donin të keqen. Por Ai kurrë nuk u përpoq të fshihej; kurrë nuk e mbrojti Veten e Tij. Përkundrazi, në çdo kohë Ai ishte i dukshëm para syve të njerëzve dhe u qëndroi me gjakftohtësi e qetësi sulmeve të të gjithë atyre që iu kundërvunë Atij. Megjithëse qenë të vendosur ta shuanin dritën e Tij, ata nuk ishin në gjendje t'ia arrinin qëllimit, dhe nga dita në ditë shkëlqimi i Tij u bë më rrezatues.

> **"As edhe për një çast të vetëm Ky i Munduar nuk është fshehur. Përkundrazi, ka qëndruar kurdoherë i patundur e i hapur para syve të të gjithë njerëzve. Ne kurrë nuk jemi tërhequr, as do të kërkojmë të arratisemi. Në të vërtetë janë njerëzit e marrë që largohen nga prania Jonë... Lëvduar qoftë Perëndia! Kauza, bartës i së cilës është Ky i Munduar, qëndron lart sa qielli dhe shkëlqen e ndritshme si dielli. Fshehja nuk lejohet në këtë pozitë, dhe as ka ndonjë arsye për të pasur frikë apo për të heshtur".[25]**

> **"I pambuluar e i pafshehur, ky i Munduar ka shpallur kurdoherë para të gjithë popujve të botës atë që do të shërbejë si çelës për të hapur dyert e shkencave, të arteve, të dijes, të mirëqenies, të begatisë e të pasurisë. Padrejtësitë e kryera nga shtypësit nuk ia kanë arritur ta bëjnë të heshtë zërin e mprehtë të Penës Më Të Lartësuar, dhe as kanë mundur dyshimet e të mbrapshtëve ta pengojnë Atë të revelojë Fjalën Më Sublime".[26]**

1. Përshkruani me fjalët tuaja se si duhet të veprojmë ne Bahá'i·të që duam të mbrojmë Kauzën e Bahá'u'lláh·ut përballë vështirësive.

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 11

"Síyáh-Chál", emri i burgut në të cilin çuan Bahá'u'lláh·un në atë ditë fatkeqe, do të thotë "Pusi i Zi". Më parë kishte qenë rezervuar uji për një nga banjat publike të Ṭihrán·it, dhe më pas e kishin kthyer në një burg të nëndheshëm ku mbyllnin kriminelët më të rrezikshëm.

Që të arrihej qelia, na duhej të kalonimpërmes një korridori pus të errët dhe poshtë tre palë shkallëve. Të mbështjellë prej errësirës së ftohtë, ishte një i ftohtë akull, dhe sheshi i mbuluar me fëlliqësi dhe parazitë zvarranikë. Bahá'u'lláh·u Vetë i përshkruan kushtet e tmerrshme në të cilat Ai ishte burgosur:

"Me mbërritjen tonë na drejtuan së pari nëpër një korridor pis të zi e pastaj nëpër tri palë shkallë të pjerrëta thikë për tek vendi i izolimit i caktuar për ne. Bodrumin e mbështillte një errësirë e thellë dhe të burgosurit e tjerë si ne numëronin afërsisht një qind e pesëdhjetë shpirtra: hajdutë, vrasës dhe endacakë. Megjithëse i mbushur plot nuk kishte dalje tjetër për ndriçim e ajrim veç korridorit nga hyhej. Asnjë penë nuk mundet t'a përshkruajë atë vend, as ndonjë gjuhë t'a përshkruajë erën e ndyrë.Shumica e të burgosurve nuk kishin as rroba e as ndonjë shtresë për t'u shtrirë. Vetëm Perëndia e di se çfarë na ra Ne në kokë në atë vend me erë kutërbuese dhe të zymtë."[26]

Në këto kushte të egra u burgosën nga mbreti Bahá'u'lláh·u dhe një numër Bábí·sh. Bahá'u'lláh·ut ia lidhën këmbët me pranga dhe një zinxhir i rëndë që peshonte nja 50 kg iu vu rreth qafës. Tri ditët e tri netët e para atyre nuk u dhanë asgjë për të ngrënë ose për të pirë. Familja e Bahá'u'lláh·ut përgatiste ushqim për të dhe u lutej rojeve t'ia çonin. Në fillim ata nuk ua vinin veshin, por pak nga pak lëshuan pe para lutjeve të tyre. Por edhe atëherë askush nuk ishte i sigurt nëse ushqimi vërtet arrinte tek Ai, apo nëse Ai do të pranonte të hante kur të burgosurit e tjerë vuanin nga uria.

Bahá'u'lláh·un dhe shokët e Tij, edhe ata të lidhur me pranga e me zinxhirë, i kishin ngjeshur të gjithë bashkë në një qeli. I kishin vendosur në dy radhë përballë njëra-tjetrës. Bahá'u'lláh·u i mësoi të përsëritnin disa vargje, që ata i këndonin çdo natë me shumë zjarr. Njëri rresht këndonte: "Perëndia është i mjaftueshëm për mua; Ai me të vërtetë është i Gjithëmjaftueshmi", dhe rreshti tjetër përgjigjej: "Tek Ai le ta mbështesë besimin ai që beson!" Në orët e para të mëngjesit, dëgjohej kori i zërave të tyre të lumtur. Kaq e fortë ishte melodia e tyre saqë arriti në veshët e mbretit, pallati i të cilit nuk ishte larg Síyáh-Chál·it. "Çfarë është ky tingull?" thuhet të ketë pyetur ai. "Është himni i Bábí·ve që e këndojnë në burg",[27] ishte përgjigjja. Mbreti heshti.

Çdo ditë, rojet e burgut hynin në qeli dhe thërrisnin emrin e njërit prej Bábí·ve, të cilin e urdhëronin të ngrihej e t'i ndiqte te këmbët e trekëmbëshit. Me gjithë dëshirë, bartësi i emrit i përgjigjej thirrjes. Sapo ia hiqnin zinxhirët, ai brofte në këmbë dhe, në një gjendje gëzimi të papërmbajtur, i afrohej Bahá'u'lláh·ut dhe e përqafonte. Pastaj përqafonte secilin prej të burgosurve të qelisë, dhe nisej me zemrën plot shpresë e gëzim, drejt vdekjes që e priste. Pak kohë pas martirizimit të secilit prej këtyre shpirtrave heroikë, ekzekutuesi, që kishte fituar admirim përBahá'u'lláh·un, vinte dhe e informonte për rrethanat e vdekjes së martirit dhe për gëzimin me të cilin kishte duruar deri në fund vuajtjet që i kishin shkaktuar.

1. Çfarë emri kishte burgu ku futën Bahá'u'lláh·un? _____

   _____

2. Çfarë do të thotë: Síyáh-Chál? _____

3. Për çfarë shërbente Síyáh-Chál·i më parë? _____

   _____

4. Përshkruani kushtet e Síyáh-Chál·it:

5. Çfarë i vunë në qafë Bahá'u'lláh·ut kur mbërriti në Síyáh-Chál? _____

6. Me çfarë ia lidhën këmbët Atij? _____

7. Si i vendosën Bahá'u'lláh·un dhe shokët e Tij në qeli? _____

8. Çfarë i mësoi ata Bahá'u'lláh·u të bënin? _____

9. Çfarë këndonte njëri rresht i Bábí·ve gjatë natës? _____

10. Si do të përgjigjej rreshti tjetër? _____

11. Çfarë efekti pati të kënduarit e tyre te mbreti? _____

12. Çdo ditë rojet e burgut hynin në qelinëku ishin burgosur Bahá'u'lláh·u dhe shokët e Tij dhe thërrisnin emrin e njërit prej Bábí·ve. Shpjegoni me fjalët tuaja çfarë ndodhte pastaj:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

13. Si mendoni, përse Bábí·të ishin aq të mbushur me gëzim, megjithë kushtet e tmerrshme të burgut ku ndodheshin? _____

_____

_____

PJESA 12

Ka një koncept të thellë të cilin çdo nxënës i historisë Bahá'í duhet t'a kuptojë-siç i themi, Kauza e Perëndisë përparon përmes një serie krizash dhe fitoresh. Saherë që forcat e injorancës, padrejtësisë, mizorisë dhe fanatizmit e mësyjnë Kauzën, duke i dhënë shtysë një krize, një masë korresponduese e fuqisë së saj të brendshme çlirohet dhe forcat tejkalohen, duke u dhënë mamuzeve të Kauzës drejt fitoreve të reja, të cilat herët a vonë, provokojnë një shpërthim të ri kundërshtimi, i pa imagjinuar më parë, i cili shërben, nga ana e tij, të çlirojë një masë të mëtejshme nga fuqia e vetë Hyjnore. Kështu është që Kauza e Perëndisë lëviz nga kriza në fitore në krizë në fitore dhe asnjë forcë mbi tokë nuk është e aftë t'a ndalojë marshimin e saj përpara.

Shërbesa e shkurtër e Báb·it kishte ndjekur tashmë një rrugë të tillë. Një vëzhgues i zakonshëm, gjithsesi do të kishte thënë se kriza e fundit nuk mund të kapërcehej: Báb·i ishte martirizuar. Mijëra pasues të Tij ishin vrarë gjatë masakrave të një egërsie të parrëfyeshme. Dishepulli më i shquar i Tij qe martirizuar, dhe I Vetmi që mund të rigjallëronte shpresën ishte i lidhur me zinxhirë në burgun më të errët. Kriza ishte vërtet e thellë, por fitorja që do ta pasonte ishte shumë e lavdishme.

Në Síyáh-Chál, Perëndia i bëri të ditur Bahá'u'lláh·ut lartësinë e Pozitën e Tij. I rrethuar nga errësira, duke thithur ajrin më të ndyrë, me këmbët në pranga e me një zinxhir të rëndë në qafë, Bahá'u'lláh·u mori nënkuptimet e paratë Revelacionit të Perëndisë. Në këto kushte të tmerrshme, "Shpirti i Madh" ia shfaqi veten Atij, duke e urdhëruar të ngrihej e të thoshte Fjalën e Perëndisë.

Nganjëherë, Ai ndihej sikur diçka i rridhte nga maja e kokës mbi kraharor, si një rrëke e fuqishme që bie mbi tokë nga maja e një mali të lartë. Ai pa Vashën e Qiellit që qëndronte pezull para Tij, duke i folur qenies së brendshme e të jashtme të Tij, duke e quajtur Atë i Shumëdashuri i botëve, Bukuria e Perëndisë dhe fuqia e sovranitetit të Perëndisë. Atij iu dha

siguria se do të bëhej fitimtar falë Vetvetes e Penës së Tij, dhe me ndihmën e atyre që Perëndia do të ngrinte në këmbë.

Kështu nga errësira e Pusit të Zi doli Dielli i së Vërtetës. Premtimi i Báb·it u përmbush. Lindi Revelacioni Bahá'í. Megjithatë, Bahá'u'lláh·u nuk informoi asnjeri për çka kishte ndodhur. Do të priste kohën e caktuar, të urdhëruar nga Perëndia, për ta bërë të njohur Misionin e Tij.

Ushtrime

1. Përshkruani me fjalët tuaja sa e rreptë ishte kriza në të cilën gjendej komuniteti Bábí në kohën e burgimit të Bahá'u'lláh·ut.

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

2. Cila ishte fitorja që pasoi këtë krizë të thellë? _____

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

PJESA 13

Njerëzimi është me fat që këtë ngjarje monumentale në historinë e besimeve fetare e ka të regjistruar nga Bahá'u'lláh·u me vetë Fjalët e Tij. Duke sjellë ndërmend mënyrën se si Revelacioni i Perëndisë mbushi herën e parë shpirtin e Tij, Ai thotë:

> **"Një natë në ëndërr, në të katër anët u dëgjuan këto fjalë të lartësuar: 'Me të vërtetë, Ne do të Të bëjmë Ty fitimtar përmes Vetes Sate e Penës Sate. Mos u**

brengos për atë që të ka ndodhur, e as mos ki frikë, sepse je në siguri. Së shpejti Perëndia do të nxjerrë thesaret e tokës – njerëz që do të Të ndihmojnë përmes Vetes Sate e nëpërmjet Emrit Tënd, me të cilin Perëndia ka ringjallur zemrat e atyre që E kanë njohur'".[30]

Në këtë fragment, Bahá'u'lláh·u na tregon ne se një natë në një ëndërr, këto fjalë u dëgjuan nga çdo anë: Me të vërtetë, Ne do të të bëjmë Ty _____ përmes _____ dhe përmes _____. Mos vajto për atë që të _____ E as mos _____ , sepse_____ . Së shpejti Perëndia do të _____ e tokës---_____të cilët do të ndihmojnë typërmes _____ dhe nëpërmjet _____ , me të cilin Perëndia ka _____ zemrat e atyre që E kanë _____ .

Në një pasazh tjetër Bahá'u'lláh·u e përshkruan ndikimin e Revelacionit të Perëndisë mbi qenien e Tij:

"Gjatë ditëve që isha në burg në Ṭihrán, megjithëse pesha dërrmuese e zinxhirëve dhe kutërbimi i ajrit s'më linin të flija veçse pak, prapëseprapë në ato momente të rralla dremitjeje ndjenja sikur diçka më rridhte nga maja e kokës mbi kraharor, si një rrëke e fuqishme që bie mbi tokë nga maja e një mali të lartë. Si rezultat, çdo gjymtyrë e trupit tim ndizej zjarr. Në ato momente gjuha ime recitonte ato që asnjë njeri nuk është në gjendje t'i mbajë po t'i dëgjojë".[31]

Bahá'u'lláh·u thotë se gjatë ditëve që ishte në _____ në Ṭihrán, _____ e _____ dhe _____ i _____ e linin _____ vetëm pak.Megjithëse flinte vetëm pak, prapëseprapë në ato _____ të rralla _____ ndjeu sikur _____ nga _____ mbi _____. Si rezultat çdo gjymtyrë e trupit të Tij _____ . Në ato momente, Bahá'u'lláh·u recitonte ato që asnjë njeri _____ të _____ .

Në një pasazh tjetër Ai përshkruan se si iu shfaq Atij Vasha, që simbolizon "Shpirtin e Madh":

"Ndërsa isha i zhytur në vuajtje, dëgjova zërin më të ëmbël, më të mahnitshëm, që thërriste mbi kokën Time. Kur ktheva fytyrën pashë një Vashë – mishërimin e kujtimit të emrit të Zotit Tim – që qëndronte pezull para Meje. Kaq e gëzuar ishte ajo në vetë shpirtin e saj, saqë fytyra i ndriste me stolinë e pëlqimit të Perëndisë, dhe faqet i flakëronin me shkëlqimin e Mëshirëplotit. Midis qiellit e tokës ajo lëshonte një thirrje që robëronte zemrat dhe mendjet e njerëzve. Ajo i kumtoi qenies Sime të brendshme e të jashtme lajme që e gëzuan shpirtin Tim dhe shpirtrat e shërbëtorëve të nderuar të Perëndisë. Duke treguar me gisht kokën Time, iu drejtua të gjithë atyre që janë në qiell dhe të gjithë atyre që janë mbi tokë, duke thënë: 'Për Perëndi! Ky është i Shumëdashuri i botëve, e megjithatë

nuk e kuptoni. Kjo është Bukuria e Perëndisë midis jush, dhe fuqia e sovranitetit të Tij brenda jush, sikur ta kuptonit. Ky është Misteri i Perëndisë, dhe Thesari i Tij, Kauza e Perëndisë dhe Lavdia e Tij për të gjithë ata që janë në mbretëritë e Revelacionit e të krijimit, në qofshi ndër ata që kuptojnë'".[32]

Bahá'u'lláh·u na tregon se ndërsa ishte i zhytur në vuajtje, dëgjoi _____ _____ , _____ , që thërriste mbi kokën e Tij.Kur ktheu fytyrën, Bahá'u'lláh·u pa një Vashë që qëndronte pezull _____ . Fytyra e saj _____ me _____ e pëlqimit _____ Dhefaqet _____ me _____ e Mëshirëplotit.Ajo i kumtoi _____ së Tij të _____ lajme qëgëzuan _____e Tij dhe shpirtrat e _____ të Perëndisë.Duke treguar me gisht kokën e Bahá'u'lláh·ut, iu drejtua të gjithë atyre që janë në _____ dhe të gjithë atyre që janë _____ , duke _____: "Për Perëndi! Ky është _____ , e megjithatë _____ . Kjoështë _____ midis jush dhe _____ të Tij brenda jush, sikur ta _____ . Ky është _____ _____ dhe _____ i Tij, _____ dhe _____ e Tij për të gjithë ata që janë në mbretëritë e _____ e të _____ , në qofshi ndër ata që kuptojnë".

PJESA 14

Kaq i rëndësishëm është koncepti i krizave e fitoreve saqë ia vlen të ndaleni në këtë pikë e të reflektoni për fuqinë e Kauzës, që kalon çdo pengesë në shtegun e vet. Për t'ju ndihmuar në këtë punë, ju sugjerohet të lexoni citatet e mëposhtme – një nga Shkrimet e Bahá'u'lláh·ut dhe një tjetër nga një letër e shkruar në emër të Shoghi Effendi·ut – e të bëni ushtrimet që vijojnë.

"Shikoni sesi në këtë Dispensacion njerëzit pa vlerë e të marrët kanë imagjinuar me naivitet se me mjete të tilla si masakra, plaçkitje e syrgjynosje mund të fikin Llambën që ka ndezur Dora e fuqisë Hyjnore, ose të eklipsojnë Yllin e Ditës të shkëlqimit të përjetshëm. Ata duket se janë krejt të paditur për të vërtetën që pikërisht prapësi të tilla janë vaji që ushqen flakën e kësaj Llambe! E tillë është fuqia transformuese e Perëndisë. Ai ndryshon çdo gjë që dëshiron; Ai me të vërtetë ka pushtet mbi të gjitha gjërat ..."[33]

"Kjo Kauzë, si çdo Kauzë Hyjnore, nuk mund të rrënjoset efektivisht veç po qe se përballet e triumfon me guxim mbi forcat kundërshtare që e sulmojnë. Historia e Besimit është në vetvete një provë e mjaftueshme për këtë. Sprovat e përndjekjet kanë qenë gjithmonë, e do të vazhdojnë të jenë, fati i të zgjedhurve të Perëndisë. Por këto ata duhet t'i konsiderojnë si bekime të fshehura, sepse përmes këtyre

besimi i tyre do të zgjohet, pastrohet e forcohet. Bahá'u'lláh·u i krahason këto sprova të mundimshme me vajin që ushqen llambën e Kauzës së Perëndisë".[34]

Në çfarë mënyre fakti që e dini se Besimi shkon përpara përmes një vargu krizash efitoresh, ju ndihmon në vendosmërinë tuaj për të ecur në shtegun e shërbimit të Kauzës dhe të njerëzimit?

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

PJESA 15

Ndërsa Bahá'u'lláh·u qëndronte i lidhur me zinxhirë në Síyáh-Chál, armiqtë e Tij përpiqeshin që të sigurojnë nga Mbreti dënimin e Tij me vdekje. PorBahá'u'lláh·u gëzonte dashurinë si të njerëzve nga shtresat e ulëta dhe nga ato të larta, prandaj nuk mund të ekzekutohej aq kollaj. Duheshin prova se Ai kishte lidhje me atentatin kundër jetës së mbretit. Por sa më shumë përpiqeshin të gjenin prova, aq më tepër bëhej e qartë se Ai ishte krejt i pafajshëm. Duke mos qenë në gjendje të provonin fajësinë e Tij, këta armiq të paskrupull vendosën t'i helmonin ushqimin. Kaq i fortë ishte helmi, sa shenjat e tij u shfaqën që me kafshatat e para, kështu që Bahá'u'lláh·u nuk e hëngri pjesën tjetër të ushqimit që i kishin sjellë. Më në fund, autoritetet nuk kishin çfarë të bënin tjetër veçse ta nxirrnin nga burgu, por vetëm me kusht që të largohej nga vendi e të shkonte në mërgim.

Bahá'u'lláh·u kishte hequr katër muaj në burg. Tani ishte i sëmurë e i rraskapitur. Kushtet çnjerëzore të burgut, zinxhiri rreth 50 kilogramësh që mbante në qafë, dhe së fundmi helmi, e kishin lënë kaq të dobësuar saqë u vu në regjim shtrati nën kujdes të vazhdueshëm. Hallkat e zinxhirit kishin shkaktuar plagë të thella në qafën e Tij, e sado që me kohë u shëruan, shenjat i ngelën deri në fund të jetës. Në mes të gjithë këtyre telasheve, familja duhej të përgatitej për një udhëtim të stërmundimshëm brenda një muaji. Bahá'u'lláh·u ishte lënë i lirë të zgjidhte vendin e mërgimit. Ai zgjodhi Bagdatin, në atë kohë një qytet në Mbretërinë Otomane dhe sot kryeqytet i Irakut.

Udhëtimi zgjati nga 12 janari 1853 deri më 8 prill të po atij viti. Ishte mesi i dimrit dhe Bahá'u'lláh·u me familjen e Tij u shtrënguan të udhëtonin përmes pjesës perëndimore të Iranit, ku dimrat kanë një të ftohtë të hidhur. Ushqimet që kishin për rrugës nuk ishin të mjaftueshme, dhe duhet të kënaqeshin me pak. Por Mbrojtësi i këtij grupi të vogël udhëtarësh ishte Vetë Perëndia Fuqiplotë, dhe falëndihmës së Tij të pashtershme, ata arritën shëndoshë e mirë në Baghdád.

Irani e kishte privuar veten nga dhurata e pranisë së Bahá'u'lláh·ut dhe e kishte detyruar Atë të largohej, për të mos u kthyer kurrë më në vendlindje. Iraku do të ishte tani shtëpia e Qenies më të vyer të planetit. Një historian i shquar Bahá'í ka thënë këto fjalë për mërgimin e Bahá'u'lláh·ut nga Irani:

"Ndërsa Bahá'u'lláh·u i afrohej kufirit, po mbyllej një periudhë. A ishin njerëzit në Iran të vetëdijshëm për humbjen që po pësonin? Të kredhur në padituri të thellë, të zhytur në fanatizëm, të verbuar nga paragjykimet, të shtyrë nga njerëz egoistë, të mashtruar me gënjeshtra, ata nuk ishin në gjendje të shihnin e të kuptonin. Kështu, Shpëtimtari i botës u largua nga mesi i tyre. Atë që dikur e donin dhe e respektonin të pasurit e të varfërit, të lartësuarit e të poshtëruarit, princat e fshatarët, e kishin braktisur po ata njerëz të cilëve Ai kurdoherë u kishte dhuruar pa kursim dashamirësi, dashuri, drejtësi e bamirësi. Irani humbi praninë e Bahá'u'lláh·ut, por a mund të mungonte shpirti i Tij në atë vend apo në ndonjë vend tjetër?"[35]

1. Pse armiqtë e Bahá'u'lláh·ut nuk siguronin dot një dënim me vdekje për Të? _____
_____
_____
_____

2. Armiqtë e Bahá'u'lláh·ut nuk patën sukses në komplotet e tyre për ta lidhur Atë me atentatin kundër Mbretit. Çfarë bënë atëherë ata? _____
_____
_____

3. Sa muaj ndodhej Bahá'u'lláh·u në Síyáh-Chál? _____

4. Me çfarë kushte e liruan Atë? _____
_____

5. Çfarë qyteti zgjodhi Bahá'u'lláh·u si vend të mërgimit të Tij? _____

6. Baghdád·i ishte atëherë një qytet në _____
kurse sot është kryeqyteti i _____ .

7. Bahá'u'lláh·u dhe familja e Tij e nisën udhëtimin e tyre për në Baghdád më _____ dhe e mbaruan afërsisht tre muaj më vonë, më _____ .

8. Përshkruani kushtet e udhëtimit:

_____
_____
_____

PJESA 17

Lutja e mëposhtme e reveluar nga Bahá'u'lláh·u do t'ju ndihmojë të kapni një shkëndijë nga vuajtjet që përjetoi Ai në Síyáh-Chál dhe mundimet që hoqi në muajt që pasuan:

> **"Perëndia Im, Mjeshtri Im, Dëshira Ime! … Ti ke krijuar këtë grimcë pluhuri me fuqinë e përkryer të pushtetit Tënd, dhe e ke ushqyer me duart e Tua që askush nuk mund t'i lidhë… Këtë fyt që Ti e kishe mësuar me çikjen e mëndafshit, tani së fundi e ke mbërthyer me zinxhirë të rëndë, dhe këtë trup që Ti e kishe mësuar të prehej në qëndisma e kadife tani në fund ia ke nënshtruar poshtërimit të një burgu të nëndheshëm. Urdhri Yt më ka prangosur me vargonj të panumërt dhe më ka hedhur mbi qafë zinxhirë që askush nuk mund t'i këpusë. Kanë kaluar një numër vitesh gjatë të cilave vuajtjet kanë vërshuar mbi Mua si reshje të mëshirës... Sa e sa net kanë kaluar, gjatë të cilave pesha e zinxhirëve nuk Më linte të prehesha, dhe sa e sa ditë gjatë të cilave pushimi e qetësia Më janë mohuar për shkak të gjërave me të cilat Më kanë goditur duart dhe gjuhët e njerëzve! Edhe bukën e ujin që Ti, falë mëshirës Sate që s'njeh kufi, ua ke dhënë deri kafshëve të fushës, ata për një kohë ia ndaluan këtij shërbëtori, dhe gjërat që ata nuk ua kanë bërë atyre që janë larguar prej Kauzës Sate, i kanë ushtruar mbi Mua, derisa, më në fund, vendimi Yt mori formë të prerë dhe urdhri Yt i kërkoi këtij shërbëtori të ikë nga Persia, i shoqëruar nga një numër njerëzish trupvrarë e fëmijësh në moshë të njomë, në këtë stinë kur të ftohtit është aq i acartë sa njeriu s'është në gjendje as të flasë, dhe akulli e bora janë aq me tepri sa është e pamundur të lëvizësh".[36]**

Ju mund të doni ta mësoni përmendësh lutjen e mësipërme. Por edhe sikur vetëm ta lexoni disa herë, një numër thëniesh lidhur me vuajtjet e Bahá'u'lláh·ut do t'ju nguliten në mendje. Cilat janë disa nga këto thënie?

PJESA 17

Në Baghdád, Bahá'u'lláh·u mori një shtëpi me qira në lagjen e vjetër të qytetit. Në muajt që pasuan mbërritjen e Tij atje, një numër gjithnjë e më i madh Bábí·sh morën rrugën e Baghdád·it. Për fat të keq, shumë prej tyre ishin katandisur në një gjendje për të ardhur keq; ata ishin ngatërruar e hutuar, dhe disa po kryenin veprime të padenja për një pasues të Báb·it. Bahá'u'lláh·u i priti të gjithë ata që erdhën me dashuri të pakufi dhe i ndihmoi të spastronin zemrat e të ripërtërinin shpirtrat. Nën ndikimin e Tij, fatet e komunitetit Bábí filluan të ndryshonin dhe lulëzoi përsëri shpresa. Por fatkeqësisht, një krizë e re po vinte. Këtë herë, burimi i saj ishte brenda vetë komunitetit; shkaku i fatkeqësisë ishte vetë gjysëm vëllai i Bahá'u'lláh·ut, Mírzá Yaḥyá, i cili pretendonte të ishte pasardhësi i Báb·it.

Në të vërtetë, Báb·i nuk e kishte parë të nevojshme të emëronte ndonjë pasardhës, sepse e dinte që i Premtuari i të Gjitha Kohëve do të shfaqej së shpejti. Sipas këshillës së Bahá'u'lláh·ut e të një dishepulli tjetër, Ai kishte emëruar MírzáYaḥyá·n si figurë drejtuese formale. Kjo do t'i jepte mundësi Bahá'u'lláh·ut të përkrahte Kauzën në siguri relative. Bahá'u'lláh e kishte trajtuar e mbështetur me shumë dashuri MírzáYaḥyá·n gjatë gjithë jetës së tij, por ky ishte edhe ambicioz edhe frikacak. Martirizimi i Báb·it e kishte tronditur deri në atë shkallë saqë pothuajse kishte humbur besimin. Ai ishte sorollatur për njëfarë kohe si dervish në malet e Mázindarán·it, duke u sjellë në mënyrë aq të turpshme saqë i kishte bërë disa besimtarë të atij rajoni ta braktisnin Kauzën. Duke u maskuar herë kështu e herë ashtu, kishte mbërritur më në fund në Baghdád, dhe pasi kishte marrë ca para nga Bahá'u'lláh·u për t'u marrë me tregti, jetonte nën një emër të rremë në një nga rrethinat e qytetit.

Respekti e dashuria gjithnjë e më e madhe që tregonin ndaj Bahá'u'lláh·ut pasuesit e Báb·it, si dhe prestigji i Tij gjithnjë e më i lartë midis zyrtarëve të qytetit, patën një efekt të tmerrshëm mbi MírzáYaḥyá·n. Atij i hipi xhelozia dhe zjarri i saj i digjte përbrenda aq shumë saqë i bëri shkrumb çdo gjurmë mirësjelljeje. Bashkë me një ortak edhe më të paturpshëm se vetja, MírzáYaḥyá·i nisi të mbjellë farat e dyshimit midis Bábí·ve lidhur me qëllimet e Bahá'u'lláh·ut. Edhe një herë retë e dyshimit, të frikës e të imagjinatave të kota u mblodhën mbi komunitetin Bábí. Periudha e shkurtër e qetësisë kishte marrë fund dhe, nga dita në ditë, vuajtjet e Bahá'u'lláh·ut shtoheshin.

Në mëngjesin e 10 Prillit 1854, familja e Bahá'u'lláh·ut u zgjua dhe zbuloi se Ai kishte ikur. Kishte lënë qytetin pa i thënë njeriu qëllimin e destinacionin e udhëtimit. Duke parë se ku po çonin veprimet e MírzáYaḥyá·it, Bahá'u'lláh·u kishte zgjedhur të tërhiqej në malet e Kurdistanit, në verilindje të Baghdád·it. **"**I vetmi qëllim i tërheqjes Sonë në vetmi",ka thënë Ai Vetë më vonë, "ishte të shmangnim që të bëheshim arsye përçarjeje midis besimtarëve, burim shqetësimi për shokët Tanë, mjet dëmtimi për ndonjë shpirt ose shkak brenge për ndonjë zemër".[35]

Në atë vend të shkretë, disi larg qytetit të Sulaymáníyyih·së, Bahá'u'lláh·u jetoi vetëm në komunikim me Perëndinë. Kënaqej me pak ushqim. Nganjëherë i sillnin pak qumësht barinjtë e zonës përreth, dhe me raste vizitonte qytetin për të siguruar nevojat minimale për jetesën. Megjithatë, edhe përmes këtyre kontakteve të shkurtra me njerëzit e zonës, madhështia e

Bahá'u'lláh·ut nuk mund të mbahej e fshehur nga sytë e tyre. Dashuria dhe urtia e Tij i tërhoqën banorët e Sulaymániyyih·së dhe nami i Tij filloi të përhapej në zonat përreth. Lajmet për një njeri me urti dhe elokuencë të jashtëzakonshme që jetonte në atë rajon të Kurdistanit arritën në Baghdád. Familja e Tij, duke e kuptuar se ky Personazh nuk mund të ishte askush tjetër veç Bahá'u'lláh·ut, dërguan një besimtar të besuar që t'i lutej Atij të kthehet. Bahá'u'lláh·u e pranoi kërkesën e tyre, duke i dhënë fund kështu veçimit vullnetar dyvjeçar të Tij.

1. Në çfarë gjendje ishin Bábí·të që merrnin rrugën e Baghdád·it pas mbërritjes së Bahá'u'lláh·ut në atë qytet? _____

_____

2. Përse ata ishin katandisur në një gjendje të tillë _____

_____

_____

3. Çfarë filloi të ndodhte në komunitetin Bábí nën ndikimin e Bahá'u'lláh·ut? _____

_____

_____

_____

4. A kishte emëruar Báb·i ndonjë pasardhës? Pse jo? _____

_____

_____

5. Cilin kishte emëruar Báb·i si figurë drejtuese formale? _____

6. Çfarëlidhje familjare kishte MírzáYaḥyá·i me Bahá'u'lláh·un? _____

7. Përshkruani karakterin e MírzáYaḥyá·it: _____

_____

_____

8. Çfarë kishte bërë MírzáYaḥyá·i pas martirizimit të Báb·it? _____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

9. Çfarëefekt pati ndikimi gjithnjë e më i madh i Bahá'u'lláh·ut në komunitetin Bábí, si edhe prestigji i Tij në rritje tek qeveritarët e qytetit, mbi MírzáYaḥyá·n? _____

_____

10. Çfarë bëri Bahá'u'lláh·u kur pa se ku çonin veprimet e MírzáYaḥyá·it? _____

_____

_____

11. Në çfarë rajoni u tërhoq Bahá'u'lláh·u? _____

12. Bahá'u'lláh·u na thotë se i vetmi qëllim i tërheqjes së Tij në vetmi ishte të shmangte që të bëhej arsye _____ , burim _____ , mjet _____ ose shkak _____ _____ .

13. Çfarëbënte Bahá'u'lláh·u në vendin e shkretë të Kurdistanit? _____

_____

_____

_____

14. Sa kohë zgjati tërheqja e Bahá'u'lláh·ut nga Baghdád·i? _____

15. Cilat ishin rrethanat që çuan në kthimin e Tij? _____

_____

_____

PJESA 18

Çdo Manifestim i Perëndisë bën një Besëlidhje me pasuesit e Tij. Pasuesit e Báb·it kishin hyrë në një Besëlidhje me Të për të kërkuar e pranuar Atë që Perëndia do Ta Shfaqë dhe për të jetuar në bindje ndaj urdhrave të Tij. Megjithëse Bahá'u'lláh·u ende nuk u kishte thënë të tjerëve se Ai ishte i premtuari nga Báb·i, madhështia e Tij po bëhej gjithnjë e më e dukshme çdo ditë që kalonte, madje një numër i vogël njerëzish kishin filluar ta njihnin pozitën e Tij. MírzáYaḥyá·i nuk ishte i verbër që të mos e shihte madhështinë e lavdinë e Bahá'u'lláh·ut. Por atë e kishte pushtuar xhelozia e ambicia, që e nxitën të merrej me prapësira që më në fund e bënë të shkelë hapur Besëlidhjen e Báb·it. Duke iu referuar trazirave e fatkeqësive që i pritnin, Bahá'u'lláh·u i paralajmëronte miqtë:

"Ditët e sprovave kanë ardhur. Oqeane mosmarrëveshjesh e mundimesh po fryhen, dhe Flamurët e Dyshimit në çdo qoshe e kthesë po nxitin prapësira e po i çojnë njerëzit drejt humbjes.… Mos e lini zërin e disa prej ushtarëve të mohimit të mbjellë dyshime midis jush, as mos i lejoni vetes të mos i vini veshin Atij Që është e Vërteta, përderisa në çdo Dispensacion ka patur përplasje të tilla. Perëndia, sidoqoftë, do të vendosë Besimin e Tij dhe do të shfaqë dritën e Tij, ndonëse nxitësit e rebelimit e urrejnë atë... Tregoni kujdes çdo ditë për Kauzën e Perëndisë... Të gjithë janë robër në dorën e Tij. Nuk ka vend për askënd që të dalë prej andej. Mos mendoni se Kauza e Perëndisë është diçka që mund të merret lehtë, ku secili të plotësojë tekat e veta. Në vise të ndryshme një numër shpirtrash kanë dalë sot me këtë pretendim. Po afrohet koha kur… çdonjëri prej tyre do të marrë fund e do të humbasë, madje do të shndrrohet në hiç e do të bëhet diçka që s'e mban mend askush, si vetë pluhuri".[38]

1. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

   a. Bahá'u'lláh·u u tha miqve të mos i lënë _____ e disa prej _____ të _____ të mbjellin _____ .

   b. Ai i paralajmëroi ata të mos i lejojnë vetes _____ Atij _____ .

   c. Ai i siguroi miqtë se Perëndia do të vendosë _____ dhe do tëshfaqë _____ , ndonëse armiqtë e Kauzës e hedhin poshtë atë.

   d. Miqtë nuk duhet të mendojnë se Kauza e Perëndisë është diçka _____ _____ , kusecili _____ e veta.

   e. Do të vijë koha kur të gjithë ata që janë kthyer kundër Besimit do të _____ _____ dhe do të _____ . Ashtu si vetë pluhuri, ata do të bëhen diçka që _____ .

2. Bahá'u'lláh·u u referohet atyre, të cilët kërkojnë të hedhin dyshime si "ushtarëtë mohimit". Çfarë mohojnë ata? _____
_____
_____

PJESA 19

Gjatë mungesës dy-vjeçare të Bahá'u'lláh·ut, fatet e Besimit kishin arritur pikën më të ulët në historinë e tij. Siç pritej, MírzáYaḥyá·i e kishte treguar se ishte i paaftë të udhëhiqte

qoftë edhe komunitetin e vogël në Baghdád. Në disa pjesë të tij, një numër Bábí·sh merreshin me punëra që përbënin një turp për Kauzën e çmuar të Báb·it. Kështu, përsëri Bahá'u'lláh·u mori përsipër detyrën e rigjallërimit të komunitetit. Ardhja e Tij në mars 1856 iu njoftua të gjithë besimtarëve dhe dera e Tij ishte e hapur për të gjithë ata që digjeshin për të vërtetën. Banesa e thjeshtë ku Ai jetonte me gjithë familjen e bë qendra ku mblidheshin kërkues, vizitorë e pelegrinë. Gjithsecili që vinte në praninë e Tij transformohej nga fuqia e fjalëve të Tij të ëmbla e të përzemërta. Ata që kishin fatin të jetonin aty pranë e ndienin veten si në parajsë. Ata u bënë krijesa të reja, krejtësisht të shkëputura nga gjërat e kësaj bote. Ja sesi e përshkruan Nabíl·i, historiani i madh i fillimeve të Epokës Bahá'í, gjendjen e këtyre shpirtrave:

"Shumë net, jo më pak se dhjetë veta jetonin me jo më shumë se një qindarkë hurma. Askush nuk e dinte se të kujt ishin këpucët, palltot, e xhybet që gjendeshin në shtëpitë e tyre. Kushdo që shkonte në pazar, mund të mendonte se këpucët që kishte veshur ishin të vetat, dhe kush hynte në praninë e Bahá'u'lláh·ut mund të mendonte se palltoja e xhybja që mbante ishin të tijat. Edhe emrat i kishin harruar, zemrat i kishin zbrazur nga gjithçka tjetër veç adhurimit për të Shumëdashurin… Ah, gëzimi i atyre ditëve, dhe kënaqësia e magjepsja e atyre orëve!"[39]

Bahá'u'lláh·u ndenji në Baghdád edhe shtatë vjet të tjera pas kthimit nga Sulejmani·ja. Gjatë kësaj kohe, vazhdoi ta mbante të fshehtë Pozitën e Tij si Manifestimi i Perëndisë për Ditën e sotme. Por dashuria Hyjnore vërshonte prej Tij në një shkallë të tillë sa zemrat e ndieshme nuk mund të mos prekeshin prej saj. Udhëheqja Hyjnore që Ai reveloi në biseda dhe në vargjet e tabelat e shkruara e transformuan karakterin e Bábí·ve, që prej shumë vjetësh kishin mbetur pa bari. Këto janë vitet gjatë të cilave Ai reveloi Librin e Sigurisë, ku shpjegon natyrën e Revelacionit të Perëndisë me terma kaq të qartë saqë shkatërroi themelet e dogmave të krijuara nga njerëzit në të kaluarën. Gjatë së njëjtës periudhë Bahá'u'lláh·u, duke shëtitur brigjeve të lumit Tigër i zhytur në meditim, reveloi Fjalët e Fshehta, që ne i kemi aq shumë për zemër të gjithë dhe që na shërbejnë si udhëheqje në rritjen tonë shpirtërore. Shpejtësia me të cilën këto vargje rridhnin nga Pena e Tij ishte e habitshme. Ja se si Vetë Bahá'u'lláh·u i referohet asaj periudhe fuqie krijuese të jashtëzakonshme:

> **"… Revelonim si shi i rrëmbyer, me ndihmën e Perëndisë e falë Hirit e mëshirës Hyjnore të Tij, vargjet Tona, dhe i dërgonim në pjesë të ndryshme të botës. I porositnim të gjithë njerëzit, e veçanërisht këtë popull, me anë të këshillave Tona të urta e qortimeve dashamirëse, dhe ua ndaluam të përzihen në rebelime, grindje, polemika e konflikte. Si rezultat i kësaj, e me Hirin e Perëndisë, kryeneçësia e marrëzia u shndërruan në përdëllim e mirëkuptim, dhe armët u kthyen në mjete paqeje".[40]**

Shtatë vitet e jetës së Bahá'u'lláh·ut në Baghdád përfaqësojnë një periudhë fitoresh të madhërishme. Duhej pritur pra që, shpejt a vonë, do të vinte një krizë, e cila nga ana e saj do të kthehej në një fitore edhe më të madhe. Prestigji gjithnjë në rritje i Bahá'u'lláh·ut nuk kaloi pa rënë në sy të armiqve të Besimit. Më aktivi midis tyre ishte njëfarë Sheiku, i cili përdori çdo mjet që kishte në dorë për t'i bindur zyrtarët si të qeverisë persiane e të asaj otomane, si dhe klerin, të ngriheshin për t'iu kundërvënë Atij.

Por për vite me radhë, përpjekjet e Sheikut shkuan dëm për shkak të urtisë së Bahá'u'lláh·ut e të fisnikërisë së fjalëve e të veprave të Tij.Një herë, për shembull, ky Sheik mblodhi bashkë disa nga klerikët më të shquar të rajonit, me qëllim që t'i bindte të dënonin njëzëri Bahá'u'lláh·un. Të gjithë ishin gati të shpërthenin një sulm kundër grupit të vogël të të syrgjynosurve në Baghdád, për ta goditur Besimin në vetë zemrën e tij. Për habinë e tyre, më i

shquari ndër ta, një njeri i njohur për drejtësinë e devotshmërinë e tij, refuzoi të jepte këtë dënim për Bábí·të. Ai u tha atyre që ishin mbledhur aty se, me sa dinte ai, komuniteti Bábí nuk kishte bërë asgjë që ta justifikonte këtë veprim, dhe u ngrit e u largua nga mbledhja.

Meqenëse plani fillestar dështoi, grupi vendosi të dërgonte te Bahá'u'lláh·u një njeri të ditur dhe t'i drejtonte Atij disa pyetje për të provuar dijet e Tij. Pasi Bahá'u'lláh·u iu përgjigj të gjitha pyetjeve, i dërguari pranoi, në emër të grupit të klerikëve, gjerësinë e dijeve të Tij. Por pastaj tha se për të kënaqur të gjithë të interesuarit për të vërtetën e Misionit të Tij, Ai duhet të bënte një mrekulli për ta. "Edhe pse ju nuk keni të drejtë të kërkoni një gjë të tillë", u përgjigj Bahá'u'lláh·u, "sepse është Perëndia që vë në provë shërbëtorët e Tij dhe ata nuk duhet të venë në provë Perëndinë, Unë prapëseprapë do ta lejoj e do ta pranoj këtë kërkesë".[41] Ai megjithatë i tha të dërguarit, se klerikët duhet të zgjidhnin më parë mrekullinë që donin, dhe të shkruanin se pas kryerjes së mrekullisë nuk do të kishin më asnjë dyshim për Të, se do ta njihnin Atë e do të pranonin Vërtetësinë e Kauzës së Tij. Duhej ta vulosnin këtë dokument e t'ia sillnin Atij.

Kjo përgjigje e qartë e sfiduese e preku thellë të dërguarin. Ai menjëherë u ngrit, i puthi gjurin Bahá'u'lláh·ut dhe iku. Ua dorëzoi mesazhin e Bahá'u'lláh·ut grupit të klerikëve. Ata debatuan rreth tij tre ditë, por nuk morën dot ndonjë vendim. Më në fund s'u mbeti tjetër veçse ta linin mënjanë atë çështje.

Por këta armiq të paskrupull të Besimit nuk hoqën dorë nga intrigat e tyre kundër Bahá'u'lláh·ut. Ata vazhduan të thurnin dinakëri e t'ua paraqitnin në mënyrë të shtrembër autoriteteve qëllimet e Bahá'u'lláh·ut, derisa më në fund, në pranverë të vitit 1863, përpjekjet e tyre dhanë fryt dhe një krizë e re u shfaq.

1. Në çfarë gjendje ishte komuniteti Bábí kur Bahá'u'lláh·u u kthye në Baghdád? ____

_____

_____

2. A e kishte treguar veten të aftë MírzáYaḥyá·i për të drejtuar komunitetin? _____

3. Çfarëefekt pati mbi Bábí·të kthimi i Bahá'u'lláh·ut? _____

_____

_____

_____

_____

4. Shprehni me fjalët tuaja përshkrimin e Nabíl·it për gjendjen e atyre që jetonin pranë Bahá'u'lláh·ut:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

5. Sa vjet qëndroi Bahá'u'lláh·u në Baghdád pas kthimit nga Sulejmani·ja? _____

_____

6. Përmendni dy nga veprat e Bahá'u'lláh·ut të reveluara gjatë atyre shtatë viteve në Baghdád: _____

_____

7. Cila është tema kryesore e Librit të Sigurisë? _____

_____

8. 8.Çfarë çështjesh trajtojnë Fjalët e Fshehura? _____

_____

_____

9. Plotësoni fjalitë e mëposhtme:

a. Bahá'u'lláh·u na thotë se me _____ e falëHirit e _____ së Tij Hyjnore, Ai _____ vargjet e Tij si _____ .

b. Ai i dërgonte këto vargje _____ _____ .

c. Në këto vargje Ai _____ të gjithë njerëzit me anë të _____ të Tij _____ e _____ .

d. Ai ua ndaloi atyre të _____ në _____, _____ , _____ , e _____ .

e. Si rezultat i kësaj, e me Hirin e Perëndisë, _____ e _____ u shndërruan në _____ e _____ , dhe _____ u kthyen në _____ _____ .

10. Çfarëefekt pati prestigji në rritje i Bahá'u'lláh·ut tek armiqtë e Besimit? _____

_____

_____

11. Çfarëdo të thotë shprehja "dënim njëzëri"? _____

_____

_____

12. Tregoni me fjalët tuaja historinë e grupit të klerikëve dhe të të dërguarit që ata çuan te Bahá'u'lláh·u në Baghdád:

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

PJESA 20

Gjatë studimeve tuaja për Besimin, do të lexoni Librin e Sigurisë dhe do të përsiatni rreth kuptimit të thellë të temave të tij të shumta. Ju, sigurisht, jeni njohur tashmë me Fjalët e Fshehura. Ky vëllim do të jetëshok i përhershëm për ju gjatë gjithë jetës, dhe udhërrëfimi hyjnor që përmbahet aty do të ketë një ndikim të madh në zhvillimin tuaj shpirtëror. Në këtë pikë, ndërsa reflektoni për jetën e Bahá'u'lláh·ut në Baghdád, gjatë së cilës u reveluan këto dy

vëllime, mund të doni të mësoni përmendësh pasazhet e hapjes të secilit prej tyre. Libri i Sigurisë fillon kështu:

> **"Askush nuk do t'i arrijë brigjet e oqeanit të të kuptuarit të vërtetë, veç atij që shkëputet nga gjithçka që është në qiell e mbi tokë. Dëlirini shpirtrat tuaj, o ju popuj të botës, që të mund të arrini atë rang që Perëndia ka caktuar për ju dhe të hyni kështu në faltoren që, sipas porosive të Providencës, është ngritur në qiellin e Bayán·it".[42]**

Dhe pasazhi i hapjes së Fjalëve të Fshehta thotë:

> **"Kjo është ajo që ka zbritur prej mbretërisë së lavdisë, e folur nga gjuha e fuqisë dhe e pushtetit, dhe që u është reveluar Profetëve të së shkuarës. Prej saj Ne kemi marrë thelbin e brendshëm dhe e kemi veshur me rrobën e shkurtësisë, si shenjë hiri ndaj të drejtëve, që ata t'i qëndrojnë besnikë Besëlidhjes së Perëndisë, t'i përgjigjen plotësisht besimit të Tij në jetën e tyre dhe të fitojnë në mbretërinë e shpirtit margaritarin e virtytit Hyjnor".[43]**

PJESA 21

Aty nga fundi i qëndrimit të Tij në Baghdád, Bahá'u'lláh·u filloi t'u referohej herë pas here sprovave e vështirësive që i pritnin. Një ëndërr që u tregoi një herë miqve shkaktoi ankth të madh tek ata. "Pashë", shkruan Ai në një Tabelë, "Profetët dhe Lajmëtarët të mblidhen e të ulen rreth Meje, duke rënkuar, qarë e vajtuar me të madhe. I habitur u kërkova arsyen; pas kësaj rënkimet e vaji i tyre u shtuan më tej dhe më thanë: 'Ne qajmë për Ty, O Misteri Më i Madh, O Faltore e Pavdekësisë!' Qanin me aq ngashërim sa fillova të qaja edhe Unë bashkë me ta. Në këtë kohë, Tubimi i epërm m'u drejtua Mua duke thënë: '… Së shpejti Ti do të shohësh me sytë e Tu atë që asnjë Profet nuk e ka parë… Bëj durim, bëj durim.' … Ata vazhduan të më flasin tërë natën deri afër agimit".[42]

Në fillim të vitit 1863, gjatë dymbëdhjetë ditëve të festivalit të Naw-Rúz·it (vitit të ri Persian), Bahá'u'lláh reveloi Tabelën e Detarit të Shenjtë, e cila, me gjuhë mistike, para-lajmëronte ngjarjet e ardhme dhe bënte fjalë për tradhti e ndarje. Kjo Tabelë iu lexua miqve të mbledhur në praninë e Tij më 26 Mars. Oqeane hidhërimi vërshuan në zemrat e tyre kur e kuptuan se po ua merrnin Atë. Po atë ditë, një lajmës i solli Bahá'u'lláh·ut një njoftim se Atij i kërkohej një takim me Guvernatorin e Baghdád·it. Të nesërmen, Bahá'u'lláh·ut iu paraqit një letër e kryeministrit të Perandorisë Otomane drejtuar Guvernatorit, e formuluar me shumë mirësjellje, që e ftonte Bahá'u'lláh·un të udhëtonte për në kryeqytetin otoman, Kostandinopojë. Një shpurë kalorësish do ta shoqëronte për Ta mbrojtur. Bahá'u'lláh·u e pranoi menjëherë kërkesën, por refuzoi të pranonte paratë e ofruara nga qeveria për udhëtimin. Përfaqësuesi i guvernatorit nguli këmbë që Ai t'i pranonte paratë, duke thënë se autoritetet do të fyheshin po të mos e bënte këtë. Më në fund, Ai e mori shumën bujare dhe ua shpërndau menjëherë të varfërve të qytetit.

Lajmi i mërgimit të afërt të Bahá'u'lláh·ut nga Baghdád·i e tronditi komunitetin Bábí. Miqtë i pushtoi hidhërimi, dhe në fillim askush nuk ishte në gjendje të flinte as të hante. Por pak nga pak u qetësuan nga fjalët e ngrohta e të dashura të Bahá'u'lláh·ut dhe u pajtuan me faktin që pjesa më e madhe e tyre nuk do kishin fatin ta shoqëronin Atë në etapën tjetër të

mërgimit të Tij. Si shenjë të dashurisë së Tij, Ai shkroi me dorën e Vet nga një Tabelë për secilin prej miqve që jetonin në qytet – burrë, grua apo fëmijë.

Në afërsi të Baghdád·it ishte një kopsht shumë i bukur plot me trëndafila, dhe trëndafilat ishin lulja e preferuar e Bahá'u'lláh·ut. Tridhjetë e një ditë pas Naw-Rúz·it, Ai la qytetin dhe hyri në atë kopsht. Besimtarët, dhe në të vërtetë një numër i madh banorësh të Baghdád·it ishin shumë të mërzitur. Komuniteti Bábí, krejt i ringjallur nga përkujdesja e ngrohtë e Bahá'u'lláh·ut, kishte hyrë tashmë në një krizë të re. Cili do të ishte fati i këtij Besimi të ri, Shpresa e vetme e të cilit po syrgjynosej në një vend aq larg pasuesve të tij? Përgjigja që i priste ata Bábí zemërthyer që u mblodhën për t'i dhënë Atij lamtumirën qe diçka e mahnitshme. Bahá'u'lláh·u do të griste perdet që fshihnin Rangun e Tij të vërtetë nga sytë e njerëzve dhe do të shpallte hapur se Ai ishte i Premtuari i të gjitha kohëve.

Bahá'u'lláh·u qëndroi në kopshtin, që sot njihet si Kopshti i Riḍvánit, për 12 ditë para se të nisej për në Kostandinopojë. Armiqtë e Tij ishin përpjekur t'i jepnin një goditje fatale Kauzës së Tij, duke e ndarë Atë nga shumica e besimtarëve të Vet. Por Perëndia e ktheu lamtumirën në një rast gëzimi të pamatë. Shpallja e Misionit të Tij u dha jetë të re shpirtrave të shokëve të Tij. Kjo ishte Dita e Ditëve për të cilën i kishte përgatitur Báb·i. Vetë Bahá'u'lláh·u ka thënë se në atë Ditë: **"të gjitha gjërat e krijuara u zhytën në detin e dëlirjes".**[45]

Për fat të keq, dihet shumë pak për hollësitë e bisedave që Bahá'u'lláh·u zhvilloi me vargun e vizitorëve që priti në Kopshtin e Riḍvánit. Fjalët e mëposhtme të historianit Nabíl s'na japin veçse një vezullim fare të shkurtër të lavdisë së atyre ditëve:

"Çdo ditë, që para agimit, kopshtarët këpusnin trëndafilat e mbjellë përgjatë katër rrugicave të kopshtit dhe i grumbullonin në qendër të tendës së Tij të bekuar. Kaq i madh ishte pirgu i tyre sa kur shokët e Tij mblidheshin për të pirë çajin e mëngjesit në praninë e Tij, nuk e shihnin dot njëri-tjetrin përballë. Të gjithë këta trëndafila, Bahá'u'lláh·u me dorën e Tij ua besonte atyre që i niste nga prania e Vet çdo mëngjes për t'ua dorëzuar nga ana e Tij miqve arabë e persianë në qytet… Një natë, natën e nëntë të hënës në rritje, ndodhi që unë të isha ndër ata që ruanin jashtë tendës së Tij të bekuar. Ndërsa po afrohej mesnata, e pashë Atë që doli nga tenda, kaloi pranë vendeve ku po flinin disa nga shokët e Tij, dhe filloi të shëtiste lart e poshtë nëpër rrugicat e kopshtit të rrethuara nga lulet e të ndriçuara nga hëna. Kaq e fortë ishte kënga e bilbilave nga çdo anë, saqë vetëm ata që ishin pranë Tij mund të dëgjonin dallueshëm zërin e Tij. Vazhdoi të ecte derisa, duke u ndalur në mes të njërës prej rrugicave, tha: 'Shihini këta bilbila. Kaq e madhe është dashuria e tyre për këta trëndafila, saqë pa fjetur nga muzgu deri në agim, këndojnë meloditë e tyre dhe komunikojnë me pasion të zjarrtë me objektin e adhurimit të tyre. Atëherë, si mund t'i zerë gjumi ata që thonë se digjen nga zjarri i bukurisë së trëndafiltë të të Shumëdashurit?' Për tri net me radhë, ruajta dhe i rashë rreth e qark tendës së Tij të bekuar. Sa herë që kaloja pranë shtratit ku shtrihej, e gjeja zgjuar, dhe çdo ditë, nga mëngjesi deri kur errej, e shihja vazhdimisht duke biseduar me vargun e vizitorëve që vinin papushim nga Baghdád·i. As edhe një herë nuk munda të gjeja në fjalët që thoshte qoftë edhe një gjurmë shtirjeje".[46]

Në kohën e sotme, Festimet eRiḍvánit, festohen çdo vit rrotull botës për të kujtuar Deklarimin e Misionit të Bahá'u'lláh·ut. Duke zgjatur dymbëdhjetë ditë, janë festimet më të shenjta e më domethënëse nga të gjitha festat Bahá'í.

1. Tregoni me fjalët tuaja ëndrrën e Bahá'u'lláh·ut nga fundi i qëndrimit të Tij në Baghdád.

_____
_____
_____
_____
_____
_____

2. Cila ishte domethënia e ëndrrës? _____
_____
_____

3. Kur e reveloi Bahá'u'lláh·u Tabelën e Detarit të Shenjtë? _____
_____

4. Çfarë paralajmëronte Tabela e Detarit të Shenjtë? _____
_____

5. Çfarë i solli Bahá'u'lláh·ut lajmësi i qeverisë atë ditë që Tabela iu lexua miqve? ___
_____

6. Çfarë iu paraqit Bahá'u'lláh·ut të nesërmen? _____
_____
_____

7. Ku kishte vendosur qeveria ta dërgonte Bahá'u'lláh·un? _____
_____

8. Çfarëbëri Bahá'u'lláh·u me shumën e parave që qeveria i ofroi për udhëtimin? ____
_____

9. Si reaguan miqtë kur dëgjuan lajmin e largimit së shpejti të Bahá'u'lláh·ut? _____
_____
_____

10. Çfarëbëri Bahá'u'lláh·u si shenjë të dashurisë së Tij për miqtë? _____

_____

_____

11. Me çfarë emër njihet tani kopshti ku Bahá'u'lláh·u shpalli Misionin e Tij? _____

_____

12. Sa ditë ndenji Ai në atë kopsht? _____

13. Duke iu referuar atyre ditëve të lavdishme të qëndrimit të Bahá'u'lláh·ut në Kopshtin e Riḍvánit, Nabíl·i na tregon:

a. "Çdo ditë, që para agimit, kopshtarët _____

_____

_____ dhe i _____

_____ .

b. Kaq i madh ishte pirgu i tyre sa kur shokët e Bahá'u'lláh·ut _____

_____ në praninë e Tij, nuk _____ .

c. Të gjithë këta trëndafila, Bahá'u'lláh·u me dorën e Tij, ua besonte atyre që i niste nga prania e Vet çdo mëngjes për t'ua dorëzuar nga ana e Tij _____

_____ .

d. Një natë, ndodhi që Nabíl·i të ishte ndër ata që _____

_____ .

e. Ndërsa po afrohej mesnata, Nabíl·i e pa Bahá'u'lláh·un që doli _____ , kaloipranë _____ , dhe filloi të _____

_____

_____ kopshtit.

f. Kaq e fortë ishte _____

_____ , saqë vetëm ata që ishin pranë Bahá'u'lláh·ut mund të _____

_____ .

g. Bahá'u'lláh·u vazhdoi të ecte derisa, _____

_____ . Ai tha: 'shihini këta _____.

Kaq e madheështë_____ e tyre për këta_____ , saqë

_____ nga _____ deri në _____, ata

_____ e tyre dhe _____

me _____

të tyre. Atëherë, si mund _____ ataqë _____ se

_____ nga _____ të

të _____ ?'

h. Për tre netë me radhë, Nabíl·i_____

_____ .

i. Sa herë që Nabíl·i kalonte pranë shtratit ku shtrihej Bahá'u'lláh·u, e _____

_____ , dhe çdo ditë, _____

_____ , e shihte _____

_____

_____ .

j. As edhe një herë Nabíl·i nuk mundi të gjente në fjalët që thoshte Bahá'u'lláh·u

_____ .

14. Çfarë kishin shpresuar të arrinin armiqtë e Besimit duke e ndarë Bahá'u'lláh·un nga shumica e besimtarëve, dhe përkundrazi çfarë deshi Perëndia?_____

_____

_____

_____

_____

15. Çfarë feste kremtojmë ne në kohën e sotme si përvjetor të Shpalljes së Misionit të Bahá'u'lláh·ut? _____

16. Sa zgjat Festa e Ridvánit dhe në çfarë data kremtohet? _____

_____

17. Tani që keni përfunduar studimin për syrgjynosjen e Bahá'u'lláh·ut nga Irani në Irak, përgatisni dhe bëni një bisedë të shkurtër për këtë periudhë të jetës së Tij.

PJESA 22

Më poshtë janë disa pasazhe të një Tabele të reveluar nga Bahá'u'lláh·u. Lexojini me zjarr me zë të lartë. Gjatë leximit, sillni ndërmend Deklarimin e Bahá'u'lláh·ut në Kopshtin e Riḍvánit dhe le t'ju mbushin zemrën me gëzim Fjalët e Tij.

"Pranvera Hyjnore ka ardhur, O Pena Më e Lavdëruar, sepse Festa e Mëshirëplotit po afrohet me shpejtësi. Çohu dhe lartëso para gjithë krijimit emrin e Perëndisë,

dhe thuri lavde Atij, në mënyrë që të gjitha gjërat e krijuara të rilindin e përtërihen. Fol e mos pusho. Ylli i ditës i lumturisë shkëlqen mbi horizontin e emrit Tonë, Fatlumit, sepse mbretëria e emrit të Perëndisë është stolisur me ornamentin e Zotit Tënd, Krijuesit të Qiejve. Çohu para kombeve të tokës dhe armatosu me fuqinë e Emrit Më të Madh, dhe mos ji ndër ata që vonojnë…

"A mundesh ti, O Penë, të zbulosh ndonjë tjetër veç Meje në këtë Ditë? Çfarë ka ndodhur me krijimin e me manifestimet e tij? Po me emrat e me mbretërinë e tyre? Ku kanë shkuar të gjitha gjërat e krijuara, të dukshme ose të padukshme? Çfarë ka ndodhur me sekretet e fshehura të Gjithësisë e me revelacionet e saj? Ja, gjithë krijimi është zhdukur! Asgjë s'ka mbetur veç Fytyrës Sime, të Përherëpranishmit, të Shndritshmit, Lavdiplotit.

"Kjo është Dita në të cilën asgjë nuk mund të shihet, veç vezullimeve të Dritës që shkëlqen në fytyrën e Zotit Tënd, të Hirshmit, Bujariplotit. Me të vërtetë, Ne kemi bërë që çdo shpirt të shuhet përmes sovranitetit Tonë të papërballueshëm e gjithënënshtrues. E pastaj kemi thirrur në jetë një krijim të ri, si shenjë të dashamirësisë Sonë për njerëzit. Unë jam, me të vërtetë, Bujariploti, i Lashti i Kohëve...

"Thuaj: Kjo është Parajsa, në gjethnajën e së cilës nektari i fjalës ka skalitur dëshminë: 'Ai që ishte i fshehur nga sytë e njerëzve është shfaqur, i veshur me sovranitet e fuqi!' Kjo është Parajsa, fëshfërima e gjetheve të së cilës shpall: 'O ju që banoni në qiej e mbi tokë! Është shfaqur ajo që kurrë më parë nuk qe shfaqur. Ai Që në përjetësi e kishte fshehur Fytyrën e Tij nga sytë e krijimit, tani ka ardhur'. Nga pëshpërima e flladit që fryn midis degëve vjen thirrja: 'Ai që është Zoti sovran i gjithçkaje u shfaq. Mbretëria është e Perëndisë', ndërsa nga ujërat që rrjedhin mund të dëgjohet murmurima: 'Të gjithë sytë janë gëzuar, sepse Ai Që askush s'e ka soditur, sekretin e të Cilit askush nuk e ka zbuluar, e ka ngritur perden e lavdisë dhe ka zbuluar pamjen e Bukurisë'.

"Brenda kësaj parajse dhe nga lartësitë e dhomave të saj më të zgjedhura, Shërbyeset e Qiellit kanë thirrur me zë të lartë: 'Gëzohuni, o banorë të mbretërive të epërme, sepse gishtat e Atij Që është i Lashti i Kohëve po i bien, në emër të Lavdiplotit, Këmbanës Më të Madhe mu në zemër të qiejve. Duart e bujarisë kanë çuar përqark gotën e jetës së pasosur. Afrohuni dhe pini pa kursim. Pini me ëndje të shëndetshme, O ju që jeni mishërimi vetë i mallit, ju që jeni vetë mishërimi i dëshirave të papërmbajtshme!'"[47]

PJESA 23

Bahá'u'lláh·u, familja e Tij, dhe grupi i vogël i besimtarëve që i shoqëronin qëndruan në Kostandinopojë vetëm katër muaj. Qeveria Persiane vazhdonte nga larg përndjekjen e Atij që tani e shihte në mënyrë të qartë si udhëheqësin e lëvizjes Bábí. Ambasadori i saj në oborrin e Sulltanit, sundimtarit të Perandorisë Otomane, ndërmori një fushatë sistematike kundër Bahá'u'lláh·ut. Mjedisi në të cilin jetonin sulltani, ministrat e tij dhe oborrtarët e tjerë, ishte një mjedis tradhtish, intrigash e hipokrizie. Bahá'u'lláh·u refuzoi të kishte të bënte me anëtarët e oborrit dhe me qëllimet e tyre të pavlera. Ky veçim ia bëri edhe më të lehtë ambasadorit persian

t'ua mbushte mendjen autoriteteve me akuza e gënjeshtra. Përpjekjet e tij të pareshtura patën efekt dhe më në fund u lëshua një urdhër që e syrgjynoste Bahá'u'lláh·un në qytetin e Adrianopojës, edhe më larg kufirit persian.

Përgjigjja e Bahá'u'lláh·ut ndaj urdhrit ishte një akt i jashtëzakonshëm kurajoje. Ai menjëherë reveloi një Tabelë të gjatë drejtuar vetë Sulltanit, në të cilën qortonte atë dhe ministrat e tij dhe nxirrte në shesh papjekurinë e pazotësinë e tyre. Tabela iu dorëzua kryeministrit në një zarf të vulosur. Thuhet se kur ai e hapi letrën e filloi ta lexonte, u zbeh dhe tha: "Është sikur Mbreti i Mbretërve të nxjerrë një urdhër për më të përunjurin mbret vasal të tij për t'i ndrequr sjelljen".[48]

Udhëtimi dymbëdhjetë ditësh nga Kostandinopoja në Adrianopojë ishte shumë i vështirë për Bahá'u'lláh·un dhe familjen e Tij, që ishin tani në syrgjynosjen e tretë. Ishte dhjetor dhe moti ishte i ftohtë i hidhët. Vetëm duke ndezur një zjarr për të shkrirë akullin mundën ata të fitonin ujin prej burimeve përgjatë udhës. Shumë nga syrgjynët nuk kishin rrobat e nevojshme për këtë klimë kaq të ashpër.

Bahá'u'lláh·u hyri në Adrianopojë më 12 dhjetor 1863 dhe qëndroi në atë qytet gjithsej katër vjet e gjysmë. Kjo ishte një periudhë tjetër krizash të dhimbshme e fitoresh të shkëlqyeshme. Ndërsa ndikimi i Bahá'u'lláh·ut rritej, zjarri i xhelozisë digjej më me forcë në zemrën e MírzáYaḥyá·it. Ai doli gjithnjë e më hapur në kundërvënien e tij ndaj Bahá'u'lláh·ut dhe bëri çfarë kishte në dorë që t'i parandalonte Bábí·të të mos pranonin Manifestimin e Perëndisë për këtë Ditë. Vështirësitë që ai shkaktoi jo vetëm prekën vetë komunitetin, por edhe u dhanë armiqve të jashtëm të Besimit armë për të ndërmarrë sulme të mëtejshme kundër Bahá'u'lláh·ut e pasuesve të Tij. Tradhtia e MírzáYaḥyá·it dukej se nuk njihte kufij. Ai madje vendosi ta helmonte Bahá'u'lláh·un dhe thuri plane e u përpoq derisa ia arriti qëllimit. Efekti i helmit te Bahá'u'lláh·u qe i rëndë, dhe megjithëse u shërua, deri në fund të jetës kishte dridhje të dorës.

Adrianopoja, sigurisht, nuk do të kujtohet për veprimet e turpshme të MírzáYaḥyá·it, por për fitoret e mëdha që Bahá'u'lláh·u arriti në atë qytet. Pikërisht prej andej Bahá'u'lláh·u dërgoi shumë nga Tabelat e Tij drejtuar mbretërve e sundimtarëve të botës dhe shpalli botërisht Besimin e Tij.

Kjo shpallje publike ishte faza e tretë e një procesi gradual përmes të cilit Misioni i Bahá'u'lláh·ut iu bë i ditur njerëzimit. Faza e parë filloi në burgun e nëndheshëm të Síyáh-Chál·it në Ṭihrán, kur Shpirti Hyjnor iu revelua Bahá'u'lláh·ut dhe e njoftoi Atë se ishte bartësi i Mesazhit të Perëndisë për kohën e sotme. Megjithëse lindja e Revelacionit të Tij mbeti e panjohur për një dhjetëvjeçar të tërë, kjo, ashtu si agimi, shkundi shpirtrat e përgjumur, duke zgjuar hap pas hapi ata që zotëronin aftësi perceptuese e duke i përgatitur për të njohur Bahá'u'lláh·un. Faza e dytë nisi në kopshtin e Riḍvánit, ku Ai u shpalli Misionin e Vet disa prej besimtarëve që ishin mbledhur për t'i dhënë lamtumirën. Tani një numër i vogël shpirtrash të favorizuar ishin në dijeni të Pozitës së Tij. Faza e tretë ishte shpallja botërisht e Misionit të Tij. Ajo Filloi në Kostandinopojë, mori një përshpejtim të konsiderueshëm në Adrianopojë, dhe arriti pikën më të lartë të fuqisë në 'Akká, vendi tjetër e përfundimtar i syrgjynosjes së Tij.

1. Sa kohë ndenji Bahá'u'lláh·u në Kostandinopojë? _____

2. Përse qëndrimi i Tij atje qe aq i shkurtër? _____

_____

_____

3. Përse nuk u përzie Bahá'u'lláh·u me oborrin e Sulltanit gjatë qëndrimit të Tij në kryeqytet? _____

_____

4. Si përfitoi ambasadori Persian prej refuzimit të Bahá'u'lláh·ut për të mos patur fare të bënte me anëtarët e oborrit dhe me qëllimet e tyre të pavlera? _____

_____

_____

5. Për ku u dëbua Ai pas kësaj? _____

6. Përse Qeveria Persiane donte ta dërgonte Atë sa më larg kufijve të saj? _____

_____

_____

7. Çfarëbëri Bahá'u'lláh·u kur mori lajmin e dëbimit të mëtejshëm të Tij? _____

_____

_____

_____

8. Çfarëtha kryeministri i sulltanit kur lexoi letrën e Bahá'u'lláh·ut? _____

_____

_____

9. Kur mbërriti Bahá'u'lláh·u në Adrianopojë? _____

10. Sa kohë ndenji Ai në atë qytet? _____

11. 11.Cila ishte ngjarja më e rëndësishme që u zhvillua në Adrianopojë? _____

_____

_____

12. Nëpër sa faza kaloi shpallja e Misionit të Bahá'u'lláh·ut njerëzimit ?_____

_____

13. Cila ishte faza e parë? _____

_____

14. Cila ishte faza e dytë? _____

_____

15. Cila ishte faza e tretë? _____

_____

PJESA 24

Kundërvënia e hapur e MírzáYaḥyá·it ndaj Bahá'u'lláh·ut në Adrianopojë shkaktoi çrregullim të madh midis mërgimtarëve, shumë prej të cilëve sapo kishin filluar të kapnin një shkëndijë të Pozitës së Bahá'u'lláh·ut. Kjo u dha armiqve të Kauzës, që kishin pas vetes pushtetin e dy qeverive – persiane dhe otomane –, rastin e nevojshëm për t'i dhënë një goditje tjetër Besimit të sapolindur të Perëndisë. Një mëngjes, papritur shtëpia e Bahá'u'lláh·ut u gjend e rrethuar me ushtarë dhe gjithsecilit i thanë të përgatitej për t'u nisur menjëherë. Për njëfarë kohe askush nuk e dinte ku do të shkonin. Frika më e madhe e shumë syresh ishte se mos i ndanin nga i Shumëdashuri i tyre, sepse poshtë e lart dëgjoheshin fjalë se Bahá'u'lláh·un dhe familjen do ta syrgjynosnin në një vend, ndërsa të tjerët do t'i detyronin të shpërndaheshin. Më në fund u mor vesh se Bahá'u'lláh·u do të syrgjynosej në qytetin-burg të 'Akká·s dhe MírzáYaḥyá·i në ishullin e Qipros. Shumë nga syrgjynët, si nja shtatëdhjetë veta, u dërguan në 'Akká, duke përfshirë dy nga mbështetësit më të mbrapshtë të MírzáYaḥyá·it. Nga ana tjetër, katër nga shokët e Bahá'u'lláh·ut u syrgjynosën me grupin e MírzáYaḥyá·it në Qipro.

Bahá'u'lláh·u dhe familja e Tij u larguan nga Adrianopoja më 12 gusht 1868 dhe, pas një udhëtimi të vështirë nëpër tokë e me det, arritën në 'Akká më 31 gusht. Banorët e 'Akká·s ishin mësuar me ardhjen e të burgosurve, sepse qyteti përdorej nga otomanët si vend internimi për kriminelë e elementë turbullues. Këtë radhë atyre iu tha se të ardhurit ishin armiq të shtetit, të Perëndisë dhe të Fesë së Tij. Sulltani kishte urdhëruar që ata të mbaheshin në izolim të rreptë, me besimin se kushtet e rënda të 'Akká·s do të çonin më në fund në asgjësimin e tyre përfundimtar. Urdhri i sulltanit ishte lexuar publikisht në xhami, dhe të gjithë e kishin kuptuar që këta persianë ishin dënuar me burgim të përjetshëm e që shoqërimi me ta ishte rreptësisht i ndaluar.

Pasi zbritën nga anija në 'Akká, syrgjynët i çuan te barakat ushtarake, një pjesë e të cilave do të ishte burgu i tyre. Natën e parë atyre nuk u dhanë për të ngrënë e për të pirë, dhe më pas secilit iu caktuan tre copa bukë të një cilësie të keqe në ditë. Brenda një kohe të shkurtër, të gjithë, me përjashtim të dy vetave, u sëmurën, dhe tre prej tyre vdiqën. Rojet refuzuan t'i varrosnin të vdekurit pa ua paguar shpenzimet e nevojshme. Atëherë shitën një copë qilim të vogël që Bahá'u'lláh·u e përdorte për të thënë lutjet, dhe paratë ua dhanë rojeve. Më vonë u mësua se ata nuk e kishin mbajtur fjalën dhe i kishin varrosur të vdekurit pa i larë, pa i veshur dhe pa qefin, ndonëse atyre u qe dhënë dyfishi i parave që nevojiteshin për varrimin.

Edhe pse kushtet e burgimit gradualisht u përmirësuan, vitet e para në 'Akká ishin një periudhë vuajtjesh të thella për Bahá'u'lláh·un. Ato që pat hequr në Síyáh-Chál i ishin shkaktuar

Atij vetëm nga armiqtë e jashtëm të Besimit. Kurse telashet në Adrianopojë kishin karakter të brendshëm. Kriza e atyre viteve të para në ‘Akká ishte gjithsesi rezultat i përpjekjeve të armiqve të jashtëm e të brendshëm të Besimit. Vetë Bahá’u’lláh·u i është referuar asaj periudhe me fjalë të tilla:

> **“Dije se me të arritur në atë Vend, Ne vendosëm ta quanim atë ‘Burgu Më i Madh’. Edhe pse më parë qemë lidhur me zinxhirë e vargonj në një tokë tjetër, prapëseprapë Ne nuk e quajtëm atë me këtë emër. Thuaj: mendoni për këtë, O ju që keni dhuntinë e të kuptuarit!”**[49]

Megjithë urdhrin e sulltanit që askush të mos shoqërohej me Bahá’u’lláh·un dhe familjen e Tij, një numër besimtarësh nga Persia morën rrugën e gjatë për në ‘Akká, Shpeshherë në këmbë, me shpresën se do t’i lejonin të hynin në praninë e Tij. Kur mbërrinin, këta shpirtra të devotshëm, duke mos pasur mundësi të afroheshin tek Ai, qëndronin në njëfarë largësie përballë burgut, dhe kënaqeshin duke parë qoftë edhe për një çast figurën e Tij përmes hekurave të dritares së qelisë. Një përshëndetje e Dorës së Tij të bekuar ishte një shpërblim i mjaftueshëm për muaj të tërë udhëtimi, dhe shumica merrnin rrugën e kthimit në shtëpi, mirënjohës për dhuratën që kishin marrë.

Ngjarja më tragjike e kësaj periudhe ishte vdekja e papritur e djalit të Bahá’u’lláh·ut, MírzáMihdí·ut, që njihet si Dega më e Pastër. Një mbrëmje ai ishte në tarracën e barakave, duke ecur tutje-tëhu i përqëndruar në lutje e përsiatje, kur ra nga një baxhë mbi një arkë druri një kat më poshtë. Iu thyen brinjët dhe ndonëse thirrën një mjek, nuk qe e mundur të bëhej gjë. Brenda 22 orësh ai vdiq. Para se të ndërronte jetë, Bahá’u’lláh·u e pyeti Degën më të Pastër çfarë dëshironte. Ai u përgjigj: “Dua që njerëzit e Baháit të mund të arrijnë në praninë Tënde”. “Kështu do të bëhet,” tha Bahá’u’lláh·u; “Perëndia do të ta plotësojë dëshirën”.[50]

Ndonëse vuajtjet e Bahá’u’lláh·ut në burgun e ‘Akká·s ishin shumë të rënda, duhet të sjellim ndërmend se internimi i Tij atje ishte përmbushja e profecive të së shkuarës. Pikërisht në ‘Akká Dielli i së Vërtetës do të ndriçonte për njëzet e katër vjet me shkëlqim të plotë. Gjatë kësaj periudhe, duke vizituar Malin Karmel në Haifa aty pranë, Bahá’u’lláh·u i tregoi ‘Abdu’l-Bahá·it vendin ku do të ndërtohej më vonë Varri i Shenjtë i Báb·it. Vendi i prehjes së Atij Vetë afër ‘Akká·s, do të bëhej Vendi Më i Shenjtë mbi tokë dhe Kibla e njerëzve të Baháit. Në afërsi të Varrit të Shenjtë të Báb·it, do të vendosej Selia e Shtëpisë Universale të Drejtësisë. Qytetet binjake të Haifa·s e ‘Akká·s do të bëheshin qendra botërore shpirtërore e administrative e Besimit Bahá’í. Ndodhi që me këto fjalë që vijojnë, Bahá’u’lláh·u kishte bërë një herë aluzion për internimin e Tij në ‘Akká në një Tabelë, të shfaqur gjatë viteve të para të kaluara në Adrianopojë:

> **“Kur mbërritëm, u përshëndetëm me flamurë drite, pastaj Zëri i Shpirtit thirri duke thënë: ‘Së shpejti të gjithë ata që jetojnë mbi tokë do të rreshtohen nën këta flamurë’.”**[51]

1. Si e shfrytëzuan armiqtë e jashtëm të Besimit në favor të tyre shqetësimin e shkaktuar nga MírzáYaḥyá·i? _____

   _____

2. Ku u syrgjynos pas kësaj Bahá’u’lláh·u? _____

3. Ku u dërgua MírzáYaḥyá·i? _____

4. Sa veta e shoqëruan Bahá'u'lláh·un në 'Akká? _____

5. Si mendoni ju, përse disa nga pasuesit e Bahá'u'lláh·ut u dërguan në Qipro me MírzáYaḥyá·in, ndërsa dy nga mbështetësit e Yaḥyá·it u dërguan në 'Akká? _____

_____

_____

6. Në çfarë date u nis Bahá'u'lláh·u nga Adrianopoja? _____

7. Në çfarë date mbërriti Ai në 'Akká? _____

8. Çfarëurdhra kishte dhënë sulltani lidhur me burgosjen e Bahá'u'lláh·ut dhe të besimtarëve që e shoqëronin? _____

_____

_____

9. Si arritën t'i mësonin këto urdhra populli i 'Akká·s? _____

_____

10. Ku i çuan Bahá'u'lláh·un dhe shokët e Tij me të mbërritur në 'Akká? _____

_____

11. Përshkruani me pak fjalë kushtet e tyre në ditët e para në burg: _____

_____

_____

_____

_____

_____

12. Çfarëemër i vuri Bahá'u'lláh·u 'Akká·s? _____

13. Cila ishte ngjarja më tragjike që ndodhi gjatë viteve të para në 'Akká? _____

_____

14. Nën cilat kushte e bënin pelegrinët e parë rrugën e tyre për në 'Akká?_____

_____

_____

_____

_____

_____

15. Përshkruani me fjalët tuaja rrethanat e vdekjes së Degës më të Pastër:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

16. Sa vjet qëndroi Bahá'u'lláh·u në 'Akká e rrethinat e saj? _____

17. Çfarëi tregoi Bahá'u'lláh·u 'Abdu'l Bahá·ít kur po vizitonin Malin Karmel në Haifa?

_____

18. Cili është Vendi më i Shenjtë në rruzull dhe ku ndodhet? _____

_____

19. Ku ndodhet Selia e Shtëpisë Universale të Drejtësisë? _____

_____

20. Ku ndodhet qendra botërore shpirtërore e administrative e Besimit Bahá'í? _____

_____

21. A e dini se çfarë bëjnë sot pelegrinët kur vizitojnë Haifa·n dhe 'Akká·n? Mund t'i kërkoni ndonjërit prej miqve në komunitetin tuaj që ka qenë pelegrin në Tokën e Shenjtë t'ju tregojë për këtë.

PJESA 25

Në 'Akká Bahá'u'lláh·u vazhdoi shpalljen e Tij universale. Këtu janë disa pasazhe që Ai u drejtoi nga Adrianopoja dhe 'Akká mbretërve dhe sundimtarëve të botës:

Perandorit Francez, Napoleonit III:

"O mbret i Parisit! I thuaj priftit të mos u bjerë më këmbanave. Për Perëndinë, Të Vërtetin! Këmbana Më e Fuqishme është shfaqur në formën e Atij që është Emri Më i Madh…"[52]

Carit të Rusisë, Nikollajeviç Aleksandrit II:

"Ngrihu midis njerëzve në emër të kësaj Kauze gjithënënshtruese, dhe pastaj ftoji kombet drejt Perëndisë, të Lartësuarit, të Madhit".[53]

Mbretëreshës Viktoria të Anglisë:

"Lëre mënjanë dëshirën tënde, dhe ktheje zemrën ndaj Zotit tënd, të Lashtit të Kohëve. Ne të përmendim ty për hir të Perëndisë, dhe dëshirojmë që emri yt të lartësohet për kujtimin tënd e Perëndisë, Krijuesi i tokës e i qiellit".[54]

Mbretit të Prusisë, William I:

"Bëj kujdes që kryelartësia të mos të të pengojë të njohësh Agimin e Revelacionit Hyjnor, që dëshirat tokësore të mos të të veçojnë si një perde nga Zoti i Fronit atje lart e të tokës këtu poshtë".[55]

Perandorit Austriak, Franc-Jozefit:

"Hapi sytë, që të mund të shohësh këtë Vizion të lavdishëm, të njohësh Atë që e ke thirrur me lutje ditën e natën, dhe të soditësh Dritën që shkëlqen mbi këtë Horizont të ndriçuar".[56]

Sulṭán 'Abdu'l-Azíz·it të Perandorisë Otomane:

"Mos e lër mënjanë frikën e Perëndisë dhe ji ndër ata që veprojnë me drejtësi. Mblidhi rreth vetes ata ministra tek të cilët mund të nuhatësh aromën e besimit e të drejtësisë, këshillohu me ta, dhe merr atë që është më e mira në sytë e tu, e ji ndër ata që veprojnë me bujari ."[57]

Náṣiri'd-Dín Sháh·ut të Persisë:

"Ne lutemi që me mirësinë e Tij – lartësuar qoftë Ai –përmes këtij burgimi Ai të çlirojë qafat e njerëzve nga zinxhirët e vargonjtë, dhe të bëjë që ata, me fytyra të sinqerta, të kthehen ndaj Fytyrës së Atij që është i Fuqishmi, Bujari. I gatshëm është Ai t'i përgjigjet kujtdo që e thërret, dhe pranë i ndodhet cilitdo që komunikon shpirtërisht me Të".[58]

Sundimtarëve të Amerikës dhe Presidentëve të Republikave të saj:

"Ngjiteni të thyerin me duart e drejtësisë, dhe dërrmojeni shtypësin që i shkon mbroth, me shkopin e porosive të Zotit tuaj, Urdhëruesit, Urtiplotit".[59]

Papës Piu IX:

"Fjala që Biri e fshehu është shfaqur. Ajo është dërguar këtu poshtë në formën e tempullit njerëzor në këtë ditë. Bekuar qoftë Zoti Që është Ati! Ai, me të vërtetë, u ka ardhur kombeve me madhështinëe Tij më të madhe".[60]

Gjithë turmës së murgjve të Kishës së Krishterë:

"O turmë murgjish! Mos u mbyllni në kisha e manastire. Dilni me lejen Time, dhe merruni me atë që do t'u sjellë përfitim shpirtrave tuaj e shpirtrave të njerëzve".[61]

PJESA 26

Katër muaj pas vdekjes së papritur të Degës më të Pastër, u desh që Bahá'u'lláh·u dhe shokët e Tij të hiqeshin nga barakat që të hapej vend për disa trupa ushtarake. Atë dhe familjen i vendosën përkohësisht në disa shtëpi, dhe më në fund i çuan në shtëpinë që sot njihet si shtëpia e 'Abbúd·it. Ata vazhdonin të mbaheshin nën vëzhgim dhe i rrethonte një popullatë që, nën ndikimin e urdhrave të sulltanit, mbante qëndrim jodashamirës e armiqësor ndaj tyre.

Por me kalimin e kohës populli i 'Akká·s arriti ta kuptojë pafajësinë e këtij grupi të vogël syrgjynësh nga Persia, dhe kushtet e burgimit të tyre u lehtësuan. Në një pjesë të madhe ndryshimet i detyrohen 'Abdu'l-Bahá·it, i cili ishte në kontakt të vazhdueshëm me banorët e qytetit dhe qe në gjendje t'u tregonte atyre qëllimet e vërteta të Bahá'í·ve dhe frymën e Mësimeve të të Atit. Më në fund, Bahá'u'lláh·ut iu krijua mundësia që të dilte nga qyteti i 'Akká·s për të vizituar viset aty pranë. Pasi kishte qenë izoluar aq gjatë në këtë qytet të shkretuar, Bahá'u'lláh·u mund të kalonte tani njëfarë kohe në fshat e të kënaqej me bukurinë e gjelbërimin e natyrës që e donte aq shumë.

Vitet e fundit të jetës Bahá'u'lláh·u i kaloi në Vilën e Bahjí·së, në rrethinat e 'Akká·s. E ndërtuar gjatë kohës që Ai ishte i burgosur brenda mureve të qytetit, ajo u braktis nga i zoti për shkak të një epidemie që shpërtheu në atë zonë. 'Abdu'l-Bahá·it iu dha mundësia ta merrte atë për të Atin e tij të dashur, në fillim me qira e pastaj duke e blerë tërësisht.

Tashmë qëndrimi jo vetëm i njerëzve të 'Akká·s, por edhe i atyre të rajoneve fqinje të Sirisë e Libanit, ndaj Bahá'u'lláh·ut e pasuesve të Tij kishte ndryshuar krejtësisht. Megjithëse urdhrat e sulltanit ishin ende në fuqi dhe zyrtarisht Ai ishte i burgosur e nën mbikqyrje të rreptë, në të vërtetë ishte i adhururar e i respektuar si mbret. Edhe zyrtarët e rajonit vinin për të kërkuar mendimin e këshillën e Tij. E tillë është fuqia e Revelacionit të Bahá'u'lláh·ut për të transformuar zemrat e njerëzve.

Gjatë viteve në 'Akká dhe Bahjí, Pena e Bahá'u'lláh·ut reveloi vëllime të tëra udhërrëfyese që do t'i japë mundësinjerëzimit të ndërtojë një qytetërim të lavdishëm botëror. Vepra më e madhe që rrodhi nga Pena e Tij ishte Qitapi Akdas, Libri Më i Shenjtë i Dispensacionit të Tij, i cili u revelua në Shtëpinë e Abudit rreth vitit 1873. Duke iu referuar Shkrimeve të Bahá'u'lláh·ut të reveluara në Tokën e Shenjtë, Shoghi Effendi·u thotë:

"Shkrimet e Bahá'u'lláh·ut gjatë kësaj periudhe, duke parë fushën e gjerë që përfshijnë, duket se u përkasin tri kategorive të ndryshme. E para përmban ato

shkrime që përbëjnë vijimin e shpalljes së Misionit të Tij në Adrianopojë. E dyta përfshin ligjet dhe dekretet e Dispensacionit të Tij, të cilat në pjesën më të madhe përmbahen në Qitapi Akdas, Librin Më të Shenjtë të Tij. Në të tretën duhen futur ato Tabela që pjesërisht shpallin e pjesërisht rikonfirmojnë doktrinat e parimet që qëndrojnë në themel të këtij Dispensacioni".[62]

Përhapja e gjerë e Besimit të Bahá'u'lláh·ut në botën perëndimore nuk filloi gjatë vetë jetës së Tij dhe do të duhej të priste kohën e shërbesës së 'Abdu'l-Bahá·it. Megjithatë Mësimet e Tij ishin paraqitur në disa vende të Perëndimit, dhe ishte një numër i vogël njerëzish që dinin për të Burgosurin e 'Akká·s, i Cili kishte një ndikim të jashtëzakonshëm mbi të gjithë ata që takonte. Në pranverën e vitit 1890, nga fundi i jetës së Bahá'u'lláh·ut, Edward Granville Browne, një dijetar i njohur nga Kembrixhi në Angli erdhi Ta takojë Atë. Pasazhet që vijojnë janë nga shënimet e tij për këtë intervistë historike:

"… shoqëruesi im u ndal një çast, ndërsa unë zbathja këpucët. Pastaj, me një lëvizje të shpejtë të dorës, hapi perden e, pasi kalova unë, e mbylli; dhe unë u gjenda në një sallon të madh, në fund të të cilit ishte një divan i ulët, ndërsa në anën përballë derës ishin dy-tri karrige. Megjithëse e merrja disi me mend se ku po vija e cilin do të shihja (meqë nuk më kishin dhënë asnjë njoftim të qartë), kaluan një ose dy sekonda para se, me një drithmë habie e nderimi, të bëhesha përfundimisht i vetëdijshëm se ai sallon nuk ishte pa njeri. Në qoshen ku divani puqej me murin ishte ulur një figurë e mahnitshme dhe e nderuar, me një kësulë shajaku në kokë, nga ato që dervishët i quajnë taç (por të një lartësie e forme jo të zakontë), përreth fundit të së cilës ishte mbështjellur një çallmë e vogël e bardhë. S'do ta harroj kurrë fytyrën e atij që po vështroja, megjithëse nuk jam në gjendje ta përshkruaj. Ata sy depërtues dukej sikur të lexonin vetë shpirtin; vetulli i gjerë tregonte fuqi e autoritet; ndërsa rrudhat e thella të ballit e të fytyrës tregonin një moshë që flokët e zinj korb dhe mjekrra madhështore e dendur, që i zbriste deri në mes, sikur e përgënjeshtronin. S'ishte nevoja të pyesja në praninë e kujt ndodhesha, ndërsa përkulesha para atij që është objekt i një devocioni e dashurie të tillë, që mbretërit do ta kishin zili dhe perandorët do ta shpresonin më kot!

"Një zë i ëmbël e plot dinjitet më ftoi të ulesha e pastaj vazhdoi: **'Lavdi Zotit që erdhe! ... Ke ardhur të shohësh një të burgosur e një syrgjyn. ... Ne duam vetëm të mirën e botës dhe lumturinë e kombeve; e megjithatë na konsiderojnë nxitës konfliktesh e revoltash që meritojnë burgim e syrgjynosje. ... Që të gjitha kombet të kenë një besim e të gjithë njerëzit të jenë si vëllezër; që lidhjet e dashurisë e të unitetit midis bijve të njeriut të forcohen; që të mos ketë më dallime fesh dhe të zhduken kundërshtitë midis racave – çfarë të keqe kanë këto? ... Dhe kështu do të bëhet; këto konflikte të pafrytshme, këto luftëra shkatërrimtare do të marrin fund dhe dita e "Paqes së Madhe" do të vijë. ... A nuk keni nevojë për këtë edhe ju atje në Evropë? A nuk është kjo që parashikoi Krishti? ... E megjithatë, shohim që mbretërit e sundimtarët tuaj i shpenzojnë pakursim thesaret e tyre më me dëshirë për mjete të shkatërrimit të gjinisë njerëzore, sesa për mjete që do t'i sillnin lumturi njerëzimit. ... Këto konflikte, kjo gjakderdhje e kjo përçarje duhet të marrin fund dhe të gjithë njerëzit duhet të jenë si një fis e një familje. ... Le të mos lëvdohet njeriu se do vendin e vet, por të lëvdohet se do sojin njerëzor. ...'"[63]**

1. Në çfarë rrethana i hoqën Bahá'u'lláh·un dhe shokët e Tij nga barakat? _____

_____

2. Si quhej shtëpia në ‘Akká ku Bahá’u’lláh·u dhe familja e Tij vendosën më në fund?

_____

3. Si ndryshuan kushtet e tyre të jetesës në ‘Akká? _____

_____

4. Çfarë e shkaktoi këtë ndryshim? _____

_____

_____

5. Si quhet vila ku Bahá’u’lláh·u kaloi vitet e fundit të jetës së Tij? _____

_____

6. Në çfarë rrethanash e bleu vilën në Bahjí‘Abdu’l-Bahá·i? _____

_____

7. Cila është vepra më e rëndësishme e reveluar nga Bahá’u’lláh·u gjatë viteve në ‘Akká?

_____

8. Ku e kur u revelua ajo? _____

_____

9. Cilat jane tri kategoritë në të cilat Shoghi Effendi·u i ka ndarë Shkrimet e Bahá’u’lláh·ut gjatë kësaj periudhe?

a. _____

_____

_____

b. _____

_____

_____

c. _____

_____

_____

10. Cilat janë disa nga ligjet e Dispensacionit të Bahá’u’lláh·ut? _____

_____

_____

_____

_____

11. Cilat janë disa nga parimet e ligjet e Dispensacionit të Tij? _____

_____

_____

_____

_____

12. Kush ishte Edward Granville Brown? _____

_____

13. Çfarë fjalësh përdor Edward Granville Brown për të përshkruar momentin kur po përkulej përpara Bahá'u'lláh·ut, si ndiheshe njeriu kur ishte në prezencën e Tij sipas tij?

_____

_____

14. Sipas fjalëve të regjistruara nga Edward Granville Browne:

- Çfarë thotë Bahá'u'lláh·u të jetë dëshira e Tij_____

  _____

- Çfarë thotë Ai, si duhet të bëhen të gjitha kombet? _____

  _____

- Çfarë dëshiron Ai t'a shohë të forcuar? _____

  _____

- Për se bën thirrje Ai se duhet të ndalojë? _____

  _____

- Për se bën thirrje Ai se duhet të anulohet?_____
  Çfarë parashikon Ai se do të ndodhë? _____

  _____

- Në çfarë thotë Bahá'u'lláh·u duhet të lëvdohet secili? _____

  _____

PJESA 27

Qitapi Akdas nuk është libër i madh; ka vetëm 190 paragrafe. Në të, megjithatë, përmbahen ligjet dhe urdhëresat bazë të qytetërimit të ardhshëm botëror. Shoghi Effendi·u i

referohet atij si Libri Mëmë i Dispensacionit të Bahá'u'lláh·ut, dhe Planimetria e Rendit të Ri Botëror. Ju do studioni pasazhe nga ky libër vazhdimisht gjatë jetës suaj përgjatë përpjekjeve për ta përputhur jetën, mendimet e veprat tuaja me urdhëresat e Perëndisë. Për tani, ju sugjerohet të mësoni përmendësh pesë paragrafët e parë të këtij libri:

> **"Detyra e parë që Perëndia u ka caktuar shërbëtorëve të Vet është të njohin Atë Që është Agimi i Revelacionit të Tij dhe Gurra e ligjeve të Tij, që përfaqëson Hyjninë si në Mbretërinë e Kauzës së Tij dhe në botën e krijimit. Kushdo që e kryen këtë detyrë ka arritur gjithë të mirat; dhe kushdo që është i privuar nga kjo ka humbur rrugën, edhe sikur të ketë kryer veprat më të denja. Është detyrë e cilitdo që arrin këtë pozitë kaq sublime, këtë majë lavdie të përkryer, të zbatojë çdo porosi të Atij Që është Dëshira e botës. Këto detyra binjake janë të pandashme. Asnjëra nuk është e pranueshme pa tjetrën. Kështu ka dekretuar Ai Që është Burimi i frymëzimit Hyjnor.**
>
> **"Ata që Perëndia i ka pajisur me intuitë do ta pranojnë me lehtësi se porositë e dhëna nga Perëndia përbëjnë mjetet supreme për ruajtjen e rendit në botë dhe për sigurinë e popujve të saj. Ai që u kthen shpinën atyre është mjeran e i marrë. Me të vërtetë, Ne ju kemi urdhëruar të flakni diktatin e pasioneve të liga e të dëshirave të mbrapshta dhe të mos i kapërceni caqet që Penda e Më të Lartit ka caktuar, sepse ato janë fryma e jetës për të gjitha gjërat e krijuara. Detet e urtisë Hyjnore e të fjalës Hyjnore janë fryrë nga flladi i Mëshirëplotit. Nxitoni të pini plot kupën, o njerëz me mend! Ata që kanë shkelur Besëlidhjen e Perëndisë, duke dhunuar porositë e Tij, dhe janë kthyer mprapsht, kanë gabuar rëndë në sytë e Perëndisë, Gjithëzotëruesit, Më të Lartit.**
>
> **"O ju popuj të botës! Dijeni me siguri se porositë e Mia janë llambat e provanisë Sime dashamirëse midis shërbëtorëve të Mi dhe çelësat e mëshirës Sime për krijesat e Mia. Kjo është dërguar nga qielli i Vullnetit të Zotit tuaj, Zotit të Revelacionit. Sikur ndokush të shijonte ëmbëlsinë e fjalëve që buzët e Mëshirëplotit kanë dashur të shqiptojnë, ai, edhe po të zotëronte të gjitha thesaret e tokës, do të hiqte dorë nga të gjitha këto për të provuar vërtetësinë qoftë edhe të njërës prej porosive të Tij, që shkëlqejnë mbi Agimet e kujdesit bujar e të dashamirësisë së Tij.**
>
> **"Thuaj: Nga ligjet e Mia nuhatet aroma e këndshme e rrobës Sime dhe me ndihmën e tyre flamujt e fitores do të ngulen në majat më të larta. Gjuha e pushtetit Tim i ka drejtuar nga qielli i lavdisë Sime fuqiplotë krijimit Tim këto fjalë: "Zbato porositë e Mia, për hir të bukurisë Sime". Lum i dashuruari që ka thithur aromën hyjnore të të Shumëdashurit të tij prej këtyre fjalëve të mbushura me kundërmimin e një hiri që asnjë gjuhë s'e përshkruan dot. Për jetën Time! Ai që ka pirë verën e zgjedhur të drejtësisë nga duart e mirëdashjes Sime bujare, do të sillet rreth porosive të Mia, që shkëlqejnë përmbi Agimin e krijimit Tim.**
>
> **"Mos mendoni se Ne ju kemi reveluar thjesht një kod ligjesh. Jo, madje me gishtat e fuqisë e të pushtetit, Ne kemi hapur Verën e zgjedhur. Për këtë dëshmon ajo që ka reveluar Penda e Revelacionit. Përsiatni lidhur mekëtë, o njerëz me intuitë!"**[64]

PJESA 28

Syrgjynosjet e njëpasnjëshme të Bahá'u'lláh·ut, megjithëse të ndërmarra me urdhër të dy tiranëve, në linjë me zyrtarë fetarë të korruptuar, ishin në realitet të drejtuara nga Dora e Vetë Perëndisë Fuqiplotë. Janë të pallogaritshme forcat e çliruara nga Manifestimi i Perëndisë ndërkohë që Ai lëvizte nga një vend në tjetrin—nga toka e Tij amtare drejt brigjeve të 'Akká·s, në afërsi të së cilës do të ngrihej qendra shpirtërore e administrative e Besimit të Tij. Harta më poshtë, duke treguar itinerarin e mërgimit të Tij, është e njohur për ju nga studimi juaj i Librit 2. Në këndvështrim të ideve që keni fituar në këtë njësi, merrni në dispozicion pak kohë për të medituar rreth domethënies shpirtërore të asaj që ndodhi në sicilin prej vendeve më të rëndësishme. Dhe ndërkohë që ju meditoni ato mijra ngjarje të shoqëruara me jetën e Tij dhe kapni një blic të mëtejshëm nga vlerae madhe dhe lavdia e Tij, fuqia dhe madhështia e Tij, sillni në mendje fjalët e Tij: "Ai i cili është përjetësisht i fshehur prej syve të njerëzve asnjëherë nuk mund të njihet përveç Manifestimit të Tij dhe Manifestimi i Tij nuk mund të sjelli provë më të madhe për të vërtetën e Misionit të Tij sesa prova e vetë Personit të Tij."



PJESA 29

Gjatë viteve që një Manifestim i Perëndisë ecën midis njerëzve, fuqitë e Tij të jashtëzakonshme përhapen në mbarë botën, duke shkaktuar një ndryshim të thellë në realitetin e të gjitha gjërave të krijuara. Në këtë Ditë të Lavdishme, Bahá'u'lláh·u i reveloi njerëzimit Fjalën e Perëndisë për pothuajse dyzet vjet, duke e pajisur botën e qenies me mundësi të pakufishme, shpalosja e të cilave do të lindë një qytetërim të një bukurie të paparë. Këta dyzet vjet Revelacioni Hyjnor të vazhdueshëm përfunduan më 29 Maj 1892.

Nëntë muaj para ngjitjes së Tij në qiell, Bahá'u'lláh·u kishte shprehur dëshirën të ndahej nga kjo botë. Që nga ajo kohë e këtej, nga toni i gjërave që thoshte po bëhej gjithnjë e më e qartë se fundi i jetës së Tij në këtë rrafsh tokësor po afrohej. Natën e 8 majit e zuri një ethe e lehtë. Ethet u shtuan të nesërmen, por pastaj u duk sikur kaluan. Ai vazhdoi të lejonte disa besimtarë të caktuar e pelegrinë të takoheshin me Të, por shpejt u bë e qartë se Ai nuk ishte mirë. Ethet iu

rikthyen, kësaj here më të forta se më parë, dhe pak nga pak gjendja e Tij u keqësua. Në orën e agimit të 29 Majit 1892, në vitin e 75-të të jetës, shpirti i Tij u ngjit në qiell nga kjo botë.

Gjashtë ditë para se të ndërronte jetë, Ai thirri në praninë e Tij të gjithë besimtarët që ishin mbledhur në Vilën e Bahjí·s, për atë që do ishte takimi i fundit me Të. Ndërsa rrinte shtrirë në shtrat i mbajtur nga njëri prej djemve të Tij, iu drejtua atyre: "Jam shumë i kënaqur me të gjithë ju", tha Ai. "Ju keni bërë shumë shërbime, dhe keni qenë shumë ngulmues në përpjekjet tuaja. Keni ardhur këtu çdo mëngjes e mbrëmje. Ju ndihmoftë Zoti të qëndroni të bashkuar. Ju ndihmoftë Ai të lartësoni Kauzën e Zotit të qenies".[65] Nga sytë e atyre që ishin mbledhur rreth Tij rridhnin lot.

Lajmi i ndërrimit jetë të Bahá'u'lláh·ut iu komunikua menjëherë Sulltanit me telegram. Mesazhi fillonte me fjalët "Dielli i Bahá·it perëndoi" dhe vazhdonte të vinte në dijeni Sulltanin lidhur me planet për ta varrosur trupin e shenjtë në afërsi të Vilës. U zgjodh një dhomë e vogël në një shtëpi në perëndim të vilës, dhe pak pas perëndimit të diellit pikërisht në ditën e ndërrimit Jetë Të Tij, Trupi i Tij u vendos të prehej. Nabíl·i e përshkruan agoninë e atyre ditëve me këto fjalë: "Më duket se trazimi shpirtëror i shkaktuar në këtë botë të pluhurit bëriqë të gjitha botët e Perëndisë të dridhen. ... Gjuha ime e brendshme dhe e jashtme është e pafuqishme të përshkruajë me fjalë gjendjen në të cilën ishim ... Në mes të konfuzionit që mbizotëronte, një numër i madh banorësh të 'Akká·s e të fshatrave fqinje, që kishin mbushur fushat rreth e qark Vilës, shiheshin që qanin, i binin kokës me grushta dhe shprehnin me zë të lartë hidhërimin e tyre".[64]

Për një javë të tërë, turma të mëdha njerëzish në zierdhën papushim për t'i shprehur hidhërimin e tyre familjes së Bahá'u'lláh·ut. Njerëz të shquar nga të gjitha shtresat e shoqërisë, përfshirë myslimanë, të krishterë e Izraelitë, poetë, klerikë e qeveritarë, u bashkuan në vajtimin për humbjen e Tij dhe në vlerësimin e lartë të virtyteve e të madhështisë së Tij. Shumë prej tyre madje i shprehën këto nderime edhe me shkrim. Shprehje të tilla nderimi u morën nga qytete anekënd zonës dhe të gjitha iu dorëzuan 'Abdu'l-Bahá·it, i cili përfaqësonte tani Kauzën e Bahá'u'lláh·ut. Megjithatë, këto shprehje të hidhërmit sipas fjalëve të Ruajtësit, s'ishin "veçse një pikë uji në krahasim me oqeanin e trishtimit e me dëshmitë e panumërta të devocionit të pakufishëm që, në orën e perëndimit të Diellit të së Vërtetës, vërshuan nga zemrat e mijëra e mijëra vetave që kishin përqafuar Kauzën e Tij, dhe ishin të vendosur të ngrejnë lart flamurin e Tij në Persi, Indi, Rusi, Irak, Turqi, Palestinë, Egjipt e Siri".[67]

Tani pasi të refelktoni për një moment mbi paragrafët më sipër formoni një çift me një anëtar tjetër të grupit tuaj dhe merrni me rradhë fjalën duke paraqitur me fjalët tuaja historinë e ngjitjes në qiell të Bahá'u'lláh·ut.

PJESA 30

Pasi ndërroi jetë Bahá'u'lláh·u, 'Abdu'l-Bahá·i caktoi Nabíl·in të përzgjidhte ato pasazhe që përbëjnë tekstin e Tabelës së Vizitimit. Kjo Tabelë recitohet në Varret e Shenjta të Bahá'u'lláh·ut e të Báb·it. Përdoret shpesh edhe në përkujtimoret e Tyre. Ngjitja në qiell e Bahá'u'lláh·ut përkujtohet në orët e para të 29 Majit. Kur ju të merrni pjesë në mbledhje të tilla në komunitetin tuaj, ju do të njiheni mirë me tekstin e kësaj tabele me bukuri aq të rrallë, nëse nuk e keni hasur atë tashmë. Ju ka hije ndërkohë që tani që e mbarojmë kursin rreth jetës së Bahá'u'lláh·ut t'a lexoni dhe të reflektoni për këtë Tabelë:

"Lavdërimi që ka aguar nga Vetja Jote më auguste dhe lavdia që ka shkëlqyer nga Bukuria Jote më e shndritshme, qofshin mbi Ty, O Ti që je Manifestimi i Madhështisë dhe Mbreti i Përjetësisë, dhe Zoti i të gjithë atyre që janë në qiell e mbi tokë! Unë dëshmoj se nëpërmjet Teje sovraniteti i Perëndisë e sundimi i tij, dhe madhështia e Perëndisë e madhëria e Tij, janë reveluar, dhe Yjet e Ditës të shkëlqimit të lashtë kanë hedhur ndriçimin mbi qiellin e vendimit Tënd të parevokueshëm, dhe Bukuria e të Padukshmit ka shkëlqyer mbi horizontin e krijimit. Unë dëshmoj, për më tepër, se vetëm me një lëvizje të Pendës Sate, urdhri Yt 'Të bëhet' u imponua dhe Sekreti i fshehur i Perëndisë u shpall dhe të gjitha gjërat e krijuara u sollën në qenie, dhe të gjitha Revelacionet u dërguan.

"Unë dëshmoj, për më tepër, se nëpërmjet Bukurisë Sate bukuria e të Adhuruarit është zbuluar, dhe nëpërmjet fytyrës Sate fytyra e të Dëshiruarit ka shkëlqyer, dhe nëpërmjet një fjale Tënden Ti ke vendosur midis të gjitha gjërave të krijuara, duke bërë që besnikët e Tu të ngjiten në majat e lavdisë dhe të pabesët të bien në humnerën më të thellë.

"Unë dëshmoj se ai që të ka njohur Ty ka njohur Perëndinë, dhe ai që ka arritur praninë Tënde ka arritur praninë e Perëndisë. I madh është, pra, bekimi i atij që ka besuar tek Ti dhe te Shenjat e Tua, dhe e ka përunjur veten përpara sovranitetit Tënd, dhe është nderuar duke të takuar Ty, dhe ka arritur pëlqimin e vullnetit Tënd, dhe ka ardhur pranë Teje e ka qëndruar para fronit Tënd. Mjerë ai që është fajtor ndaj Teje, dhe të ka mohuar Ty, dhe ka refuzuar shenjat e Tua, dhe i është kundërvënë sovranitetit Tënd, dhe është ngritur kundër Teje, dhe është bërë kryelartë para fytyrës Sate, dhe ka kundërshtuar dëshmitë e Tua, dhe është larguar nga sundimi Yt e nga zotërimi Yt, dhe është radhitur me të pabesët, emrat e të cilëve janë shënuar në Tabelat e Shenjta nga gishtat e urdhrit Tënd.

"Çoji, pra, drejt meje, O Perëndia im e i Shumëdashuri im, nga dora e djathtë e mëshirës Sate dhe e dashamirësisë Sate, flladet e shenjta të favoreve të Tua, që ato të më largojnë nga vetvetja e nga bota dhe të më çojnë në oborret e afrisë Sate e të pranisë Sate. Ti e ke në dorë të bësh çfarë të duash. Ti, me të vërtetë, ke qenë më i larti mbi të gjitha gjërat.

"Kujtimi i Perëndisë e lavdërimi i Tij, dhe Lavdia e Perëndisë e shkëlqimi i Tij, qofshin mbi Ty, O Ti që je Bukuria e Tij! Unë dëshmoj se syri i krijimit nuk ka parë kurrë një të munduar si Ti. Ti u zhyte gjatë të gjitha ditëve të jetës Sate në oqeanin e fatkeqësive. Dikur Ti ishe në zinxhirë e vargonj; një herë tjetër u kërcënove nga shpata e armiqve të Tu. Megjithatë, pavarësisht nga të gjitha këto, Ti i këshillove të gjithë njerëzit të zbatojnë ato që qenë caktuar për Ty nga Ai që është i Gjithëdijshmi, Urtiploti.

"Shpirti im u bëftë fli për të këqijat që ke vuajtur Ti, dhe shpirti im qoftë haraç për fatkeqësitë që Ti ke pësuar. I përgjërohem Perëndisë, për Ty dhe për ata, fytyrat e të cilëve janë ndriçuar nga shkëlqimet e dritës së fytyrës Sate dhe që, për hir të dashurisë për Ty, kanë zbatuar gjithçka që u ishte urdhëruar, t'i largojë perdet që janë vendosur midis Teje e krijesave të Tua, dhe të më japë mirësitë e kësaj bote e të botës që do të vijë. Ti je, me të vërtetë, Fuqiploti, Më i Lavdëruari, Lavdiploti, Gjithmonëfalësi, Më i dhembshuri.

"Bekoje, O Zot Perëndia im, Pemën Hyjnore të Lotusit dhe gjethet e saj, dhe degëzat e saj, dhe degët e saj, dhe trungun e saj, dhe filizat e saj, për aq kohë sa do të jetojnë titujt e Tu më të shkëlqyer dhe do të jenë atributet e Tua më madhështore. Mbroje, pra, atë nga ligësitë e agresorit dhe nga hordhitë e tiranisë. Ti je, me të vërtetë, Fuqiploti, Më i Pushtetshmi. Bekoji, gjithashtu, O Zot Perëndia im, shërbëtorët dhe shërbëtoret e Tua, që kanë arritur tek Ti. Ti je, me të vërtetë, Bujariploti, hiri i të Cilit është i pafund. Nuk ka Perëndi tjetër veç Teje, Gjithmonëfalësit, Më Bujarit".[65]

PJESA 31

Nga përvoja juaj, ju e dini se në vitet e ardhshme do të keni raste të panumërta për të treguar historinë e jetës së Bahá'u'lláh·ut. Ju padyshim e keni ndarë historinë në shumë raste që kur e keni përfunduar Librin 2, i cili ju ka ofruar një rrëfim të shkurtër, por të kuptueshëm të Jetës së Tij, si një prej disa temave të thellimit që janë për t'u eksploruar me miqtë dhe fqinjët gjatë një serie vizitash në shtëpitë e tyre. Rrëfimi që ju keni studiuar tani,është më i detajuar sesa ai i prezantuar në Librin 2, dhe ju do të keni mundësi të sillni në bisedat tuaja rreth personit të Bahá'u'lláh·ut njohuritë e reja që keni fituar në lidhje me ngjarjet e jetës së Tij, siç rrethanat e sugjerojnë. Më shumë të rëndësishme sidoqoftë, do të jenë idetë që keni fituar nga ngjarje të tilla në drejtim të natyrëssë Revelacionit të Tij, karakterin e Misionit të Tij, madhësinë e forcave të çliruara nga shfaqja e Tij dhe domethënien e kësaj periudhe në historinë njerëzore. Cilatdo qofshinrrethanat, një bisedë e shkurtër me dikë të ri në Besim apo një prezantim i bërë gjatë një vizite në një shtëpi në fshatin apo lagjen tuaj –janë këto ide që do të ndikojnë në analizën finale sesi flisni ju rreth personit të Bahá'u'lláh·ut dhe atë çka i përçoni dëgjuesit. Sigurisht do të ketë raste kur tu kërkohet një prezantim i shkurtër dhe faqet që vijojnë do mund t'ju ndihmojnë në këtë detyrë.

Bahá'u'lláh

Lavdia ePerëndisë



Bahá'u'lláh u lind në 12 Nëntor 1817 në Ţeheran, kryeqyteti i Iranit. Qysh nga fëmijëria e Tij, Ai tregoi shenja fisnikërie. Ai mori pak mësime në shtëpi, por nuk kishte nevojë të ndiqte shkollë, Pasi ai ishte paisur nga Perëndia me njohuri të lindura.



Një natë, babai i Tij pa një ëndërr, në të cilën e pa Bahá'u'lláh·un duke notuar në oqean. Drita që rrezatohej nga trupi i Tij ndriçonte ujrat. Floku i Tij i gjatë i zi pluskonte në të gjitha drejtimet, dhe një numër i madh peshqish e ndoqën Atë, çdonjëri mbahej tek fundi i një fijeje floku. Ai lëvizte lirshëm dhe i papenguar. Kjo ëndërr ishte njëra prej shumë shenjave të fatit madhështor, që e priste Bahá'u'lláh·un.

Më vonë, kur Ai të ishte djalë i ri, Bahá'u'lláh·ut ju ofrua një pozitë e lartë në oborrin e Mbretit, por Ai e refuzoi atë. Ai dëshironte t'a përkushtonte kohën e vet për t'u ardhur në ndihmë të shtypurve, të sëmurëve dhe të varfërve dhe të mbështeste kauzën e drejtësisë.



Kur ishte 27 vjeç, Bahá'u'lláh·u mori një Shkrim të mbledhur rulon prej Báb·it, Mesazherit të Ri të Perëndisë, i Cili po i pregatiste njerëzit për ardhjen e të Premtuarit të të gjitha Kohrave. Bahá'u'lláh·u e pranoi Mesazhin e Báb·it dhe u bë njëri prej mbështetësve të Tij më entuziastë.

Autoritetet, duke mos patur dëshirë të pranonin të vërtetën e shpallur prej Báb·it, u hodhën të persekutonin ata që besuan tek Ai, dhe kështu filluan vuajtjet e Bahá'u'lláh·ut. Në vitin 1852, Ai u arrestua dhe u prangos nën zinxhirë në një nga burgjet më të llahtarshme të Ṭeheranit.

Në këtë burg, Perëndia i zbuloi Bahá'u'lláh·ut, që Ai ishte i Premtuari nga Báb·i dhe i të gjithë Profetëve të së shkuarës. Nga kjo birucë e nëndheshme u ngrit Dielli i së Vërtetës, duke ndriçuar botën dhe duke i dhënë jetë një Dite të Re jetës së njerëzimit.

Pas katër muajsh burgimi, qeveria syrgjynosi Bahá'u'lláh·un nga toka e Tij Amtare. Gjatë të ftohtit të hidhur të dimrit, Bahá'u'lláh·u dhe familja e Tij bënë udhëtimin e gjatë nga Ţeherani për në Bagdad.

Fama dhe zgjuarësia e Bahá'u'lláh·utu përhapën në të gjitha drejtimet në Bagdad. Njerëz nga çdo sferë shoqërore tuboheshin tek shtëpia e Tij, duke kërkuar ndihmën dhe këshilllën e Tij. Qeveria, e cila kishte frikë nga influenca e Bahá'u'lláh·ut, vendosi t'a dërgojë Atë edhe më larg nga toka e Tij amtare.



Përpara se t'a linin Bagdadin, Bahá'u'lláh·u kaloi dymbëdhjetë ditë në një kopësht jashtë qytetit, ku varganë vizitorësh erdhën t'i thoshin Atij lamtumirë. Në këtë kopësht, Bahá'u'lláh·u shpalli se Ai ishte Manifestimi i Perëndisë për këtë ditë. Për shekujt, që do vinë, kjo periudhë dymbëdhjetë ditore në prill do festohet si Festivali i Riḍvánit, përvjetori i deklarimit të Bahá'u'lláh·ut për Misionin e Tij mbarë-botëror.

Sulṭán ‘Abdu’l-Aziz
of the Ottoman Empire

Nicolaevitch Alexander II,
Czar of Russia

Franz-Joseph,
Austrian Emperor

Napoleon III,
Emperor of the French

Náṣiri’d-Dín Sháh
of Persia

Pope Pius IX

Queen Victoria
of England



William I,
King of Prussia

Vendi tjetër i mërgimit të Bahá’u’lláh·ut ishte Konstandinopoja dhe, më vonë, Adrianopoja, të dyja qytete të Turqisë së sotme. Nga Adrianopoja, Bahá’u’lláh·u, i burgosur dhe syrgjyn, u dërgoi letra mbretërve dhe sundimtarëve të botës duke i urdhëruar ata të tregonin drejtësi dhe të përdorin fuqinë e tyre për t’i dhënë fund varfërisë dhe luftës.

Në Adrianopojë, si më parë, fama e Bahá'u'lláh·ut u përhap midis banorëve të rajonit, dhe qeveria vendosi t'a syrgjynoste atë madje edhe më larg në qytetin-burg të 'Akká-s. Ky ishte burgu, në të cilin kriminelët më të ligj dhe ngatërrestarët e vendit ishin dërguar, për të mos u dëgjuar më kurrë.



Kushtet e burgosjes ishin ekstremisht të ashpra. Disa nga ithtarët e Bahá'u'lláh·ut udhëtonin me kilometra të tëra për në 'Akká, por nuk lejoheshin të hynin në praninë e Tij. Ata mundeshin të shihnin vetëm siluetën e Tij nga larg ndërsa Ai i përshëndeste ata me dorë, që nga dritarja e qelisë së Tij.

Gradualisht kushtet u përmirësuan, ndërkohë që numra njerëzishnë rritjetë zonës, arritën t'a njohin fuqinë dhe madhështinë e Bahá'u'lláh·ut. Gjatë viteve të fundit të Jetës së Tij, Ai jetoi në Vilën e Bahjí-t, jashtë mureve të qytetit. Në 'Akká, Bahá'u'lláh·u shfaqi volume udhëzimesh për njerëzimin, përfshirë Kitáb-in-e-Aqdas-it, Librin e Tij më të Shenjtë.

Në Maj 1892 Bahá'u'lláh·u ndërroi jetë. Vendprehja e Tij e Përjetshme në Bahjí, e rrethuar tani nga kopshte të bukura, është Vendi më i shenjtë në glob. Çdo vit, mijra vetë nga bota mbarë vizitojnë vendin e Tij të prehjes për t'i shprehur respektin si dhe të luten e të meditojnë në rrethinat e qeta.

REFERENCAT

1. *The Promulgation of Universal Peace* [Shpallja e Paqes Universale], Bahá'í Publishing Trust, Wilmette 1995, f. 25.

2. Bahá'u'lláh, *The Summons of the Lord of Hosts: Tablets of Bahá'u'lláh* [Thirrja e Zotit e Ushtrive: Tabela të Bahá'u'lláh·ut], Qendër Botërore Bahá'í, Haifa 2002, f. 167

3. Po aty, f. 167-68.

4. Nabíl, *Lajmëtarët e Agimit*, Tiranë [i pabotuar], #203.

5. *Lajmëtarët e Agimit*, #204.

6. Bahá'u'lláh, *Epistle to the Son of the Wolf* [Letër për të Birin e Ujkut], Bahá'í Publishing Trust, Wilmette 1995, f. 11.

7. 'Abdu'l-Bahá, *On Divine Philosophy* [Për filosofinë hyjnore], Tudor Press, Boston 1918, f. 49.

8. *Lajmëtarët e Agimit*, #178.

9. Po aty, #187.

10. Po aty, #187.

11. Po aty, #187.

12. Po aty, #187.

13. Po aty, #188.

14. Po aty, #189.

15. Po aty, #190.

16. *Selections from the Writings of the Báb* [Pjesë të zgjedhura nga Shkrimet e Báb·it], Qendër Botërore Bahá'í, Haifa 1982, f. 82-83.

17. Po aty, f. 98.

18. Po aty, f. 149.

19. *Lajmëtarët e Agimit*, #196.

20. Po aty, #198.

21. *Qëmtime nga Shkrimet e Bahá'u'lláh·ut,*Tiranë 1995, #129.

22. *The Promulgation of Universal Peace,* f. 141-42.

23. Nga një letër e datës 29 gusht 1852, shkruar nga Captain Von Goumoens, cituar në Shoghi Effendi, *God Passes By*[Perëndia kalon pranë], Bahá'í Publishing Trust, Wilmette 1995, f. 65-66.

24. *Lajmëtarët e Agimit*, #955.

25. *Tabela të Bahá'u'lláh·ut të reveluara pas Qitapit Akdas*, Tiranë 2002, #4:27.

26. Po aty, #7:41.

27. *Lajmëtarët e Agimit*, #982.

28. *Epistle to the Son of the Wolf*, f. 20-21.

29. a. *Lajmëtarët e Agimit*, #982; b. Po aty, #984.

30. *Epistle to the Son of the Wolf,* f. 21.

31. Po aty, f. 22.

32. *God Passes By,* 101-02.

33. *Qëmtime*, #29.

34. *Kriza dhe Fitorja,* Tiranë 1996, #287:2 (rev.)

35. Balyuzi, H. M., *Bahá'u'lláh: The King of Glory*[Bahá'u'lláh, Mbreti i Lavdisë], George Ronald, Oxford 1991, f. 104.

36. *God Passes By,* f. 109.

37. Bahá'u'lláh, *Kitáb-i-Íqán*, Tiranë 1998, #279 (rev.).

38. *God Passes By*, f. 115.

39. Po aty, f. 137.

40. *Epistle to the Son of the Wolf*, f. 22.

41. *God Passes By*, f. 144.

42. *Kitáb-i-Íqán*, Tiranë 1998, #2.

43. Bahá'u'lláh, *Fjalët e Fshehura*, Tiranë 1996, f. 5 (#0).

44. *God Passes By*, f. 147.

45. Bahá'u'lláh, *Qitapi Akdas: Libri më i Shenjtë*, Tiranë 2004, Q75.

46. *God Passes By,* f. 153.

47. *Qëmtime*, #14.

48. *God Passes By,* f. 160.

49. *God Passes By,* f. 185.

50. *Bahá'u'lláh: The King of Glory*, f. 311-13.

51. *God Passes By,* f. 184.

52. *The Proclamation of Bahá'u'lláh to the Kings and Leaders of the World*, Bahá'í World Centre, Haifa 1967, f. 17.

53. Po aty, f. 28.

54. Po aty, f. 33.

55. Po aty, f. 39.

56. Po aty, f. 43.

57. Po aty, f. 47.

58. Po aty, f. 60.

59. Po aty, f. 63.

60. Po aty, f. 84.

61. Po aty, f. 95.

62. *God Passes By*, f. 205-06.

63. *Bahá'u'lláh: The King of Glory*, f. 371-03.

64. *Qitapi Akdas,* Q1-5.

65. *God Passes By*, f. 222.

66. Po aty, f. 222.

67. Po aty, f. 223.

68. Bahá'u'lláh, nga: *Një përzgjedhje Lutjesh Bahá'í dhe Shkrimesh të Shenjta,* #96, bot. i dytë shqip 2001, f. 124-127.